



# JU JENI I ZHVENDOSUR: TË DREJTAT TUAJA NUK JANË

KTHIMI I QËNDRUESHËM I PRONAVE DHE ZGJIDHJET PËR ZHVENDOSJEN NË  
KOSOVË GJATË TRANZICIONIT



# JU JENI I ZHVENDOSUR: TË DREJTAT TUAJA NUK JANË

KTHIMI I QËNDRUESHËM I PRONAVE DHE ZGJIDHJET PËR ZHVENDOSJEN NË  
KOSOVË GJATË TRANZICIONIT

## **TABELA E PËRMBAJTJES**

### **Pjesa I**

3. Fotografia: Kampi Konik 1, Mali i Zi
4. Parafjala
5. Hyrje
6. Fotografia: Qendra kolektive Konik 2, Mali i Zi
7. Rekomandimet e konferencës
17. Artikulli i Ministrisë së ambientit dhe planifikimit hapësinor
19. Fotografia: Qendra kolektive Krnjaca në Beograd
20. Artikulli i Zyrës së Ombudspersonit
23. Fotografia: Kampi në Leposaviq/Leposavić
24. Artikulli i Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë dhe Projektit të të Drejtave Civile në Kosovë
27. Fotografia: Qendra kolektive në Leposaviq/Leposavić
28. Artikulli nga Agjencionii Kosovar për Prona
31. Fotografia: Qendra kolektive në Padalishtë/Padalište afër Graqanicës/Gračanica
32. Artikulli nga Seksioni i OSBE-së për Prona
36. Fotografia: Kampi “Padina” në pyjet e Çukaricës afër Beogradit
37. Artikulli nga Divizioni i OSBE-së për Komunitete
40. Fotografia: Kampi “Padina” në pyjet e Çukaricës afër Beogradit
41. Artikulli nga MPDL – Lëvizja për Paqe

### **Pjesa II**

53. Fotografia: Kampi i Plementinës/Plementina afër Prishtinës/Priština
54. Parimet e Pinheiro-s
67. Fotografia: Kampi Konik 1, Mali i Zi
68. Raporti “Tetë vite më pas: Kthimi i pakicave dhe kthimi i objekteve banesore dhe pronës në Kosovë”
104. Aktivitete pasuese lidhur me Rekomandimet në raportin e OSBE-së: Tetë vite më pas: Kthimi i pakicave dhe kthimi i objekteve banesore dhe pronës në Kosovë
109. Informatat lidhur me fotografitë
111. Mirënjojjet



## SEKTORI 1

### PARATHËNIE NGA SHEFI I MISIONIT TË OSBE-SË NË KOSOVË

Tetë vite pas konfliktit, kthimi i pronës dhe kthimi dhe reintegrimi i personave të zhvendosur nga Kosova vazhdon të jetë një prej sfidave kryesore në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë. Ashtu siç pasqyrohet në raportin e Misionit të OSBE-së në Kosovë “Tetë vite më pas: Kthimi i pakicave dhe kthimi i objekteve banesore dhe pronës në Kosovë (qershori 2007)” që nga viti 1999 është kthyer një numër i vogël i pjesëtarëve të pakicave. Me mijëra mbesin të zhvendosur dhe shpesh jetojnë në kushte të vështira në zonat e tyre të zhvendosjes. Ata janë të zhvendosur por të drejtat e tyre nuk janë, dhe institucionet e Kosovës duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekjet e domosdoshme për t'i mbrojtur ato.

Në nëntor të vitit 2007, OSBE-ja, në bashkëpunim me Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor në Kosovë dhe me organizatën joqeveritare spanjolle “Lëvizja për Paqe” (Movement for Peace) e kanë organizuar një konferencë si vazhdimësi të raportit “Tetë vite më pas: Kthimi i pakicave dhe kthimi i objekteve banesore dhe pronës në Kosovë”. Përfaqësues të autoriteteve qendrore e lokale në Kosovë, të cilët merren me kthimin e pronës dhe çështjet që kanë të bëjnë me të zhvendosurit kanë marrë pjesë në konferencën: “Ju jeni i zhvendosur: por të drejtat tuaja jo: konferanca mbi kthimin e qëndrueshëm të pronave dhe zgjidhjet për zhvendosjen në Kosovë gjatë tranzicionit”.

Bazuar në rezultat e kësaj konference si dhe në pikëpamjet e pjesëmarrësve, ky publikim vë në pah sfidat e mbetur që duhet të zgjidhen në proceset e kthimit të pronës, kthimit dhe reintegrit dhe ofron rekomandime ligjore dhe të politikës për t'u ballafaquar me këto sfida.

Misioni shpreson se këto rekomandime nuk do të mbesin në letër por do të zbatohen dhe do të ndihmojnë në përmirësimin e jetës së të zhvendosurve.

Tim Guldimann,  
Shefi i Misionit,  
Mision i OSBE-së në Kosovë

## Hyrje

Inspirimi për këtë libër<sup>1</sup> rroddhi nga konferanca e mbajtur në Kosovë në nëntor të vitit 2007 të titulluar “Ju jeni i zhvendosur: të drejtat tuaja nuk janë: Konferanca për kthimin e qëndrueshëm të pronave dhe kthimin në përgjithësi në Kosovë gjatë tranzicionit”. Libri fillon me rekomandimet e konferencës se si të lëvizet përpara.

Libri është i ndarë në dy pjesë. Në pjesën e parë, vihen në pah sfidat nga këndvështrimi i akterëve të ndryshëm lidhur me çështjet pronësore në Kosovë. Ministria për Ambient dhe Planifikim Hapësinor, Agjencioni Kosovar për Prona, Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë në bashkëpunim me Projektin për të Drejtat Civile në Kosovë, Lëvizjen për Paqe, një organizatë joqeveritare spanjolle që punon në Kosovë, Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë dhe OSBE-në kanë cekur pikëpamjet e tyre lidhur me çështjet që duhet të shtjellohen gjatë procesit të kthimit të pronës dhe kthimit në përgjithësi.

Pjesa e dytë përmban informata kyçë se si të zbatohen rekomandimet e konferencës. Raporti i OSBE-së “Të vite më pas: Kthimi i pakicave dhe i objekteve banesore dhe pronës në Kosovë”<sup>2</sup> ilustron sfidat specifike që duhet të shtjellohen në Kosovë. Parimet e Pinheiro-s zhvillojnë standardek ekzistuese ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të tij të zhvendosurve dhe shërben si një udhërrëfyes i rëndësishëm për të gjithë akterët relevant në shtjellimin e çështjeve ligjore dhe teknike në përpjekjet përmbrrojtjen e të zhvendosurve në Kosovë.

Shpresojmë se ky publikim ofron një kontekst dhe inspirim për t'u ballafaquar me këto çështje themelore të të drejtave të njeriut në Kosovë.

<sup>1</sup> Pikëpamjet e shprehura në këtë libër nuk i shprehin domosdoshmërisht qëndrimet e Misionit të OSBE-së në Kosovë

<sup>2</sup> Raporti është lëshuar në qershor të vitit 2007.



## JU JENI I ZHVENDOSUR: TË DREJTAT TUAJA NUK JANË

### KONFERENCA PËR KTHIMIN E QËNDRUESHËM TË PRONAVE DHE ZGJIDHJET PËR ZHVENDOSJE NË KOSOVË GJATË TRANZICIONIT DOKUMENTI PËRFUNDIMTAR I KONFERENCËS DHE REKOMANDIMET

NËNTOR 26 - 27, 2007. HOTELI GRAND, PRISHTINË

Tetë vite pas luftës, kthimi i pronës vazhdon të jetë një prej sfidave kryesore për Kosovën. Rreth 17,000 kthime të pakicave janë bërë deri në vitin 1999. Me mijëra të tjerë mbesin të zhvendosur dhe të drejtat e tyre nuk mbrohen në mënyrë adekuate. Më 26-27 nëntor, Misioni i OSBE-së në Kosovë, në bashkëpunim me organizatën joqeveritare spanjolle "Lëvizja për Paqe" dhe me Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor kanë organizuar një konferencë në Prishtinë me titull "Ju jeni i zhvendosur, të drejtat tuaja nuk janë" duke nxitur edhe më tej idetë dërekomandimet e cekura në raportin "Tetë vite më pas" të publikuar në qershor të vitit 2007. Qëllimi i konferencës ishte të shqyrtohen çështjet e pazgjidhura brengosëse lidhur me kthimin e pronës si dhe të vlerësohen mënyrat për gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme për zhvendosjen përmes një procesi të gjërë përfshirës dhe konsultativ.

Konferanca vuri në pah një numër çështjesh kyçe të cilat i kontribuojnë dobësimit të mbrojtjes së të drejtave të personave të zhvendosur. Për më tepër, ajo mundësoi hartimin e politikës dhe rekomandimeve ligjore:

- Mungesën e financimit dhe rastet e pengimit nga ana e autoriteteve lokale e bëjnë procesin e kthimit të pronës përmes Agjencionit Kosovar të Pronave një proces mjift sfidues.
- Korniza ligjore dhe institucionale nuk është e përgatitur për të plotësuar nevojat e veçanta të personave të zhvendosur. Komunat dhe gjykatat nuk mund t'i njoftojnë ata me kohë, ndërsa korniza ligjore në zbatim është jo adekuate.
- Shënimet kadastrale dhe gjyqësore përkitazi me Kosovën qëndrojnë të zhvendosura në Serbi. Për më tepër, nuk ekziston ndonjë procedurë adekuate e njoftimit publik dhe rishqyrtimit për të mbrojtur personat e zhvendosur kur bëhen ndryshime në regjistrin e pronës së patundshme për shkak të punës teknike apo transfereve pronësore. Në këtë drejtim, ekziston një nevojë e qartë që të përmirësoset bashkëpunimi institucionalë ndërmjet Republikës së Serbisë dhe institucioneve të Kosovës në sferën e drejtësisë, regjistrimin e të drejtave mbi pronën e patundshme dhe në shërbimet tjera publike.
- Shkatërrimi i vendbanimeve joformale gjatë konfliktit në asnjë rast nuk duhet të çoj në ndarjen e mëtejme të romëve, ashkalinjve dhe egjiptasve. Personave të zhvendosur që kanë jetuar në vendbanimet joformale u duhen masa të veçanta të regullarizimit të tokës në mënyrë që t'i mbrojnë të drejtat e tyre banesore. Ekziston nevoja për një organ koordinues dhe mbikëqyrës – përfshirë përfaqësues të të zhvendosurve, organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e tjera kyçe të interesit – për të shqyrtaur dhe shtjelluar rregullisht sfidat e panumërtë teknike dhe të politikës të cilat mbesin të pazgjidhura në sferën e kthimit të pronës apo zhvendosjes.
- Kthimet nuk janë e vetmja zgjidhje për zhvendosjen, kornizat e qarta për integrim lokal apo edhe rivendosje (përfshirë skemat për ndarjen e tokës) janë ende në pritje. Kjo është një çështje posaçërisht e ngutshme pasi që me mijëra persona të zhvendosur, përfshirë edhe ata që janë zhvendosur gjatë marsit të vitit 2004, vazhdojnë të jetojnë në kushte skajshmërisht joadekuante.
- Poashtu, kthimi apo kompensimi me naturë nuk është i vetmi mjet juridik në dispozicion për humbjen e gëzimit të të drejtave pronësore si pasojë e konfliktit. Kompensimi, si mjet juridik, poashtu duhet të merret parasysh, në përputhje me parimet ndërkombëtare të banimit dhe kthimit të pronës
- Kërkohen kontaktet më efektive në terren për personat e zhvendosur nga ana e komunave, gjykatave, Agjencionit Kosovar të Pronave, organizatave joqeveritare për ndihmë juridike si dhe institucioneve të tjera të interesuara në mënyrë që të ofrohen informata më të sakta.

#### Prapavija: standaret ndërkombëtare

Përbrenda standardeve evropiane, e drejta në kthim mund të shihet si një e drejtë e prejardhur, e drejtë e ndërtuar, e bërë në thelb nga e drejta në liri të lëvizjes (Neni 2, Protokoli 4, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut), nga e drejta në pronë (Neni 1, Protokoli 1) si dhe nga e drejta e respektit për familje dhe jetë private (Neni 8). E drejta në mjet efektiv juridik për viktimat e shkeljeve të të drejtave të njeriut (gjegjësisht, Neni 13) është zhvilluar në kohët e fundit në Parimet e OKB-së për Korrigjim, të cilat e cekin kthimin e pronës si një lloj korrigimi që u takon viktimate të "shkeljeve të rënda të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe shkeljeve të rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare.<sup>3</sup> Personat e zhvendosur dhe refugiatët kanë të drejtë t'iu kthehen shtëpive të

<sup>3</sup> 'Parimet themelore dhe Udhëzimet mbi të drejtën në mjet juridik për viktimat e shkeljeve të mëdha të ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut dhe shkeljeve serioze të ligjit ndërkombëtar humanitar', Dok. i OKB-së. A/RES/60/147 (mars 21, 2006).

tyre dhe t'i riposedojnë pronat e tyre. Kombet e Bashkuara kohët e fundit kanë hartuar një tërësi standardesh përmbrojtjen e objekteve banesore, tokës dhe të drejtave pronësore në situatat pas luftës dhe i ka integruar këto në një tërësi Parimesh mbi Banimin e Kthimin e Pronës për Refugjatët dhe të Zhvendosurit (Parimet e "Pinheiro-s").<sup>4</sup> E rendësish së veçantë është e drejta në banim dhe kthim të pronës dhe e drejta në kthim vullnetar.

Qeveritë kanë përgjegjësi përfundit që i mbrojnë të drejtat pronësore dhe që ofrojnë mekanizma korrigues përfundit qytetarët e saj. Kosova ka institucionë që kanë mandat t'i zgjidhin kontestet pronësore dhe të mbrojnë të drejtën e të gjithë individëve përgjithësisht që t'është posaçëruar të tyre, ashtu siç parashikohet me standartet ndërkombëtare. Shfrytëzimi dhe funksionimi efektiv i këtyre institucioneve është me rendësi thelbësore përfundit ligjor, zhvillimit si dhe kthimit të qëndrueshëm të zhvendosurve gjatë konfliktit. Mbrotja efektive e të drejtave pronësore kërkon që të gjithë akterët të ndihmojnë përfunditligjore respektin përmes kornizës ligjore dhe institucionale në Kosovë e cila është themeluar të shtjellojë çështjen e kthimit të pronave. Komunat, gjykatat, policia, Agjencioni Kosovar përfundit Prona, shoqëria civile dhe bashkësia ndërkombëtare duhet të punojnë së bashku përfundit që këto institucionë t'ë respektohen dhe t'ë janë në gjendje ta kryejnë mandatin e tyre.

### **Konferenca mbi kthimin e qëndrueshëm të pronës dhe zgjidhjeve përfundit zhvendosjen gjatë tranzicionit**

Në konferencë kanë marrë pjesë përafersisht rreth 200 individë që përfaqësojnë një shumëlojshmëri të qjerë të grupeve të interesit, përfshirë edhe Ministrinë përfundit ambient dhe planifikim hapësinor, Ministrinë përfundit komunitete dhe kthim; zyrtarët komunal përfundit kthim; zyrat komunale të kadastrit; gjykatësit e gjykatave komunale; Zyra e UNMIK-ut përfundit komunitete, kthim dhe pakica; Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara përfundit Refugjatë; Programi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara; Zyra ndërkombëtare përfundit migrim; Zyra e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë; Agjencioni Kosovar përfundit Prona; Shërbimi Politic i Kosovës dhe organizatat joqeveritare që ofrojnë ndihmë juridike. Vlen të theksohet se gjatë konferencës ishin të pranishëm edhe shumë persona të zhvendosur dhe përfaqësues të tyre. Institucionet e Republikës së Serbisë ishin të përfaqësuara nga Ministria përfundit Kosovë dhe Metohinë dhe nga Qendra përfundit Koordinim përfundit Kosovë dhe Metohi.

Ky raport ofron një prapavijë të shkurtër të çështjes së të drejtave pronësore dhe kthimin përfundit personat e zhvendosur nga Kosova, ofron përmblehdje të pikave kyçë të cilat kanë dalë nga diskutimet në konferencë dhe detajet e rekomandimeve specifike përfundit cilat janë pajtuar pjesëmarrësit e konferencës.

### **Grupet punuese**

Gjatë konferencës, pjesëmarrësit janë ndarë në pesë grupe punuese, çdonjëra e udhëhequr nga një moderator. Çdo grup punues kishte përfundit të detyrë të diskutojë çështje specifike dhe t'ë identifikojë rekomandime përfundit t'i shqyrtuar ato:

**Grupi Punues I. qasje në banim adekuat dhe ndihmë përfundit kthim përfundit zhvendosurit.** grupi vlerësoi mënyra përfundit qushtet joadekuat t'ë banimit të personave në zhvendosje. ndihma përfundit kthim dhe reintegrim nuk është gjithnjë në dispozicion dhe nuk ka adresë të sakta përfundit të siguruar banim dhe shërbime t'ë tjera në trevat ku momentalisht jetojnë të zhvendosurit. grupi poashtu ka diskutuar përfundit mbrotjien e objekteve banesore dhe t'ë drejtave pronësore t'ë romëve, ashkalinjve dhe egjiptasve. ata i takojnë bashkësive më t'ë rrezikuara në Kosovë dhe ballafaqohen me probleme t'ë ndërrthurura që e pengojnë qasjen e tyre në kthimin e pronës dhe në kthim në përgjithësi. kushtet e tyre t'ë banimit janë në përgjithësi jo adekuate. shpesh ata jetojnë edhe në kushtet e joformalitetit: u mungon titulli i regjistruar përfundit Pronë dhe/ose dëshmi t'ë dokumentuara përfundit të dëshmuar t'ë drejtat e tyre mbi shtëpitë e veta.

**Grupi Punues II. mbrotja e së drejtës në banim dhe kthim të pronës përfundit agjencionit kosovar përfundit Prona.** agjencioni kosovar përfundit Prona (më herët drejtorati përfundit çështje banesore-pronësore) ka kompetencë t'ë zgjidh të gjitha ankesat e pazgjadhura t'ë ndërlidhura me luftën në pronët e patundshme private. është ky një institucion kyç në procesin e kthimit të pronës. përfundit që ofruar qëndrueshmëri t'ë zgjidhjeve, kërkohet një koordinim i mirëfilltë institucional përfundit gjyqësinë dhe me institucionet e tjera të Kosovës. procesi i drejtë përfundit mekanizmit t'ë mirëfilltë me t'ë gjitha resurset është një kusht pa t'ë cilin nuk bëhet, përfundit që procesi efektiv t'ë kthimit të pronave. ky grup punues ka diskutuar gjendjen aktuale dhe sfidat momentale me t'ë cilën ballafaqohen institucionit.

**Grupi Punues III: Rolet dhe përgjegjësitet e institucioneve t'ë tjera të Kosovës (gjykatat, kadastro, komunat, policia)** përfundit mbrotjien e t'ë drejtave pronësore t'ë zhvendosurve. Agjencioni Kosovar përfundit Prona nuk është i vetmi me përgjegjësi përfundit mbrotjien e t'ë drejtave t'ë zhvendosurve. Gjykatat, Regjistri i t'ë Drejtave përfundit Pronë e Patundshme, komunat dhe policia kanë rolet e tyre në ofrimin e mbrotjies adekuatës dhe në procesin e kthimit të qëndrueshëm t'ë pronave. Ky grup punues vlerësoi, në këtë kontekst, sfidat momentale ligjore dhe institucionale përfundit mbrotjien e t'ë drejtave t'ë zhvendosurve përfundit banim dhe kthim t'ë pronës, dhe përfundit kthim t'ë sigurt dhe t'ë dinjitetshëm në shtëpi.

<sup>4</sup> Këto parime formalisht janë miratuar nga Nën-komisioni i OKB-së mbi Avancimin dhe Mbrotjien e t'ë drejtave t'ë njeriut më 11 gusht 2005. (Parimet mbi banimin dhe kthimin e pronës përfundit Refugjatët dhe t'ë zhvendosurit, E/CN.4/Sub.2/2005/17).

Grupi Punues IV: Reforma ligjore duhet të ofrojë mbrojtje efektive të të drejtave. Mbrojtja adekuate e të drejtave në kohën e tranzicionit kërkon reforma domethënëse ligjore. Korniza ligjore e Kosovës është në tranzicion dhe zbrazëtitar në legjislacion mund të ndikojnë në mënyrë negative në të drejtat e të zhvendosurve. Ky grup punues vlerësoi zbrazëtitar në legjislacion dhe shqyrttoi mënyra se si të vazhdohet përpara në ofrimin e mbrojtjes më efektive të të drejtave.

Grupi Punues V: Pjesëmarrja efektive dhe mbrojtja e të drejtave të bashkësive të romëve, ashkalinjëve dhe egjiptasve. Romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit vazhdojnë të jetojnë të zhvendosur brenda dhe jashtë Kosovës tetë vite pas konfliktit dhe u takojnë grupeve më të marginalizuara. Aftësitë e bashkësive të tyre të zhvendosura për vetë-organizim janë shumë të kufizuara, u mungon përfaqësimi i fortë dhe efektiv për të bërë që zëri i tyre të dëgjohet në organet dhe mekanizmat për koordinim të kthimit. Institucionet komunale në Kosovë kanë pak informata se ku jetojnë momentalistë këto bashkësi dhe në çfarë kushtesh, dhe sa prej tyre e shqyrtojnë fare kthimin në Kosovë. Ka shumë pak aktivitete për të kontaktuar këto bashkësi të zhvendosura dhe për përfshirjen e tyre në projektet e kthimit të organizuar. Situata e pasigurt politike në Kosovë është duke e vështirësuar situatën e romëve, ashkalinjëve dhe egjiptasve të zhvendosur dhe krijon rreziqe shtesë që të mbresin pa status të shtetësisë.

## REKOMANDIMET

### Për Kryeministrin e Republikës së Serbisë

Të bëhet, si prioritet, kthimi dhe/ose ofrimi i qasjes në shënimë kadastrale dhe gjyqësore përkitazi me Kosovën të zhvendosur të cilët momentalistë gjenden në Serbi

Të zbatohen, në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës, dispozitat e "Protokollit mbi Kthimin Vullnetar dhe të Qëndrueshëm" ndërmjet UNMIK-ut/IPVQ-së/Republikës së Serbisë në vitin 2006.

Të transformohet "Protokoli i Kthimit Vullnetar dhe të Qëndrueshëm" nga një dokument udhërrëfyes i politikës në instrument obligues ligjor.

Të ndërmerren hapat për të përmirësuar bashkëpunimin teknik në sferën e drejtësisë, regjistrimit të të drejtave pronësore në patundshmëri dhe në shërbime të tjera publike me institucionet e Kosovës për të përmirësuar mbrojtjen e të drejtave të zhvendosurve.

### Për Qeverinë e Kosovës:

Të zbatohen, në bashkëpunim me Qeverinë e Republikës së Serbisë, dispozitat e "Protokollit mbi Kthimin Vullnetar dhe të Qëndrueshëm" ndërmjet UNMIK-ut/IPVQ-së/Republikës së Serbisë në vitin 2006.

Të transformohet "Protokoli i Kthimit Vullnetar dhe të Qëndrueshëm" nga një dokument udhërrëfyes i politikës në instrument obligues ligjor.

Të ndërmerren hapat për të përmirësuar bashkëpunimin teknik në sferën e drejtësisë, regjistrimit të të drejtave pronësore në patundshmëri dhe në shërbime të tjera publike me institucionet e Republikës së Serbisë për të përmirësuar mbrojtjen e të drejtave të zhvendosurve.

Në përputhje me "Standardet për Kosovën", të vazhdohet që publikisht të flitet kundër banimeve ilegale dhe shfrytëzimit të pronës dhe të avancohet zbatimi i ligjeve përkatëse.

Të hartohen dhe të zbatohen masat përlirim e përkohshëm të personave të zhvendosur nga pagesa e taksave gjyqësore, kadastrale apo taksave të tjera administrative.

Të mundësohet, në përputhje me "Standardet për Kosovën" funksionimi i vazhdueshëm i "Grupit të Interesit mbi Vendbanimet Joformale", që ka për detyrë hartimin dhe zbatimin e një strategjie dhe plani të veprimit afat-mesëm dhe afat-gjatë për tërë Kosovën (përfshirë zbatimin e legjislacionit) mbi rregullarizimin e vendbanimeve joformale dhe parandalimin e vendbanimeve të reja.

Të ofrohet, përmes Grupit të Interesit një mbikëqyrje adekuate e respektimit të dispozitave mbi vendbanimet joformale nga ana e komunave që janë parashikuar në Planin e Veprimit për Integrimin Evropian dhe në Standardet për Kosovën.

Të informohen bashkësítë e zhvendosura të romëve, ashkalinjëve dhe egjiptasve jashtë Kosovës mbi zhvillimet rreth Strategjisë së Qeverisë për integrimin e romëve, ashkalinjëve dhe egjiptasve.

Publikisht të shprehet përkushtimi përmes mbështetjen e kthimit të romëve, ashkalinjëve dhe egjiptasve të zhvendosur dhe refugjatëve.

Të ndihmohen përpjekjet e romëve, ashkalinjëve dhe egjiptasve si dhe bashkësisë së refugjatëve për krijimin e rrjetit regional për informim.

### Për Ministrinë e Drejtësisë

Të ndihmohen në bashkëpunim me Ministrinë për komunitete dhe kthim, Ministrinë serbe për Kosovën dhe me Komisionerin e Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë mundësítë për përgatitjen e një baze të dhënavë për të zhvendosurit e cila do të përdoret në gjykatat lokale dhe në institucionet e tjera relevante.

### **Për Ministrinë për Komunitete**

Të hulumtohen mundësítë përmirësimin e qasjes së personave të zhvendosur në drejtësi dhe në komunikim me institucionet kosovare.

### **Për Ministrinë e Drejtësisë**

Të organizohet një fushatë e vetëdijesimit për blerësit e mundshëm të pronës së patundshme për të parandaluar shitblerje të falsifikuara.

### **Për Ministrinë e Shërbimeve Publike**

Të hartohet procedura për të informuar titullarët e zhvendosur të pronave lidhur me ndryshimet dhe punët teknike në Regjistrin e të Drejtave të Pasurisë së Patundshme dhe të ndryshohen afatet ekzistuese kohore për të ofruar qasje mjeteve efektive administrative dhe gjyqësore juridike. Njoftimet publike duhet të publikohen në gazetat në Republikën e Serbisë.

### **Për komunat dhe ministritë e Kosovës**

Të zbatohet Ligji ekzistues mbi Eksproprijimin në mënyrë konsistente dhe në veçanti të tregohet kujdes për njoftimin e titullarëve të zhvendosur të pronave, si dhe të kompensohen në mënyrë adekuate.

### **Për Kuvendin e Kosovës**

Të vlerësohet reforma e mundur ligjore apo format tjera për të ofruar njoftim, publicitet, përfaqësim dhe qasje adekuate në mjete juridike nga ana e personave të zhvendosur dhe pjesëtarëve të bashkësive minoritare në procedurat administrative.

*Ligji mbi gjykatat:* Hartimi i dispozitave të reja që do t'i zhvlerësonin ato në fuqi lidhur me Ligjin mbi Gjykatat (1978), do të ndihmonte që të definohet më mirë ligji në fuqi në sferat në kompetencë të gjykatave, pasi që momentalisht ekziston paqartësi dhe pasiguri ligjore.

Të ndryshohet ligji në fuqi mbi obligimet (Ligji mbi Kontratat dhe Dëmet, neni 180) për të ofruar qartësi ligjore në përcaktimin e organit përgjegjës për ofrimin e kompensimit.

Të ndryshohet ligji në fuqi mbi procedurën civile për të mundësuar një sistem adekuat të njoftimit për të zhvendosurit të cilët nuk jetojnë në Kosovë

Të shqyrtohet çështja e de-nacionalizimit përmes legjislacionit adekuat.

Ligjvënësi duhet të ndryshojë procedurën për të emëruar një përfaqësues të përkohshëm. Për shembull, Ligji mbi Procedurën Kontestimore (Gazeta zyrtare e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, 4/1977 (37)) duhet të parasheh shprehimi i karakterit e jashtëzakonshëm të kësaj dispozite, dhe të kërkojë që gjykatësit të shfrytëzojnë të gjitha mjetet në dispozicion për të gjetur të pandehurin para emërimit të përfaqësuesit të përkohshëm (përfshirë përdorimin e Regjistrat Civil Qendror), si dhe të kërkohet që shpallja e emërimit të bëhet në të gjitha gjuhët zyrtare.

### **Për Komunat**

Nën udhëheqjen e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim dhe me aprovin e UNMIK-ut, të ndahet toka për programet e banimit që kanë për synim integrimin lokal të personave të zhvendosur.

Të integrohen Strategjitet komunale për kthim në Planet komunale zhvillimore duke marrë parasysh implikimet buxhetore.

Të njihen nevojat e personave të zhvendosur brenda territorit të tyre dhe të përfshihen këto në programet specifike buxhetore të komunës për të lehtësuar kushtet joadekuate të banimit.

Të integrohen vendbanimet joformale që janë ngritur që prej shumë kohësh – përfshirë ato që janë shkatërruar gjatë luftës – në planet hapësinore dhe për zhvillim urban. Të përbahen nga shfrytëzimi i tokës për qëllime të tjera. Shkatërrimi i vendbanimeve joformale i ndërlidhur me konfliktin nuk duhet të shpie në ndarjen e mëtejme të bashkësive të romëve, ashkalinjëve dhe egjiptasve.

Të arrihet përputhje me dispozitat e Standardit për Prona (Qëllimi 31) dhe të ndalojen përpjekjet e paarsyetuara për të zhvilluar tokat publike për qëllime të tjera përvëç atyre banesore nga ana e banorëve të tyre të mëhershëm. Nëse është i nevojshëm ri-zhvillimi, kompensimi apo banimi alternativ duhet t'i ofrohet të zhvendosurit.

Në rastet kur vendbanimet joformale zënë tokë publike, shtetërore apo shoqërore, të legalizohet situata e tyre, në bashkëpunim me institucionet e tjera qeveritare dhe akterët relevant ndërkombëtarë.

Nëse është e domosdoshme, të mundësohet ri-parcelizimi, dhënia e tokës në shfrytëzim, ndërrimi i tokës me

Agjencionin Kosovar të Mirëbesimit, integrimi në planet hapësinore dhe urbane dhe pranimi de fakt o i zënies afatgjate të tokës shoqërore.

Në përputhje me "Parimet e Pinheiro-s", të merren të gjitha masat administrative, legjislative dhe gjyqësore për të mbështetur dhe mundësuar kthimin në përgjithësi dhe kthimin e pronës. Kështu, atje ku pengesat teknike lidhur me mbajtjen joformale të pronës vështirësojnë kthimin, e drejtë individuale e personit të zhvendosur për t'u kthyer në shtëpi duhet të ketë prioritet mbi interesat e tjera publike, siç janë ato komerciale, rekreative apo interesat e trashëgimisë kulturore.

Të ofrojë, me të gjitha mundësitë, banim social për personat e dëbuar nga pronat banesore të cilët i plotësojnë kriteret e rezikueshmërisë sociale.

Të merren masat e veçanta për të parandaluar ndërtimin ilegal në pronat e personave të zhvendosur.

Të sigurohet financimi i mjafthueshëm për zbatimin e Strategjive komunale për kthim.

Të zbatohet Ligji mbi gjuhët, posaçërisht lidhur me gjuhën romane në komunat ku kjo është e nevojshme.

Të kyçen përfaqësuesit e bashkësisë në aktivitetet e kontaktave në terren siç janë vizitat shko-dhe-shiko.

Të përfshihen propozimet dhe rekombandimet e bëra nga përfaqësuesit e romëve, ashkalinjëve dhe egjiptasve në proceset e planifikimit siç është hartimi i Strategjive komunale për kthim dhe planeve komunale hapësinore dhe urbane.

Të kryhen aktivitete më efektive të kontaktit në terren nga ana e institucioneve komunale për romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit e zhvendosur dhe refugjatë.

### **Për Shërbimin Policor të Kosovës dhe autoritetet komunale**

T'i respektojnë dispozitat ligjore të largimit të banuesve ilegal në rastet e ri-zënies së pronave banesore pas dëbimit.

### **Për Gjykatat e Kosovës:**

Të respektohet karakteri i formës së prerë dhe i zbatueshëm i vendimeve të Komisionit të Ankesave për Çështjet Banesore-Pronësore.

Për t'iu shmangur procedurave paralele dhe kundërthënëse mbi të njëjtën pronë, gjykatat duhet ta kontaktojnë Agjencionin Kosovar të Pronës në procedurat pronësore kudo që ka indikacione se prona është kërkuar përmes Agjencionit Kosovar të Pronave.

Kryetarët e gjykatave duhet të përkujdesen që të gjithë gjykatësit të janë në dijeni për karakterin e jashtëzakonshëm të emërimit të përfaqësuesit të përkohshëm dhe nevojës për të shfrytëzuar organin kompetent administrativ ose, sipas nevojës, mjete të arsyeshme alternative për të gjetur palët para se të kalohet në emërimin e përfaqësuesve të përkohshëm.

Për këtë qëllim, kryetarët e gjykatave duhet të përkujdesen që të gjithë gjykatësit të janë në dijeni për mundësinë që ofrohet sipas Urdhèresës Administrative të UNMIK-ut 2002/16 ku autoritetet gjyqësore të UNMIK-ut mund të kërkojnë shpalosjen e të dhënave personale nga Regjistri Qendor Civil. Gjykatësit duhet të kërkojnë shërbimet e Regjistrat Qendor Civil në përpjekjet e tyre për të gjetur të pandehurit.

Gjatë emërimit të përfaqësuesit të përkohshëm për të pandehurit serb, kryetarët e gjykatave duhet të krijojnë praktikën sipas së cilës njoftimet përkatëse duhet të botohen edhe në gazetat serbe, në mënyrë që të forcohen përpjekjet e kontaktave në terren.

### **Për ofruesit e ndihmës ligjore pa pagesë**

Të zbatohen programe për t'iu ndihmuar personave të zhvendosur që jetojnë në kushtet e mbajtjes joformale të pronës për të rregullarizuar situatën e tyre përmes regjistrimit të transfereve, trashëgimive, ankesave bazuar në posedimet jo të favorshme apo metodave të tjera.

### **Për Agjencionin Kosovar të Pronave**

Të zgjatet afati për parashtrimin e ankesave për AKP-në (3 dhjetor 2007) për gjashtë muaj të tjerrë.

Të ofrohet transparencë procedurale dhe qasje informatave për të gjitha palët në ankesat e kontestuara.

Të administrojë në koordinim me komunat, shtëpitë e zbrazëta të rindërtuara, të finançuara nga organizata ndërkombëtare.

Të arrihet, në bashkëpunim me autoritetet relevante, implementimi efektiv i mandatit të tij në tërë territorin e Kosovës, përfshirë pjesën veriore të Mitrovicës.

### **Për Institutin Gjyqësor të Kosovës**

Të ofrojë trajnim intensiv mbi shtrirjen e rishqyrtimit të gjykatave në rastet kur ankesat 'A' i janë drejtuar gjykatave të rregullta nga Komisionet për Ankesat Pronësore.

Të ofrojë trajnim intensiv për të gjitha gykata komunale lidhur me kompetencat dhe jurisdikcionin e Agjencionit Kosovar të Pronave dhe Komisionit për Ankesat Pronësore.

### **Për Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm**

Të shpallet Ligji i Parlamentit të Kosovës mbi Eksproprijimin për të ofruar siguri ligjore dhe mbrojtje të të drejtave kur autoritetet publike i privojnë individët nga posedimet e tyre për interesat publike.

Të vlerësohen vendimet rreth eksproprijimit të nxjerrë nga komunat në Kosovë që nga themelimi i UNMIK-ut në mënyrë që të intervenojë duke shfrytëzuar kompetencat e rezervuara sipas nevojës, në mbrojtje të të drejtave pronësore.

### **Zyrës së UNMIK-ut për Çështjet Ligjore**

Të përshpejtohet përgatitja e legjislacionit të nevojshëm për implementimin e plotë të mandatit të Agjencionit Kosovar të Pronave, përfshirë legjislacionin e papërfunduar që rregullon kompensimin për ekzekutimin e kërkeshave rreth objekteve banesore.

### **Për zyrën e UNMIK-ut për komunitete, kthim dhe pakica dhe për Ministrinë për komunitete dhe kthim**

Të zgogëlohen kushtet e rekomanduara lidhur me madhësinë e shtëpisë për të nxitur ndërtimin e shtëpive më të vogla se 75m<sup>2</sup>, posaçërisht në vendbanimet joformale. Përndryshe, të azhurnohet rregullisht Doracaku i ndryshuar për kthimin e qëndrueshëm bazuar në mësimet e nxjerra përmes implementimit në terren.

### **Për Departamentin e UNMIK-ut për Drejtësi**

Të përgatitet propozimi bashkërisht me grupet e tjera të interesit për t'i gykuar sa më shpejtë rastet pronësore të parashtruara nga serbët kundër KFOR-it, UNMIK-ut, komunave dhe individëve të suspenduara në vitin 2004 (dhe rastet e ndërlidhura), përfshirë ndihmën gykata dhe gjkatësve, si dhe eliminimin e pengesave ligjore.

Të ndryshohen dhe kanalizohen procedurat për parandalimin e shitblerjeve të falsifikuara, siç është verifikimi i letrave të autorizimit të lëshuara në Serbi.

### **Për donatorët ndërkombëtar**

Të financohen projektet e qeverive lokale që synojnë të lehtësojnë kushtet joadekuatë të banimit të personave të zhvendosur paralelisht me procesin e kthimit. Banimi i përkohshëm joadekuat (barakat, kontejnerët) nuk duhet të bëhen zgjidhje të përhershme.

### **Për Komisionerin e Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë**

Të mundësohet një përgatitje dhe proces më transparent i përzgjedhjes së pjesëmarrësve për vizitat shko-dhe-shiko. Të mundësohet përfshirja më e madhe e përfaqësuesve të zhvendosurve në të gjitha fazat e procesit përgatitor të vizitës shko-dhe-shiko.

### **Për bashkësítë e romeve, ashkalinjëve dhe egjiptasve në Kosovë dhe për bashkësítë e zhvendosurve dhe refugjatëve jashtë Kosovës:**

Të marrin pjesë në aktivitetet e kontaktit në terren siç janë vizitat shko-dhe-shiko.

Të mundësohet një pjesëmarrje më e madhe e grave të zhvendosura në vizitat shko-dhe-shiko dhe në strukturat përkthim.

T'i kontribuojnë fuqizimit të rrjetit informativ të bashkësive të romëve, ashkalinjëve dhe egjiptasve për të zhvendosurit dhe refugjatët (përfshirë Iniciativën 6 (OJQ e romëve dhe ashkalinjëve nga Prizreni), Informativni Centar – Shoqata e Romëve dhe Egjiptasve në Mal të Zi dhe Shoqata Humanitare e Pakicave Kombëtare dhe Etnike "Bratstvo" në Beograd).

Të identifikohen përfaqësuesit përgjegjës dhe legjitim për t'i shtjelluar çështjet e interesit të njëmendëtë dhe nevojat e bashkësive te tyre si dhe të angazhohet në mënyrë më pro-aktive me institucionet komunale.

### **Për akterët ndërkombëtarë (Këshilli Danez për Refugjatë, Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë, Misioni i OSBE-së në Kosovë, Serbi, Mal të Zi dhe ish Republikën Federale Jugosllave të Maqedonisë)**

T'i ndihmojë përpjekjet e zhvendosurve dhe refugjatëve për të ndërtuar një rrjet regional. Të ndihmohet me ngritjen e kapaciteteve, të promovohen pikësynimet dhe aktivitetet e rrjetit; të ofrohet mbështetja teknike dhe financiare.

## MMPH

### KTHIMI I PRONËS, SFIDË DHE PRIORITET

Institucionet e Kosovës të përkrahura edhe nga bashkësia ndërkombëtare, çdo ditë e më shumë janë duke avancuar në proceset demokratike për zhvillimin e një demokracie të qëndrueshme, ku dominojnë ligji dhe rendi, duke pasur për synim avancimin e të drejtave qytetare, ku të gjithë komunitetet pa dallim të ndihen të barabartë para ligjit. Bazuar në punën e deritanishme, falë angazhimeve serioze të faktorëve përgjegjës dhe institucioneve relevante nuk kanë munguar as rezultatet. Një e arritur është zbatimin e standardit të VI-të që ka të bëjë me të drejtën pronësore. Ndonëse në ecjen rreth zbatimit të këtij standardi janë manifestuar vështirësi të konsiderueshme, rezultatet janë evidente dhe të prekshme.

E drejta pronësore si e drejtë e ligjshme, kthimi i pronave qytetarëve të ligjshëm nga abuzimi i kësaj të drejte dhe tjetërsimi i pronës nga e kaluara, për një kohë ishte sfidë kryesore e MMPH-së për të siguruar politika vepruese dhe strategji institucionale për një kthim të qëndrueshëm të së drejtës pronësore dhe kthimin e të zhvendosurve nëpër pronat e tyre të ligjshme. MMPH duke e parë rendësinë e kësaj çështjeje, është angazhuar për një përparrim substancial në mbrojtjen e së drejtës pronësore, duke identifikuar si sfida kryesore: zbatimin efektiv të ligjit, bashkërenditjen dhe bashkëpunimin institucional, si dhe bërjen e strategjisë për një qartësi ligjore, kompletimin e legjislacionit për të drejtën e pronës. Themelimi i Agjencisë Kosovare të Pronës, doli si një domosdoshmëri dhe nevoje imediate e kohës, me qëllim të trajtimit institucional dhe të realizimit të kësaj të drejtë, të drejtës pronësore, kthimin e pronës pronarëve legjitimë dhe realizimin e kësaj detyre, si një nga tetë standardet e njoitura për Kosovën.

Në të gjitha angazhimet tona të deritashme për zbatimin e plotë e këtij standardi, si dhe në arritjen e progresit të mëtutjeshëm nuk ka munguar mbështetja e OSBE-së dhe UNMIK-ut, shpresojmë dhe besojmë se ky bashkëpunim, nuk do të mungojë as në të ardhmen.

Gjatë periudhës njëvjeçare AKP ka shënuar progres të rëndësishëm në disa fusha. Ndër të arriturat kryesore që duhet potencuar është marrëveshja në mes Qeverisë së Kosovës dhe Agjencisë Kosovare të Pronës mbi modalitetet e skemës së qiradhënieve. Ndërkaq fakti se kjo marrëveshje ka filluar të zbatohet menjëherë dhe qysh tanë mund të prezantojmë rezultatet evidente të shënuara nga zbatimi i kësaj marrëveshje, janë argumente të një pune të suksesshme. AKP-ja ka mbyllur mbi 29000 raste të zgjidhura të kthimit të pronës pronarëve legjitimë. Kemi rritje të azhuritetit të gjykatave në zgjidhjen e kontesteve pronësore civile që kanë të bëjnë me pronën, si dhe pjesëmarrjen aktive të policisë duke zbatuar këto vendime. E arritura tjetër është në fushën e zbatimit të ligjit, me ç'rast është hartuar dokumenti për Procedurat e Standardeve Operuese, dokument ky i cili tashmë është në duar e të gjithë përgjegjësve rajonalë të Shërbimit Policor të Kosovës. Kjo do të ndikojë që policia do të jetë më aktive në veprimet e që kanë të bëjnë me uzurpimet ilegale. Janë edhe disa të arritura solide që kanë të bëjnë me zbatimin e Standardit të VI-të, si trajtimi i vendbanimeve joformale, kthimi në pronat dhe zgjidhja e problemit të banimit për komunitetin rom, i cili nga përfundimi i luftës ka jetuar në kampe, përmes ndërtimesave për banim social, Plemenitini I dhe II, Magure etj. Institucionet tona kanë bërë avancime dhe janë duke bërë, për ndërtimin e kadastres, në mënyrë që t'u ofrohet qasja të gjithë qytetarëve të Kosovës, është digitalizuar Regjistri i të Drejtave Pronësore të Patundshmërisë, si dhe ndërtimi i regjistrat kadastral të banesave.

Kthimi i pronës si një detyrë komplekse dhe ballafaqimi me sfida të shumta për një kthim të qëndrueshëm të pronës, e bëri të domosdoshëm rreshtimin e shumë faktorëve relevantë institucionalë për realizimin e kësaj të drejte. Prandaj, përvèç AKP-së që ka dalë si produkt i kësaj problematike dmth realizimit të së drejtës pronësore juridike dhe MMPH-së, si bartëse e kryesore, duhet përmend kontributin e këtyre faktorëve të bashkëpunimit të ndërsjellë: Agjencia Kadastrale e Kosovës, KGJK, UN-HABITAT-i, AKM, UNHCR, DPH, DBN, SHPK, MD, MAPL, ZKM etj.

Arritia e krijimit të një legjislacioni efektiv dhe mekanizmave efektivë për zgjidhjen e kontesteve pronësore juridike, duke e trajtuar në mënyrë institucionale realizimin e së drejtës pronësore, e konsiderojmë si element bazë për inkurajimin e kthimeve dhe trajtimin e barabartë të të gjitha komuniteteve etnike në Kosovë.



## OMBUDSPERSONI

### E DREJTA E TË ZHVENDOSURVE PËR T'U KTHYER NË PRONAT E TYRE DHE TË DREJTAT PRONËSORE

Në shumicën e vendeve demokratike, e drejta në pronë konsiderohet një e drejtë themelore dhe respektimi i kësaj të drejte paraqet një parakusht përfundimor i sundimit të ligjit dhe rendit në një vend. Me shekuj, shumë filozofë dhe shkencëtarë të ndryshëm kanë analizuar dhe zhvilluar teorinë e konceptit të pronës si një çështje qenësore përfundimore e një individu në njëren anë dhe zhvillimit të një shoqërie në anën tjetër. Koncepti i pronës mund të vështrohet në dy kuptime – atë të ngushtë dhe të gjerë. Në kuadër të këtij kuptimi të gjerë, prona përfshin një gamë të gjerë të aspiratave dhe interesave, ndërsa në kuadër të atij të ngushtë; prona identifikohet si një e mirë materiale. Si rezultat i këtij koncepti të pronës, ajo shihet si një e drejtë natyrore që rrjedh nga puna.

Në shumicën e vendeve perëndimore ku mbizotërojnë demokraci të konsoliduara, e drejta në pronë private i paraprin kërkesave të autoritetit publik. Prona mund të kufizohet përfundimor i shkaqe të vlefshme, por autoriteti si i tillë nuk mund të posedojë në mënyrë arbitrale pronën private. Kosova, si territor i qeverisur dhe administruar nga UNMIK-u, është ende në proces të ndërtimit të institucioneve të sajë demokratike.

Në të kaluarën dhe sot, paqartësitë dhe vështirësitë në zbatimin e ligjit në Kosovë ndikojnë në mbrojtjen adekuate të kësaj të drejte. Si rezultat i konfliktit në Kosovë në vitet e nëntëdhjetë, shumë kosovarë humbën jetën dhe shumë të tjerë u zhvendosën brenda dhe jashtë territorit të Kosovës. Në të njëjtën kohë, prona private, shoqërore dhe publike pësoi dëme të konsiderueshme apo riposidim arbitrar.

E drejta e të zhvendosurve përfundimor i kthyer në pronat e tyre përfaqëson një të drejtë themelore që rrjedh nga vetë natyra e kësaj të drejte. Askujt nuk mund t'i mohohet kjo e drejtë e kthimit ose t'u ndalohet personave të zhvendosur qasje në pronën e tyre, pasi që prona si e tillë konsiderohet një element thelbësor ose një kusht i domosdoshëm përfundimor i njjerut dhe shoqërisë në tërësi. Kthimi i pronës dhe kthimi i personave të zhvendosur në pronat e tyre duhet të trajtohen si çështje të ndërvanura apo si dy pjesë të së njëjtës çështje.

Gjatë dhe pas konfliktit, një numër i personave të zhvendosur, përfundimor i kthyer në pronat e tyre, konsiderohen si një numër i personave të zhvendosur, përfundimor i kthyer në pronat e tyre. Edhe pse Drejtori i Kombeve të Bashkuara përfundimor i kthyer në pronat e tyre, pasi që prona si e tillë konsiderohet një element thelbësor ose një kusht i domosdoshëm përfundimor i njjerut dhe shoqërisë në tërësi. Kthimi i pronës dhe kthimi i personave të zhvendosur në pronat e tyre duhet të trajtohen si çështje të ndërvanura apo si dy pjesë të së njëjtës çështje.

Përfundimor i kthyer në pronat e tyre, konsiderohen si një numër i personave të zhvendosur, përfundimor i kthyer në pronat e tyre, pasi që prona si e tillë konsiderohet një element thelbësor ose një kusht i domosdoshëm përfundimor i njjerut dhe shoqërisë në tërësi. Kthimi i pronës dhe kthimi i personave të zhvendosur në pronat e tyre duhet të trajtohen si çështje të ndërvanura apo si dy pjesë të së njëjtës çështje.

Përfundimor i kthyer në pronat e tyre, konsiderohen si një numër i personave të zhvendosur, përfundimor i kthyer në pronat e tyre, pasi që prona si e tillë konsiderohet një element thelbësor ose një kusht i domosdoshëm përfundimor i njjerut dhe shoqërisë në tërësi. Kthimi i pronës dhe kthimi i personave të zhvendosur në pronat e tyre duhet të trajtohen si çështje të ndërvanura apo si dy pjesë të së njëjtës çështje.

ngadalësuar krijimin e kushteve adekuate për kthim të qëndrueshëm dhe kanë dëshmuar edhe një herë që vetëm rindërtimi apo kthimi i pronës nuk janë të mjaftueshme nëse nuk ndërmerren edhe masa të tjera për të ofruar siguri dhe integrim. Si pasojë, shumë të kthyer të mundshëm, në veçanti serbët dhe romët, ngurrojnë të kthehen aty ku frikësohen për sigurinë e tyre.

Në mënyrë që të tejkalohen këto vështirësi dhe frika, Ministria për komunitete dhe kthim duhet të kyçet më shumë, ashtu siç duhet edhe koordinatorët në nivel lokal të cilët duhet të punojnë që kthimin ta bëjnë më të qëndrueshëm dhe më përfshirës. Kjo nënkupton krijimin e sistemit funksional për mbrojtjen e të drejtave pronësore. Për këtë qëllim, institucionet e lartë-përmendura duhet të formojnë një aleancë të gjerë dhe të strukturuar mirë.

Lidhur me kthimet, rindërtimi i shtëpive të shkatërruara paraqet një sfidë tjetër për autoritetet publike në Kosovë. Shumica e shtëpive të shkatërruara para apo gjatë vitit 1999 janë rindërtuar nga donatorët ndërkombëtar deri në vitin 2002. Më pastaj, komunat janë zotuar të ndërmarrin masa për këtë çështje, por deri tash nuk kanë qenë aq të suksesshëm, kryesisht për shkak të mungesës së fondeve. Ashtu siç është cekur edhe në Raportin Special të Institucionit të Ombudspersonit Nr. 12, shumica e komunave në Kosovë (me përjashtim të komunës së Prizrenit) nuk kanë ndërmarrur asnjë veprim për rindërtimin e shtëpive të cilat nuk janë rindërtuar deri në vitin 2002. Në raportin e lartpërmendur, ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit prandaj ka rekomanduar që autoritetet komunale, në bashkëpunim me qeverinë e Kosovës, të përgatisë strategjitet se si t'i rindërtojë këto shtëpi, shumica prej të cilave janë dëmtuar pjesërisht apo tërësisht. Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit sugjeroi që masat e tillë do të mund të nënkuptojnë sigurimin e fondeve nga donatorët apo të fondeve speciale nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës. Deri tash, nuk është ndërmarrur asnjë masë në përgjigje të këtij reporti, qoftë nga autoritetet përkatëse komunale qoftë nga ato qendrore.

Pasiguria në sferën e ligjit si dhe mungesa e infrastrukturës domethënëse ligjore deri tash i kanë kontribuar situatës kaotike të të drejtave pronësore në Kosovë sot. Siç është rasti gjithmonë me të drejtat e njeriut, e drejta në pronë dhe posaçërisht e drejta e të kthyerve në pronë varet dhe është e ndërlidhur me sigurinë dhe me respektimin e të drejtave ekonomike, shoqërore dhe kulturore.

Garantimi i pacuneshmërisë së të drejtave pronësore në Kosovë është ende një sfidë e madhe për shkak të një varg burimesh të ligjeve dhe mekanizmave përfunksionimin dhe mbrojtjen e të drejtave pronësore. Në këtë kontekst, burimet njerëzore të angazhuara në këto sfera po ashtu janë ose të pamjaftueshme ose nuk menaxhohen në mënyrë efektive.

Në këtë drejtim, shoqëria kosovare, institucionet publike, institucionet e specializuara, OJQ-të e ndryshme dhe organet tjera ndërkombëtare duhet të konsolidojnë dhe të themelojnë një strategji të përbashkët për krijimin e kushteve adekuate për zbatimin e sundimit të ligjit në sferën e të drejtave pronësore, posaçërisht të të drejtave të ndërlidhura me të zhvendosurit dhe të drejtat e tyre për kthim në shtëpitë dhe pronat e tyre.



**UNHCR**  
**i dhe të drejtat pronësore, banesore dhe të tokës**

Përfshtirja e UNHCR-it në riatdhesimin vullnetar të refugjatëve është një funksion thelbësor që buron nga mandati jonë për mbrojtjen ndërkombëtare të refugjatëve dhe kërkimin e zgjidhjeve të qëndrueshme për çdo refugjat. Me kalimin e viteve, mandati i UNHCR-it është fuqizuar edhe më tej nga rezolutat e ndryshme të Asambleës së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara për t'u kyçur në mbrojtjen e të zhvendosurve intern. Sfidat kryesore të UNHCR-it përkitazi me kthimin, qoftë të refugjatëve apo të të zhvendosurve janë të avancojë kushtet për kthimin vullnetar, të mundësojë ushtrimin e zgjedhjes së lirë dhe të informuar dhe të mobilizojë mbështetje për të realizuar kthimin e suksesshëm. Kthimi i suksesshëm kërkon qasje të menjëhershme shërbimeve themelore si dhe mjeteve për ta bërë kthimin të qëndrueshëm. Për çdo të kthyer, qasja në tokat, shtëpitë dhe pronat e tyre është një prioritet.

Personat fizik dhe juridik kanë të drejtë te janë pronar, të posedojnë dhe të shfrytëzojnë të gjitha llojet e pronës, përfshirë pronën banesore dhe komerciale si dhe atë bujqësore. Mbajtësi i të drejtave pronësore mund t'i transferojë të gjitha apo ndonjëren prej këtyre të drejtave të tjerëve. Autoritetet mund të ndërhyjnë, të privojnë nga kontrolli i shfrytëzimit të të drejtave pronësore për ndonjë person nëse ndërhyrja e tillë parashihet me ligj, nëse i shërben ndonjë qëllimi legjitim ose nëse është në interes të përbashkët dhe siguron një baraspeshë të drejtë ndërmjet interesave të bashkësisë dhe mbrojtjes së të drejtave individuale në fjalë.<sup>5</sup> Të drejtat pronësore janë ngushtë të ndërlidhura me të drejtat e njeriut, në mes të tjerëve “të drejtën në banim adekuat”, “të drejtën në qytet”<sup>6</sup>, “lirinë e lëvizjes”, “të drejtën në siguri” dhe “mos-diskriminim”.

E drejta e refugjatëve dhe personave të zhvendosur për t'u kthyer në shtëpitë e tyre njihet gjithnjë e më shumë si e drejtë e veçantë, e pavarur dhe në vete nga bashkësia ndërkombëtare. Edhe pse gjëzimi i të drejtave pronësore është një e drejtë e rëndësishme e njeriut që luan një rol të dalluar në procesin e kthimit, ekzistojnë edhe faktorët e tjerë siç është siguria, liria e lëvizjes, qasja në shërbime dhe qasja në aktivitetet fitim-prurës të cilat në fund janë vendimtare nëse personi vendos apo jo të kthehet (me apo pa të drejta të konfirmuara pronësore).

Në Kosovë, sipas Rezolutës së Këshillit të Sigurimit 1244/99, UNHCR-i ka mandat të mbikëqyr kthimin e sigurt dhe të dinjitetshëm të refugjatëve dhe të të zhvendosurve. “Siguria”, në mes të tjerëve do të thotë “siguria materiale”, ku përfshihet qasja në pronë dhe strehim, dhe “siguria ligjore” ku përfshihet siguria e poseditmit dhe konfirmimi i të drejtave pronësore. Në përputhje me këtë rol, UNHCR-i kryen aktivitete vijuese në sferën e të drejtave pronësore në Kosovë:

- UNHCR-i avokon dhe monitoron legjislacionin mbi pronën dhe zbatimin e saj nga autoritetet kompetente për të parë nëse këto janë në përputhje me ligjin dhe standartet e të drejtave të njeriut dhe lejojnë kthimin e sigurt dhe të dinjitetshëm të popullatës së zhvendosur;
- UNHCR-i avokon një kornizë efikase dhe efektive institucionale në sferën e të drejtave pronësore;
- UNHCR-i, përmes partnerit të tij implementues “Projekti për të drejtat civile – Kosovë” (CRP-K), ofron këshilla ligjore dhe ndihmë lidhur me pronën personave për të cilat UNHCR-i është i brengosur. Përveç kësaj, UNHCR-i finançon ofruesit e ndihmës juridike në Serbi (Praxis) dhe Mal të Zi (Qendra juridike/ CRS);
- Aktivitetet e UNHCR-it në ngritjen e kapaciteteve për autoritetet komunale në kontekst të kthimit vullnetar dhe të qëndrueshëm përfshin mbrojtjen e të drejtave pronësore.
- UNHCR-i kontribuon në mënyrë pro-aktive – ndër të tjera, edhe përmes caktimit të stafit të specializuar për çështjet pronësore dhe ushtron funksion koordinues – për të krijuar kushte për kthim për projekte specifike për kthim, zbatimi i suksesshëm i të cilëve, për shkak të numrit të të kthyerve dhe/ose rëndësissë politike të projektit, mund të nxisin procesin e përgjithshëm të kthimit. Kthimi në Mahallën Rome dhe Njësia për mbrojtje/çështje ligjore e Mekanizmit koordinues është një shembull i kësaj.

Në ushtrimin e mandatit të tij mbikëqyrës, UNHCR-i ka bërë vrojtime vijuese për procesin e kthimit të pronave lidhur me kthimin:

<sup>5</sup> Shih *ndër të tjera Nenin 1, Protokollin 1 të Konventës evropiane të të drejtave të njeriut*

<sup>6</sup> Në bazë të “së drejtës në qytet” çdo person në qytet apo komunitet ka të drejtë të jetë një anëtar i barabartë i komunitetit.

Të favorshme për kthimin:

- Janë vënë në zbatim mekanizmat speciale (HPCC/KPCC) për vendimet lidhur me pretendimet pronësore dhe zbatimin e tyre (HPD/AKP).
- HPD dhe AKP punojnë në bashkëpunim të ngushtë me UNHCR-in (p.sh koordinim/pjesëmarrje në vizitat shko dhe shiko/shko dhe informo, dhënia e prioritetit për pretendimet pronësore të të zhvendosurve, dhënia e shtëpive/banesave të braktisura personave për të cilat brengoset UNHCR-i, shkëmbimi i përgjithshëm i informatave).

Pengesat për kthim

- Vendim-marrja zgjat disa vite dhe shihet si e “ngadalshme” nga personat e zhvendosur.
- Zbatimi i vendimeve nuk është gjithnjë i qëndrueshëm (p. sh. incidentet pas dëbimeve, rizëniet).
- Procesi i kthimit të pronave shihet si shumë i politizuar nga të zhvendosurit intern.
- Çështjet e banimit, tokës dhe pronës nuk shtjellohen në mënyrë sistematike/gjithëpërfshirëse. HPD-ja dhe AKP-ja janë organe ligjore, të specializuara dhe teknike dhe nuk u është dhënë roli i hartimit të politikave/roli këshillues apo koordinues për shkak të mandatit dhe burimeve të kufizuara.
- Aspektet humanitare dhe sociale të ndërlidhura me të drejtat pronësore në procesin e kthimit siç janë të pastrehët dhe të ata pa tokë nuk janë shtjelluar në mënyrë sistematike përkizati me ndarjen e tokës apo shtëpisë, por në një mënyrë ad hoc dhe kur këto ishin të ndërlidhura me projektet specifike të kthimit. Shembuj të kësaj janë Kthimi në Mahallën rome në Mitrovicë dhe banesat sociale për romët, ashkalinjët dhe egjiptasit e zhvendosur në Plementinë.

Prandaj, kërkohet një reagim koherent sistematik për t'i mbuluar të gjitha çështjet e ndërlidhura me banimin, pronën dhe tokën (p. sh. qasaja në banim adekuat; reagim efektiv ndaj incidenteve të sigurisë pas dëbimit; politikat e rindërtimit; strehimi social; ankesat lidhur me pronën banesore, bujqësore apo komerciale të gjykohet në mënyrë efektive/të drejtë). Momentalisht, një gamë e gjerë e akterëve vendor dhe ndërkombëtar merren me çështjet e ndryshme pronësore në Kosovë bazuar në instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, rregulloret e UNMIK-ut, Planit për Implementimin e Standardeve në Kosovë (më herët) dhe tash Planit të Veprimit për Partneritetin Evropian. Me dorëzimin e vazhdueshëm të kompetencave nga autoritetet lokale tek ato vendore, nevoja për një organ qendror koordinues dhe për hartimin e politikave është edhe më e madhe në mënyrë që të shtjellohen mospërputhjet dhe mangësitë.



## KPA

### Implementimi i Mandatit të KPA-së – Sfidat për të ardhmen

Që nga krijimi, Agjencia Kosovare e Pronës është dashur të ballafaqohet me sfida të ndryshme, ku përgjegjësitë i kishte trashëguar nga paraardhësi i saj, ish Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore ('HPCC'), e gjithashtu edhe zhvillimin dhe konsolidimin e rregullave dhe procedurave të reja për zgjidhjen e pronave të patundshme private. Gjersa disa nga to ende qëndrojnë, janë shfaqur edhe sfida të reja. Kjo me siguri do të rritet, veçanërisht si proces i zgjidhjes që rrjedhin momentalisht. Artikulli aktual kërkon që qartësish të adresoj disa sfida aktuale dhe të ardhshme të KPA-së.

### Përfshirja/Roli i Gjykatës Supreme të Kosovës

Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 ofron të drejtën e ankesës ndaj vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore ('PCC') në Gjykatën Supreme. Kjo në vetvete kërkon zhvillimin e marrëdhënieve komunikuese mes institucioneve përkatëse e gjithashtu edhe si procedurë ku sipas rastit mund t'i referohen Gjykatës Supreme përmes KPA-së.

Është thelbësore se Gjykatës Supreme plotësisht i është dhënë e drejta të merret me kompleksitetin dhe numrin e mundshëm të rasteve që do t'i dërgohen. Duke ditur që vendimet e PCC-së, të cilat janë objekt i ankesës, nuk mund të implementohen derisa nuk e konfirmon Gjykata Supreme, ku shpejtësia e shpalljes së aktgjykimit është e rëndësishëm së madhe dhe vendimtare për përbushjen e suksesshme të mandatit të KPA-së.

### Implementimi i vendimeve të KPCC-së

Neni 15 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 përmban llojet e ndihmave ligjore të cilat janë të mundura për paraqitësit e suksesshëm të kërkesave, veçanërsith, dëbimin; vënien e pronës nën administrim, marrëveshjen mbi qiranë, konfiskimin dhe demolimin e ndërtimeve të paligjshme dhe ankandin. Regjistri në asnjë mënyrë nuk do të ngushtohet dhe do të zgjerohet tutje me qëllim të ofrimit të direktivave për ndihmat ligjore dhe si duhet të aplikohen ato.

Mësimet e mësuara nga implementimi i vendimeve të HPCC-së ofrojnë mprehtësi të mjaftueshme për përgjigjet e mundshme ndaj vendimeve të HPCC-së, veçanërisht nga komuniteti vendor dhe institucionet qeverisëse. Gjersa shumica dërmuese e vendimeve të HPCC-së ishin implementuar me lehtësi relative, qëndrimi politik ishte i zakonshëm në lidhje me rastet që ishin politikisht të ndjeshme, gjithashtu edhe nga p.sh palët të cilat ishin të përfshira në kontestin juridik apo në lokacionin e pronave. Kjo kishte efekt në mundësinë e HPD-së për të zbatuar vendimet, efekt i cili gjithashtu haset nga KPA, e cila ka trashëguar përgjegjësit e pazgjidhura në lidhje me implementimin dhe zbatimin e vendimeve të HPCC-së. Para se KPA të filloj implementimin e PCC-së/Gjykatës Supreme, është thelbësore që është arritur uniteti i qëllimeve me të gjitha palët e interesuar. Si plotësim mbështetja e deklaruar publikisht nga institucionet ndërkombëtare dhe vendore është e nevojshme.

### Bashkëpunimi me Agjencitë e Jashtme

Mungesa e qasjes në hartat digitale dhe të dhënrat kadastrale që i ka në disposicion Agjencia Kosovare Kadastrale (AKK) ka penguar aftësitë e KPA-së për të gjetur lokacionin e pronave që janë objekt i kërkesës. Kjo ka sjellë irritim nga AKK e cila ka kushtëzuar bashkëpunimin e saj me pagesën e tarifës në vlerën e tregut. Më vonë, gjithashtu pasi që ishte shkelje e Nenit 4.2 të Aneksit II të Urdhëresës Administrative Nr. 2007/5, ndikojnë negativisht në mundësit e KPA-së për vendosur fizikisht njoftimin për kërkesën në pronën në fjalë. Kjo është pjesë integrale e procesit të KPA-së, i cili mund të ecë para vetëm nëse dhe gjersa prona të jetë identifikuar. Ashtu që kjo çështje zvogëlon efikasitetin e procesit të kërkesave dhe prolongon afatet e KPA-së.

### Komunikimi i Pohuar me Paraqitësit e kërkesës

Për t'i mbajtur të njoftuar paraqitësit e kërkesës dhe palët përgjegjëse për të gjitha zhvillimet e progresit të kërkesës, KPA është e vetëdijshme për informatat kontaktuese të ofruara në zyrat përkatëse me qëllim që të bëhet diç e tillë. Shumica e dërmuese e paraqitësve të kërkesave në KPA, megjithatë, janë persona të zhvendosur jashtë Kosovës (përafersisht 91%) dhe në disa raste nuk kanë vendbanim të caktuar. Kjo ka kuptim të pandryshueshëm se detalet kontaktuese të ofruara në kohën kur është paraqitur kërkesa janë të pamjftueshme apo objekt i ndryshimit pa njoftim të mëtutjeshëm. Ashtu që KPA është e vetëdijshme për vizitën e Paraqitësve të kërkesave zyrave të KPA-së, siç është ajo e cila gjendet në Beograd, për t'u përditësuar. Për paraqitësit e kërkesave që është e pamundur të kontaktohen me postë apo telefon, KPA do të vazhdoj operacionet e saj jashtë Kosovës, qartësish me ndërlirimet shtesë buxhetore.

## **Financimi**

Kur ishte themeluar KPA ishte bërë kështu si një entitet i pavarur i Institucioneve të Përkoħshme Vetēqeverisëse dhe UNMIK-ut. Si rezultat është tērësisht i pavarur në gjetjen e fondit të vet pér operimet e saja, një akt i cili është arritur me ndihmën e komunitetit ndërkombëtar dhe bugjetit të konsoliduar të Kosovës.

Në kohën e shkruarjes ka një mungesë të rreth 6 milion eurove në bugjetin e KPA-së pér pjesën mbetëse të vitit dhe tjetrin. Kjo më tepër se çdo gjë tjetër mbetet sfida më e madhe në KPA, me sfidat e tjera në mënyrë efikase duhet të diskutohen por këto nuk do të zgjidhen në një të ardhme të afërt. Pa burime adekuate, KPA do të jetë e detyruar të ndërpren operimin. Si actor kryesor përgjegjës pér adresimin e të drejtave pronësore në Kosovë, pasojat e kësaj do të janë të rënda pér paraqitësit e kërkeseve dhe pér procesin e kthimit, si dhe zbatimin e sundimit të ligjit. Përveç kësaj, kjo do të krijonte mungesë të besimit lidhur me investimin ekonomik, pér të cilën siguria e të drejtës pronësorë është vendimtare.

Stabiliteti i Kosovës, politikisht dhe në të kundërten dhe implementimi i suksesshëm i mandatit të KPA-së janë të lidhura ngushtë. Aftësia e KPAs pér të operuar me sukses, në veçanti lidhur me implementimin e vendimeve, varet pa marrë parasysh apo jo nga klima politike në Kosovë mbetet stable dhe progresive. Duke i dhënë rendësinë e të drejtave pronësore në Kosovë, suksesi dhe dështimi i KPA-së pér të tejkular sfidat të përmendura më lartë, mund të ndikoj në mjedisin politik dhe ka ndikim në mirëmbajten e stabilitetit.



## SEKTORI I OSBE-së PËR PRONA

### JU JENI TË ZHVENDOSUR, TË DREJTAT TUAJA NUK JANË: PËRVOJAT E KOSOVËS NË JETËSIMIN E TË DREJTAVE TË TË ZHVENDOSURVE NË BANIM DHE KTHIM TË PRONËS

Zhvendosja i vë individët në një situatë jashtëzakonisht të rrezikuar. Ndihmë të zhvendosurve në rimarrjen e pronave të tyre, në kthimin në shtëpi ose, sipas nevojës, në rivendosje është proces i domosdoshëm për të rikthyer dinjitetin njerëzor dhe për të nxitur paqen. Mirëpo, kthimi i pronës dhe kthimi në përgjithësi janë detyra të shtrenjta dhe komplekse të cilat kërkojnë mbështetje domethënëse politike, planifikim të kujdeshëm strategjik, disponueshmëri të resurseve, kryje të bashkësive të të zhvendosurve dhe, ndoshta më me rëndësi, një kornizë adekuate normative dhe operacionale e cila në njëren anë ofron mjete efektive juridike për shqyrtim dhe implementim masiv të ankesave pronësore dhe në anën tjetër ofrimin më kohë të ndihmës në banim dhe rindërtim.

Krahasimi i rezultateve të programeve për kthim të pronës, kthimin në përgjithësi dhe ato për rivendosje me shkallën tmerruese masive të zhvendosjes në nivel global nuk jep arsyen për shumë optimizëm. Mirëpo, zhvillimet e paradokohshme inkurajuese në standartet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut – gjegjësisht, “Parimet e Pinheiro-s” të vitit 2005 të lëshuara nga Nën-komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, dhe “Parimet e Korrigjimit” nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, si dhe intervenimet relativisht të suksesshme ndërkombëtare në Ballkan pasqyrojnë një trend pozitiv.<sup>7</sup> Kjo së pari shtron pyetjen se *deri në çfarë mase kanë qenë të suksesshme instrumentet që janë zbatuar në Ballkan në arritjen e synimeve të tyre dhe së dyti nëse këto janë opsione të zbatueshme edhe për konfliktet e tjera, posaçërisht kur në këto skenare të tjera mungon pushteti ekzekutiv dhe pushteti i gjerë që bashkësia ndërkombëtare ka pasur në Ballkan.*

Gjatë dy dekadave të fundit, në regionin e Ballkanit janë vënë në zbatim formula të ndryshme për realizimin e të drejtave të personave të zhvendosur për t'u kthyer në shtëpi dhe për rimarrjen e pronave të tyre. Duke lënë anash rastin specifik të Kroacisë, Bosnja e Hercegovina dhe Kosova janë rastet më relevante. Në mbarim të të dyja luftërave, janë themeluar organe kuazi-juridike ad hoc për të mundësuar zgjidhjen e lëndëve të shumta pronësore që kanë rrjedhur nga çdo konflikt. Për më tepër, për t'u mundësuar të zhvendosurve qasje në ndihmë për kthim dhe rindërtim, zhvillimi i projektit është bërë në nivel komunal dhe qendror dhe janë themeluar strukturat implementuese. Mirëpo, në të dyja vendet, korniza institucionale është karakterizuar nga prania e jashtëzakonshme e autoritetit ndërkombëtar me pushtet special (Zyra e Përfaqësuesit të Lartë në Bosnjë dhe Hercegovinë, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm në Kosovë). Të dy akterët kanë pasur pushtet të ndihmojnë në mundësimin e kthimit për të zhvendosurit dhe kthimin e pronës së tyre, ashtu siç përcaktohet edhe nga Marrëveshja e Dejtonit për Bosnjën dhe Hercegovinën e vitit 1995 edhe nga Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244 në Kosovë.<sup>8</sup>

Përderisa në shembullin e Bosnjës, Komisioni për Ankesa ne Pronën e Patundshme dhe Plani për Implementimin e ligjit mbi pronat zakonisht prezantohen si suksese të përgjithshme, rasti i Drejtoretit Kosovar për banim dhe prona/Komisioni kosovar për çështje banesore dhe pronësore (tash Agjencioni Kosovar i Pronave) vazhdojnë të jenë sfida.<sup>9</sup> Prandaj, mbrojtja e të drejtave të të zhvendosurve në banim dhe kthim të pronës dhe në kthim në shtëpi është realizuar vetëm pjesërisht për bashkësitetë minoritarë (serbët, romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit).

Kështu, me mijëra mbesin të zhvendosur edhe brenda edhe jashtë Kosovës, shpesh në kushte joadekuante në strehimore kolektive ose rrinë në ndërtesa të papërfunduara me infrastrukturë të dobët dhe kushte jo të shëndetshme sanitare. Befasisht, ndihma për rivendosje gati që nuk ekziston. Tetë vite pas konfliktit, dhe për

<sup>7</sup> “Parimet themelore dhe udhëzimet mbi të drejtën në mjete juridike dhe korrigjimi për viktimat e shkeljeve të mëdha të Ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut dhe shkeljet serioze të ligjit ndërkombëtar humanitar”, UN Doc. A/RES/60/147 (mars 21, 2006). Shih Nën-komisioni i OKB-së për të Drejtat e Njeriut “Banimi dhe kthimi i pronës në kontekst të kthimit të refugjatëve dhe të zhvendosurve intern” (Parimet e Pinheiro-s) E/CN.4/Sub.2/2005/17, 28 qershori 2005: “E drejta në kthim të pronës ekziston si e drejtë e veçantë, dhe nuk rrezikohet as nga kthimi dhe as nga mos-kthimi i refugjatëve dhe të zhvendosurve që kanë të drejtë në banim, tokë dhe kthim të pronës.”

<sup>8</sup> Neni 1, Shtojca VII e Marrëveshjes së Dejtonit parashev që: “Të gjithë refugjatët dhe personat e zhvendosur kanë të drejtë të kthehen lirshëm në shtëpitë e tyre të origjinës. Ata kanë të drejtë t'u kthehen pronat nga të cilat janë privuar gjatë armiqësive të vitit 1991 dhe të kompensohen për çfarëdo prone e cila nuk mund t'ju kthehet”. Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244 vërteton “të drejtën e të gjithë refugjatëve dhe të zhvendosurve të kthehen në shtëpitë e tyre në siguri”. Kthimi i papenguar i refugjatëve dhe të zhvendosurve është përgjegjësi i pranisë ndërkombëtare civile dhe asaj ushtarakë.

<sup>9</sup> Shih Regulloren e UNMIK-ut Nr. 2000/60 mbi Ankesat rreth Objekteve Banesore dhe Rregulloren e Punës dhe Dëshmitë e Drejtoretit për Çështje Banesore-Pronësore dhe Komisionit të Ankesave për Çështjet Banesore-Pronësore, si dhe Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2006/50 mbi zgjidhjen e lëndëve që kanë të bëjnë me Pronën e Patundshme Private, përfshirë Pronën Bujqësore dhe Komerciale, të cilat mund të gjinden në [www.unmikonline.org](http://www.unmikonline.org).

shkak të frikës dhe mungesës së perspektivës, të zhvendosurit nuk janë kthyer. Një pjesë e madhe e vendimeve të Komisionit të Ankesave për Çështjet Pronësore-Banesore nuk kanë rezultuar në riposédimin e shtëpisë nga titullari i patundshmërisë (të cilët në përgjithësi nuk janë të gatshëm të kthehen për shkaqe sigurie dhe shkaqe të tjera) por vetëm në shijë të pronës ose në administrimin e saj të përkohshëm të priti të një zgjidhjeje më të mirë.<sup>10</sup> Ky fakt vë në pikëpyetje deri në njëfarë mase efektivitetin domethënës të mjetit juridik që ofrohet – riposédimi dhe/ose administrimit të përkohshëm. Arsyet që procesi i Drejtoretit për Çështje Banesore-Pronësore/Komisionit të Ankesave për Çështjet Banesore-Pronësore nuk shpie në kthim janë të shumta. Së pari, mungesa fillestare e resurseve ka zvogëluar në masë të madhe shqyrtimin e ankesave në fazat e hershme duke humbur në këtë mënyrë një shtytje kyçë. Së dyti, një e treta e lëndëve të implementuara ka rezultuar në thëniet deklarative lidhur me pronën e shkatërruar, duke mos ofruar asnjë mjet tjetër juridik. Në këtë drejtim, riposédimi nuk është një mjet adekuat juridik në mungesë të lirisë së lëvizjes. Kjo, në anën tjetër, hap pyetjen e kompensimit si një alternativë të mundshme. Në Kosovë, kjo nuk është ofruar. Gati njëzet mijë lëndë për kompensim qëndrojnë të suspenduara me kërkesë të UNMIK-ut. Më me rëndësi, për shkak të një vendimi fillestari me të cilën lëndëve banesore u është dhënë prioritet ndaj lëndëve që merren me tokë, lëndët nga prona bujqësore dhe komerciale nuk janë shtjelluar si duhet deri në vitin 2006, kur është zgjeruar mandati i Drejtoretit për Çështje Banesore-Pronësore/Komisionit të Ankesave për Çështjet Banesore-Pronësore përmes transformimit të saj në Agjencionin Kosovar të Pronave. Agjencionin Kosovar i Pronave është një strukturë e ngjashme me Drejtoretin për Çështje Banesore-Pronësore/Komisionin e Ankesave për Çështjet Banesore-Pronësore. Ka një mandat më të gjërë si dhe mundësinë e shqyrtimit gjyqësor nga ana e Gjykatës Supreme. Për më tepër, Bordi Mbikëqyrës me udhëzime administrative dhe të politikës siguron pjesëmarrjen e qeverisë lokale (pa ndërryrë në punën e Komisionin për Ankesa Pronësore). Sfida kryesore për institucionin deri tash është financimi i tij. Kufizimet buxhetore kanë ndikuar në funksionimin e Drejtoretit për Çështje Banesore-Pronësore/Komisionit të Ankesave për Çështje Banesore-Pronësore) (dhe sot Agjencionit Kosovar të Pronave) që nga krijimi i saj. Në ndërkohë, grumbullimi i lëndëve vazhdon dhe tash ka arritur deri në 30,000 raste, që është më shumë se dyfishi i parashikuar.<sup>11</sup>

Sferat tjera të brengosjes që ndikojnë në mbrojtjen e të drejtave të të zhvendosurve janë zhvendosja dhe humbja e shënimëve kadastrale dhe gjyqësore, falsifikimi i dokumenteve pronësore (përfshirë letërnjoftimet që përdoren në këto transaksione të falsifikuara) si dhe kryerja e eksproprijimeve nga ana e autoriteteve lokale pa plotësuar kushtet e parashikuara për verifikimin, njoftimin dhe kompensimin e titullarëve të pronave (të cilët ndonjëherë janë persona të zhvendosur).<sup>12</sup>

## Kthimet e pakicave

Procesi i kthimit në Kosovë ishte një sukses i konsiderueshëm për pjesën më të madhe të popullatës shqiptare. Refugiatët shqiptarë dhe personat e zhvendosur janë kthyer në numër të madh pas hyrjes së trupave të Forcës Kosovare në vitin 1999 dhe me ndihmë të madhe ndërkombëtare në rindërtim. Mirëpo, kthimi i bashkësive të zhvendosura minoritare (në rend të parë asaj serbe, dhe në numër më të vogël bashkësive rome, të ashkalinjëve dhe egjiptasve) është vështirësuar nga brengat e siguri, mungesa e perspektivës ekonomike, presionit politik nga autoritetet beogradase, ndërsa në rastin e romëve, ashkalinjëve dhe egjiptasve – të cilët jetonin edhe para lufës në vendbanime joformale – mungesa e titullit të regjistruar, dokumenteve ose në përgjithësi mbajtjes së sigurt të pronave. Përpjekjet për të vënë në funksion obligimet e së drejtës në banim dhe sigurimi i ndarjes së titullit të tokës për romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit pa prona në përgjithësi nuk ishin të suksesshme, me përjashtim të “Mëhallës Rome” në qytetin e ndarë të Mitrovicës.<sup>13</sup>

## Konkluzionet

Edhe pse është e vështirë të identifikohen mësimet e nxjerra nga shembulli i kthimit të pronave në Kosovë, të cilat mund të ishin të vlefshme në skenare të tjera, është e qartë se një mekanizëm për ankesa masive bashkë me strukturat për kthim dhe rindërtim ka më shumë gjasa t'i shërbejë të zhvendosurve nëse merren parasysh të gjithë faktorët në fazat e hershme të konceptimit dhe planifikimit. Gjetja e mjeteve më efektive juridike për çregullimet

<sup>10</sup> Shih reportin e Misionit të OSBE-së në Kosovë të lëshuar në qershor 2007 “Tetë vite më pas: kthimi i pakicave dhe kthimi i objekteve banesore dhe pronës”, në [www.osce.org/kosovo](http://www.osce.org/kosovo).

<sup>11</sup> Shih ueb faqen e Drejtoretit për Çështjet Banesore-Pronësore dhe Komisionin e Ankesave për Çështjet Banesore-Pronësore ([www.hpkosovo.org](http://www.hpkosovo.org)) dhe ueb faqen e Agjencionit Kosovar të Pronave ([www.kpaonline.org](http://www.kpaonline.org)).

<sup>12</sup> Shih reportin e Misionit të OSBE-së në Kosovë mbi ‘Eksproprijimet në Kosovë’ (dhjetor 2006).

<sup>13</sup> Rindërtimi i lagjes nënkuptonte ndarjen e 3.5 hektarëve tokë shoqërore për t'i vendosur ish banorët pa titull të regjistruar, ridefinimin e planeve urbane dhe një skemë të veçantë të banimit me të drejta të kufizuara shfrytëzimi.

e shkaktuara nga konflikti është një sfidë më e madhe. Bashkërisht me këtë, të gjitha opzionet për mekanizmat alternative të zgjidhjes së kontesteve (përfshire ndërmjetësimin), mjetet juridike (përfshire skemat për kompensim) dhe dhënia e tokës dhe banimit (përfshire tituj të ri sipas nevojës) duhet të shqyrtohen në mënyrë të themeltë.

Struktura e zhvillimit dhe implementimit të projekteve për kthimin e pakicave nuk ka dhënë rezultatet e pritura, përkundër të gjitha përpjekjeve. Bartja e kompetencave nga autoritetet ndërkombëtare në ato vendore, në përputhje me bartjen e përgjithshme të kompetencave nga Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë tek institucionet kosovare nuk ka përmirësuar situatën. Lëvizje pozitive, megjithatë, është shënuar në drejtim të kyçjes së vazhdueshme të personave të zhvendosur në proces. Mundësitet e integruaratë kthimit të personave dhe kthimit të pronave, siç është implementimi masiv i vendimeve në ndonjë lokacion të caktuar mund të jetë i dobishëm. Pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara në planifikimin strategjik dhe implementimin e programeve të tilla është gjithnjë i një rëndësi të jashtëzakonshme. Ata janë më se të vetëdijshtëm se edhe pse ata janë të zhvendosur, të drejtat e tyre nuk janë.



## DIVIZIONI I OSBE-së PËR KOMUNITETE

### ZGJIDHJET E QËNDRUESHME ENDE NË PRITJE: SFIDAT E PAZGJIDHURA PENOJNË KTHIMIN E PRONËS DHE KTHIMIN E QËNDRUESHËM TË ROMËVE, ASHKALINJËVE DHE EGJIPTASVE

Nuk është bërë sa duhet: e drejta e romëve, ashkalinjëve dhe egjiptasve të zhvendosur për kthim dhe rimarrje të posedimeve të tyre nuk janë prekur. Ndërthurja e faktorëve të ndryshëm siç është mungesa e regjistrimit të pronës dhe/ose dëshmi për ta vërtetuar titullin (për shkak të banimit paraprak në vendbanime joformale), mungesa e dokumenteve personale, brengat e sigurisë, mungesa e perspektivës ekonomike, vëmendje e ulët nga donatorët dhe mungesa e përfaqësimit efektiv në organet e ndërlidhura me kthimin kanë çuar në një rreth vicioz. Romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit e zhvendosur në përgjithësi nuk janë kthyer apo rikthyer në posedimet e veta. Shumica vazhdojnë të jetojnë të zhvendosur dhe në kushtet joadekuate të banimit me mungesë të qasjes së duhur në shërbime.

Për pëmirsësimin e vendbanimeve joformale dhe kthim të të zhvendosurve janë bërë plane në programet e ngërthyerë në "Standardet për Kosovën" dhe në Planin e Veprimit për Partneritetin Evropian. Mirëpo, me disa përjashtime (të pëershruara në vijim), këto përpjekje nuk kanë dhënë rezultate të kënaqshme apo ndonjë skemë koherente dhe efikase për ndarjen e tokës. Tetë vite pas konfliktit, autoritetet lokale dhe ndërkombëtare ende nuk kanë hartuar një politikë kredibile për t'u përkujdesur që romëve, ashkalinjëve dhe egjiptasve t'u ofrohet ndihmë në kthim dhe reintegrin, përfshirë edhe ndarjen e titullit të pronës sipas nevojës, integrimit të vendbanimeve të vjetra joformale në plane urbane dhe ofrim të shërbimeve. Për të realizuar këtë, kërkohen reforma ligjore dhe institucionale.

Zhvendosja dhe migrimi kanë zvogëluar popullatën e romëve, ashkalinjëve dhe egjiptasve në Kosovë në më pak se një e treta e popullatës së para luftës. Vlerësohet se nga 150,000 të cilët kanë jetuar në Kosovë para vitit 1999 vetëm 30,000 deri 35,000 jetojnë sot në Kosovë. Shumë prej këtyre personave të cilët janë larguar që nga 1998 janë ende azil kërkues ose me "status tolerimi" në Evropën perëndimore, me status të përkohshëm pranimi në Bosnjë e Hercegovinë apo refugiatë dhe të zhvendosur brenda regjionit.<sup>14</sup>

Poashtu, një numër i pjesëtarëve të këtyre bashkësive ende janë të zhvendosur në Kosovë. Edhe pse një pjesë domethënëse e këtyre bashkësive janë larguar bashkërisht me shqiptaret gjatë fazës së dhunshme në periudhën prej 1998 deri në qershor 1999, vendbanime të tëra të këtyre bashkësive janë djegur dhe banorët e tyre janë dëbuar pas konfliktit dhe në trazirat e marsit të vitit 2004. Shembuj relevantë të këtyre akteve të dhunës janë shkatërrimi i Mëhallës rome "Fabrica" në Mitrovicën e jugut, paraprakisht e banuar me 8,000 romë, ose zhvendosjen e banorëve të mëhallave të Prishtinës<sup>15</sup> të njohura si "Moravskë" apo "Dalmatinska". Kthimi dhe rindërtimi nuk kanë dhënë rezultate domethënëse. Vetëm 6,765 pjesëtarë të bashkësisë janë kthyer vullnetarisht në Kosovë deri më gusht 2007.<sup>16</sup>

Mungesa e dokumenteve personale, shënimëve pronësore apo titullit të regjistruar kanë rënduar problemin. Sipas Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugiatë, rreth 20 - 40% të romëve, ashkalinjëve dhe egjiptasve në Kosovë u mungon statusi i regjistrimit civil dhe prandaj nuk janë në gjendje të ushtrojnë të drejtën themelore siç është qasja në gjykata. Të zhvendosurit në Serbi ballafaqohen me të njëjtin problem. Gjysma e tyre madje nuk janë as të regjistruar si persona të zhvendosur. Prej 42,000, vetëm 22,000 janë të regjistruar të Komisariati për Refugiatë. Mungesa e dokumenteve i vë ata në rrezik që të bëhen pa shtëpsi.<sup>17</sup>

Shumica e këtyre personave jetojnë apo kanë jetuar në vendbanime joformale ku u mungonte kriteret themelore për njohje ligjore, siç janë lejet urbane apo titulli i regjistruar. Në disa raste, objektet banesore ishin të vendosura në tokë private dhe/ose shoqërore. Ky faktor i shtuar ka komplikuar procesin e kthimit dhe kthimin e pronës së tyre. Sipas standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, autoritetet publike kanë obligim të ndërmarrin hapa për të ofruar siguri ligjore të mbajtjes së pronës personave që jetojnë në vendbanime joformale.<sup>18</sup> Prandaj, kthimi i të zhvendosurve kërkon ofrimin e mbajtjes së sigurt të pronave dhe ndarjes së titullit të ri. Kështu, në mënyrë që t'i

<sup>14</sup> 30,000 romë, ashkalinjë dhe egjiptas janë larguar nga Kosova para konfliktit. 40,000 romë, ashkalinjë dhe egjiptas momentalist gjenden në vendet e Evropës perëndimore, kryesisht në Gjermani. Maqedonia, Mali i Zi dhe Bosnja e Hercegovina janë nikoqirë të rreth 10,000. 40,000 janë të zhvendosur në Serbi.

<sup>15</sup> Sipas regjistrimit të popullatës në Serbi në vitin 1991, komuna e Prishtinës kishte rreth 6,625 banorë romë. Burimet e tjera vlerësojnë deri në 15,000 romë, ashkalinjë, egjiptas në qytetin e Prishtinës.

<sup>16</sup> Shih Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugiatë: Kthimi vullnetar i pakicave në Kosovë deri më 31 gusht 2007.

<sup>17</sup> Shih Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugiatë, mars 2007: analiza e situatës së të zhvendosurve intern nga Kosova në Serbi : ligji dhe praktika

<sup>18</sup> Shih komentin e përgjithshëm 4 të Komitetit të Kombeve të Bashkuara mbi të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore (e drejta në banim adekuat), paragrafi 8 (a).

rindërtojnë shtëpitë e veta në mënyrë ligjore, organet përgjegjëse (komunat dhe Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit) duhet të ndajnë formalisht shfrytëzimin e tokës, gjë që kërkon lejen e UNMIK-ut. Këto ndarje të tokave varen në masë të madhe nga vullneti politik i komunave dhe autoritetet ndërkombëtare. Romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit prandaj varen nga kujdesi i autoriteteve publike për të mundësuar kthimin e tyre dhe rregullarizimin e lagjeve të tyre.

Në anën tjetër, mund të ofrohen argumente bazuar në faktin se individët mund të fitojnë të drejta përmes zënisë së tokës për një kohë të gjatë nëse kjo i plotëson kushtet e posedimit jo të favorshëm. Në realitet, personat e zhvendosur kanë pak gjasa të jenë të suksesshëm në gjykatë, pasi që posedimi jo i favorshëm nuk është i mundur në tokën publike apo shoqërore.<sup>19</sup> Ekzistojnë disa shembuj praktikë të kthimeve përfshirë ofrimin e mbajtjes apo posedimit të sigurt. Shembulli më i rëndësishëm është mëhallia rome në Mitrovicën e jugut, të banuar me 462 romë në tetor të vitit 2007. Rindërtimi i kësaj lagjeje nënkuqonte ndarjen e 3.5 hektarëve të tokës shoqërore për të vendosur ish banorët pa titull të regjistruar, ridefinimin e planeve urbane dhe një skemë të veçantë banimi me të drejtat e kufizuara të shfrytëzimit. Mirëpo, sipas kësaj skeme, të zhvendosurit të cilët nuk kishin titull të regjistruar dhe të cilët nuk kthehen, faktikisht i humbin shtëpitë e mëhershme pa ndonjë formë të kompensimit ose ofrimit të banimit të ri.<sup>20</sup> Në Dy Korriku, komuna e Mitrovicës lejoi rindërtimin në parcela shoqërore për të mundësuar kthimin. Në Rudesh (Istog) Komuna dhe Agjencioni Kosovar i mirëbesimit u pajtuan në dhjetor të vitit 2006 për ndërrimin e tokës për të mundësuar kthimin e romëve, ashkalinjëve dhe egjiptasve. Aprovimi i ndërrimit të tokës nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm është vonuar për shkak të përfshirjes së lagjes në të ardhmen në "Zonën e Mbrojtur", e cila rrëthon Manastirin ortodoks Serb të Gorioqit. Një Udhëzim i parado Kohshëm administrativ<sup>21</sup> i cili ndalon ndërtimin në këtë zonë mund të ndikojë në procesin e kthimit.

<sup>19</sup> Shih Ligjin mbi marrëdhëniet themelore të pronës, gazeta zyrtare e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë 6/80, Neni. 28 deri 32. Kushtet dhe afatet kohore të parashikuara për posedim jo të favorshëm nuk vlejnë për tokën publike.

<sup>20</sup> Konventa Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, që zbatohet edhe në Kosovë, e mbron gjëzimin e qetë të pronës (Neni 1, Protokolli 1) si dhe të drejtën në shtëpi (Neni 8).

<sup>21</sup> Shih Udhëzimin administrativ të qeverisë Nr. 11/2007 mbi ndërprerjen e përkohshme të ndërtimit të objekteve brenda zonave të mbrojtura.



## MPDL – LËVIZJA PËR PAQE

### NGA ZHVENDOSJA TEK VENDET E ORIGJINËS: PËRCJELLJA E TË DREJTAVE TË QYTETARËVE.

El Movimiento por la Paz, el Desarme y la Libertad (MPDL - Movement for Peace)<sup>22</sup> me këtë prezanton gjashtë raste ligjore për studime përbrenda kornizës së nismës së përbashkët të zhvilluar me Misionin e OSBE-së në Kosovë (OSCE) me titullin “Ju jeni i zhvendosur por të drejtat tuaja nuk janë”.

Të dyja organizatat luajnë një rol të ndryshëm dhe kombinojnë qasje të ndryshme ndaj problemeve që prekin qasjen në të drejtë në sferën e kthimit të pronës dhe qasjes në banim adekuat për qytetarët në përgjithësi dhe për të zhvendosurit në veçanti. Në të vërtetë, OSBE-ja mund të shfrytëzojë më mirë aftësinë e saj për të ndikuar më shumë në punën më me kujdes të qeverive qendrore dhe lokale, ndërsa MPDL – Lëvizja për Paqe duhet të garantojë, përmes dhënieve së ndihmës juridike pa pagesë, ndihmë direkte grupeve të rezikuara të qytetarëve të cilat e kanë të parandaluar ushtrimin e të drejtave të cilat u takojnë.

Raste ligjore të cilat ilustrojnë brengat e shprehura si dhe rekomandimet e dhëna në raportet e shumta të lëshuara nga akterët relevantë (ndër të tjerët, Institucion i Ombudspersonit në Kosovë, Mision i Përkohshëm Administrativ i Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe OSBE-ja), janë përgjedhur nga MPDL – Lëvizja për Paqe.

Rastet 1, 2, 3 dhe 4 të prezantuar këtu kanë të bëjnë me kërkuesat ligjore të njerëzve që jetojnë në zhvendosje, dhe ndaj të cilëve është reaguar duke falënderuar veprimeve të koordinuara të zyrave tona në Beograd, Nish, Prishtinë dhe Podgoricë<sup>23</sup> të cilat përbënë rrjetin e përhershëm të zyrave të quajtur “Grupi Punues për Kosovën”. Këto raste vënë në pah disa probleme të ndërlidhura me: (i) lirinë e kufizuar të lëvizjes, (ii) ekzistimin e numrit të madh të rasteve të pazgjidhura, (iii) transaksione të falsifikuara, (iv) njoftimet mbi procedurat gjyqësore, (v) proceset e ekspropriimit dhe privatizimit, dhe (vi) efektivitetin e mekanizmave për ankesa, të cilat në fakt pengojnë qasjen në të drejtat e personave të zhvendosur.

Rasti 5 ka të bëjë me një person jo të zhvendosur, prona e të cilit është transferuar si rezultat i praktikave të pohuara diskriminuese në periudhën ndërmjet marsit 1989 - marsit 1999, dhe njëra prej çështjeve që vihet në pyetje është puna e Agjencionit kosovar të pronave. Ky rast shpie në përfundimin shtesë se edhe pse problemet e ndërlidhura me çështjet pronësore mund të prekin kryesisht dhe në mënyrë të veçantë personat që jetojnë të zhvendosur, qytetarët jo të zhvendosur nuk duhet të lihen jashtë diskutimeve.

Në fund, Rasti 6 ofron një pasqyrë të mirë se si është shtjelluar çështja e kthimit të pronës në Bosnjë dhe Hercegovinë. Theksi i veçantë duhet t'i jepet mendimit se si grupet relevante të interesit të “bashkësisë ndërkombëtare” dedikuani në një moment specifik resurse dhe përpjekje të mjaftueshme për të themeluar një sistem efektiv, ku Komisioni për Ankesa rreth Patundshmërive për Refugjatë dhe Persona të Zhvendosur ishte një institucion kyç. Duhet të ceket se janë miratuar ligjet specifike nga Zyra e Përfaqësuesit të Lartë<sup>24</sup> në mënyrë që t'i mundësohet organit administrativ të lëshojë vendime obliguese dhe të zbatueshme, por posaçërisht, në përputhje me mandatin e saj, Zyra e Përfaqësuesit të Lartë vendosi t'i shkarkojë nga puna zyrtarët publike të cilët, edhe pse obligoheshin me vendimet e komisionit në fjalë, nuk i implementonin ato.

Me qëllim që t'i kontribuojë zbatimit të rekomandimeve që jepen në reportin e OSBE-së “Tetë vite më pas kthimi i pakicave dhe kthimi i objekteve banesore dhe pronës në Kosovë”, MPDL – lëvizja për paqe thekson në rastet vijuese për studim një listë jo të plotë të problemeve që kërkojnë një krye aktive të të gjithë grupeve të interesit në mënyrë që të nxitet procesi i qëndrueshëm i kthimit në përgjithësi dhe i kthimit të pronës në Kosovë.

<sup>22</sup> El Movimiento por la Paz, el Desarme y la Libertad (MPDL - Movement for Peace) është krijuar në vitin 1983, për të punuar në Zhvillim, Veprim Social dhe Ndihmë humanitare, momentalistështë duke punuar në më shumë se 100 projekte në rreth 30 vende. MPDL – Lëvizja për paqe ruan një prani të vazhdueshme dhe aktive në Evropën juglindore që nga 1992, ndërsa në territorin e Kosovës që nga 2001. MPDL – Lëvizja për paqe momentalistështë duke ekzekutuar programin “Konsolidimi i kthimit dhe stabilizimi i Ballkanit”, të mbështetur nga Agjacioni Spanjoll për bashkëpunim ndërkombëtar, i cili është themeluar nga Projekti për Ndihmë Juridike Falas, Projekti Social si dhe Projekti Bujqësor për Zhvillimin e bashkësive rurale në Hercegovinë lindore.

<sup>23</sup> Lëvizja për paqe krijoj “Grupin Punues për Kosovën” në mënyrë që të shqyrtojë të gjitha kërkuesat e bëra nga refugjatët dhe të zhvendosurit nga Kosova. Grupi i përmendur, i formuar nga ekipi prej 15 juristëve dhe asistentëve ligjor, përfshirë avokatë të jashtëm, ka iniciuar 5,633 procedura ligjore që kanë të bëjnë me pronën dhe çështjet banesore, përfshirë përfaqësimin ligjor pa pagesë tek gjykatat në Kosovë (periudha 01.10.2001 – 31.08.2007). Ky grup është një pjesë e rjetjet ndër-kufitar prej 10 zyrave të themeluara nga Lëvizja për paqe në Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi dhe Serbi, përfshirë Kosovën.

<sup>24</sup> Zyra e Përfaqësuesit të lartë është një institucion ndërkombëtar ad hoc përgjegjës për të mbikëqyrur zbatimin e aspekteve civile të marrëveshjes me të cilën është përfunduar lufta në Bosnjë dhe Hercegovinë. Është krijuar sipas Marrëveshjes së Përgjithshme për Paqe në vendin në fjalë (“Marrëveshja Paqësore e Dejtonit”).

## Rasti 1: Mungesa e reagimeve efektive për transaksionet e pohuara të falsifikuara<sup>25</sup>:

**Akterët kryesor të kyçur:** Zyra komunale e kadastrit (Pejë), Zyra e prokurorit publik (Pejë)

**Hyrje:** A.A me banesë në Serbi i është drejtuar zyrës për ndihmë ligjore të MPDL-së – Lëvizjes për paqe më 15 dhjetor 2006 me kërkesë për kthimin e pronës së patundshme të humbur si rezultat i transaksionit të falsifikuar.

**Pasqyrë e fakteve:** A.A. ka zbuluar se në Zyrën komunale të kadastrit në Pejë një person i tretë është regjistruar si pronar i pronës së patundshme të cilën ai e ka trashëguar. Siç raportohet, personi i cili e ka përmbyllur këtë transaksion që pohohet si i falsifikuar kishte falsifikuar një autorizimi dhe e ka verifikuar atë me 7 nëntor 2003 para Gjykatës së Qarkut në Bar (ish unioni shtetëror Serbi dhe Mali i Zi). Verifikimi i autorizimit në këtë sferë është konfirmuar nga zyra e MPDL-së – Lëvizjes për paqe në Mal të Zi derisa janë bërë hetimet për rastin.

**Procedura juridike e iniciuar:** Në janar të vitit 2007 është parashtruar padi në Gjykatën komunale të Pejës, me kërkesë për të shpallur kontratën e kontestuar të pavlefshme. Mirépo deri më datën e sotme nuk është pranuar ndonjë përgjigje gjë që tejkalon periudhën prej 180 ditëve të parapara me ligjin në fuqi.

Padia penale kundër personit i cili pohohet të ketë falsifikuar autorizimin poashtu është parashtruar në janar të vitit 2007 tek Zyra e prokurorit publik në Pejë.

Me njoftimin e datës 28 shkurt 2007, Zyra e prokurorit publik ka ftuar më 12 mars 2007 paditësin për të dhënë deklaratën e tij lidhur me padinë dhe për të parashtruar dokumentet relevante për të dëshmuar të drejtat pronësore. Për shkak të brengave të sigurisë paditësi parapëlqeu të dërgojë një memorandum me datën 9 mars 2007.

Zyra e prokurorit publik më vonë njoftoi paditësin përmes letrës së datës 14 shkurt 2007 se hetimet mbi këtë rast nuk do të vazhdojnë, pa përmendur fare deklaratën e dërguar me memorandum dhe as arsyet për të arsyetuar vendimin.

**Statusi momental i rastit:** Të gjitha mijetet juridike vendore për të mbrojtur të drejtat pronësore të paditësit mbi pronën e kontestuar janë shpenzuar dhe rasti është sjellë para institucionit të Ombudspersonit dhe Njësisë për Inspektim të Gjyqësorit në Kosovë, ku janë duke u zbatuar hetimet lidhur me mos-kryerjen e punës apo sjelljes së keqe të Zyrës së prokurorit publik në Pejë.

**Vërejtjet përmbyllëse:** Në kohën kur autorizimi ishte duke u verifikuar, në përputhje me Udhëzimet e dhënë nga Departamenti i UNMIK-ut për Drejtësi në Qarkoren 2003/3 drejtuar të gjitha gjykatave komunale në Kosovë, “autorizimet dhe pushteti i nënshkrimit i dhënë për qëllime të përmbylljes së transaksioneve pronësore që duket të janë falsifikuar dhe që janë vërtetuar nga Gjykatat e bashkimit shtetëror Serbi dhe Mali i Zi”, duhet t'i nënshtrohen në vërtetimit nga Departamenti i UNMIK-ut për Drejtësi.

Duke mos iu përmbajtur Udhëzimeve që kanë për synim shitjen e pronës “në emër të pronarëve që nuk jetojnë me ne Kosovë dhe nuk kanë dhënë pëlqim për shitblerje”, Gjykata komunale në Pejë mund të ketë dështuar në mbrojtjen e të drejtave pronësore të A.A.

Lidhur me paditë penale që janë parashtruar, Zyra e Prokurorit Publik nuk ka shpjeguar arsyet se pse hetimet nuk do të vazhdojnë dhe nuk ka përmendur memorandumin e dërguar më 9 mars 2007.

Mosparaqitura e informatave relevante dhe mungesa e konsistencës që është paraqitur në datat e njoftimeve, ndërprera e hetimeve me datën 14 shkurt 2007 derisa ftesa për të dhënë deklaratën me datën 28 shkurt 2007, ka shpjer në huti dhe tregon se mund të ketë parregullsi në procedurën gjyqësore.

## Rasti 2: Mungesa e njoftimit dhe kompensimit adekuat në proceset e eksproprijimit dhe privatizimit.

**Akterët kryesorë të kyçur:** Agjencionii Kosovar i Mirëbesimit, Gjykata Komunale dhe Gjykata Speciale e Gjykatës Supreme për Çështjet e ndërlidhura me Agjencionin Kosovar të Mirëbesimit.

**Hyrje:** X nga komuna e Pejës momentalisht i zhvendosur në Serbi, i është drejtuar Zyrës ligjore të MPDL – Lëvizjes për paqe më 9 dhjetor 2005 me kërkesë për të kthyer tokën.

<sup>25</sup> Duhet të ceket se informata dhe referencat dokumenteve të tjera të cekura në rastet për studim janë siguruar drejtpërsëdrejti nga personat të cilëve u është dhënë ndihma ligjore MPDL – Lëvizja për paqe.

**Pasqyrë e fakteve:** Toka e kontestuar nga X dhe nga Ndërmarrja Shoqërore “Bujqësia” gjendet në zonën kadastrale në Jablanicë në komunën e Pejës. Para nacionalizimit pa asnjë kompensim në vitet e 50-ta nga shteti jugosllav, prona i ka takuar atij të parit.

Në periudhën pas Jugosllavisë edhe pse parashtuesi i kërkesës e ka fituar pronën pas vendimit të gjykatës komunale më 1998, toka mbeti nën pronën e ndërmarrjes shoqërore “Bujqësia”.

Më datë 18 korrik 2007 privatizimi i ndërmarrjes shoqërore është shpallur në valën 28 dhe toka në fjalë është përfshirë në inventar përkundër ekzistimit të vendimit paraprak gjyqësor që e njihet X si pronar ligjor.

**Procedurat e iniciuara ligjore:** Në vitin 1996, X ka iniciuar procedurë ligjore për të kthyer pronën e cila ishte në pronësi të ndërmarrjes shoqërore “Bujqësia” dhe është njohur si pronar ligjor në vendimin e Gjykatës komunale në Pejë të lëshuar më 25 qershor 1997. “Bujqësia” ka parashtuar ankesë në Gjykatën e qarkut pa sukses dhe X është shpallur përsëri pronar ligjor me vendimin e lëshuar më 16 mars 1998.

Në shtator të vitit 2006, X ka iniciuar një procedurë të re tek gjykata komunale për të ekzekutuar vendimin e përmendur dhe avokati i jashtëm i MPDL – Lëvizjes për Paqe ka marrë pjesë në dëgjimet gjyqësore. Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit është njoftuar nga MPDL – Lëvizja për Paqe përmes një letre të parashtuar më 23 maj 2007 lidhur me ekzistimin e vendimeve të mëhershme gjyqësore të cilat i njihnin të drejtat pronësore të parashtuesit të kërkesës dhe i është propozuar një marrëveshje, por nuk ka pranuar kurfarë përgjigje.

Më 27 shtator 2007 është parashtuar një padi e re në Gjykatën Speciale të Gjykatës Supreme për Çështjet e Ndërlidhura me Agjencionin Kosovar të Mirëbesimit me kërkesë për të kthyer pronën paditësit.

**Statusi aktual i lëndës:** Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit e privatizozi ndërmarrjen shoqërore dhe ka ftuar investitorët për të blerë Kompaninë e re përmes tenderit publik e cila përbëhej nga inventari ku përfshihej edhe toka e kontestuar.

Deri në këtë moment, nuk dihet nëse do të jetë e mundur që paditësi të fitojë tokën pas Vendimit të Gjykatës Speciale të Gjykatës Supreme ose ndonjë kompensim përmes procesit të likuidimit të pasives së ndërmarrjes shoqërore.

Rasti i është bërë me dije institucionit të Ombudspersonit.

**Vërejtjet përmbyllëse:** Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit ka përfshirë tokën në inventarin e ndërmarrjes shoqërore “Bujqësia”, ka këruar oferta në valën 28, përkundër faktit se ishte në dijeni për ekzistimin e procedurave gjyqësore të hapur me kërkesë për të ekzekutuar vendimet paraprake gjyqësore të cilët e njohin paditësin si pronar ligjor.

Në mungesë të masave parandaluese me qëllim të shtyrjes së përfshirjes së tokës në inventarin që do të transformohet në kompanitë e reja, mungesa e respektit të duhur për një procedurë të iniciuar gjyqësore dhe mospërfillja e vendimeve paraprake gjyqësore të lëshuara në vitin 1997 dhe 1998 mund të rezultojë në shkeljen e të drejtave pronësore.

Poashtu mund të ceket se në përputhje me Udhëzimin Administrativ 2006/17 neni 22 paragrafi 7 të gjitha ankesat dhe dokumentet duhet të parashtohen në gjuhën angleze me shpenzim të palës në Gjykatën Speciale të Gjykatës Supreme.

Kjo kërkesë shpesh për qytetarët i vie nën një ngarkesë jologjike dhe papërbollueshme financiare që pengon qasjen e tyre në sistemin gjyqësor.

**Rasti 3: Mungesa e njoftimit adekuat mbi procedurat e iniciuara gjyqësore me qëllim të përmbylljes së shitblerjeve pronësore.**

**Akteret kryesor të kyçur:** Gjykata komunale e Pejës.

**Hyrje:** Y, personi i zhvendosur nga Peja, momentalisht jeton në Beograd, i është drejtuar Zyrës ligjore të MPDL – Lëvizjes për Paqe në Beograd më 11 dhjetor 2006, me kërkesë për të kthyer pronën pas një shitblerjeje që poohohet të jetë e falsifikuar.

**Pasqyrë e fakteve:** Y dhe familja e tij kanë ikur nga regioni në qershor të vitit 1999 dhe ka braktisur shtëpinë dhe parcelën ku është ndërtuar shtëpia në Pejë. Shtëpia është shkatërruar pak pas largimit. Prona e patundshme është regjistruar në Zyrën komunale kadastrale në emër të tij.

Kjo parcelë është zënë nga fqi Z., i cili më vonë ka regjistruar veten si pronar ligjor i pronës në kadastër.

**Procedurat ligjore të iniciuara:** Z ka parashtruar një padi ligjore kundër Y në Gjykatën komunale në Pejë, në bazë të ekzistimit të pohuar të marrëveshjeve për shitblerje të pronës të cilat siç raportohet, nuk ekzistonin asnjëherë, prandaj ai e përdori si dëshmi për dëshmim të rrejshëm nga dëshmitarët. Bazuar në ligjin në fuqi për Procedurën Civile, gjykata mund të merr vendim duke përdorur si dëshmi këto dëshmi të rrejshme të dëshmitarëve madje edhe gjatë kontestit pronësor.

Gjykata komunale në Pejë ka marrë vendimin përfundimtar me 7 qershor 2006, duke e njohur Z si pronar legjitim të pronës në mungesë të Y. Ky vendim i lejoi parashtruesit të kërkesës ta regjistrojë pronën në librat kadastrale.

Y as nuk ishte në dijeni se ishte iniciuar procedura e mësipërme ligjore, gjë që mund të jetë shkelje serioze e Ligjit mbi Procedurën Civile, nenin 86 lidhur me nenin 332, paragrafi 1) dhe 6). Me sa është në dijeni MPDL – Lëvizja për Paqe këto nene e përcaktojnë obligimin e gjykatës për t'u përpjekur ta njoftojë të paditurin përmes "mënyrës së duhur", e cila mund të bëhet përmes akterëve relevantë apo përmes shpalljes në gazeta të cilat mund realisht të supozohet se lexohen nga Y, të gjitha duke marrë parasysh gjendjen e tij si person i zhvendosur.

I padituri joformalish ka marrë vesh përvendimin e gjykatës kundër tij dhe ka parashtruar kërkesë për të rifilluar procedurën gjyqësore më 26 dhjetor 2006 në Gjykatën komunale të Pejës.

I padituri ka marrë pjesë në seancën e parë gjyqësore më 22 maj 2007 në Pejë me avokatin e tij N.H., por është shtyrë për 10 korrik 2007. Joformalish të paditurit gjyqtari kryesues i kishte thënë atij se nuk do të kishte sukses në procedurë.

Më 25 korrik 2007, Gjykata komunale në Pejë ka marrë një vendim (398/03 25/07/2007) ku refuzohej kërkesa përi-inicimin e procedurës gjyqësore. Ky vendim i është dorëzuar Y përmes avokatit të tyre në gjuhën shqipe, të cilën ai nuk e njeh. Përkundër kësaj, Y ka bërë një përkthim jozyrtar dhe ka zbuluar që (i) gjykata pohon se i është caktuar një avokat i përkohshëm (një avokat i cili paraprakisht ishte autorizuar nga Y për t'u përpjekur të gjejë blerës për pronën e tij në Pejë, por jo ta përfaqësojnë atë në këtë procedurë) dhe (ii) ai ishte informuar mbi procedurën gjyqësore në pritte përmes tabelës së shpalljeve në gjyq dhe nga gazeta kosovare ditore "Koha Ditore". Asnjëra nuk i është në dispozicion atij në vendin e zhvendosjes.

Parashtruesi i kërkesës poashtu ka parashtruar padi penale për zënie ilegale të pronës kundër Z në Zyrën e prokurorit publik. Kërkesa është refuzuar me arsyetim se ekziston vendim i vlefshëm gjyqësor i cili e shpallo Z pronar të ligjshëm të pronës së kontestuar.

**Statusi aktual i pronës:** Parashtruesi i kërkesës me kohë ka bërë ankesë në gjykatën e instancës së dytë nga i cili momentalisht prët përgjigje. Ky rast i është përcjellë edhe institucionit të Ombudspersonit dhe Njësisë për Inspektim të Gjyqësorit Kosovar, ku është duke u bërë hetimi mbi moskryerjen e punës apo sjelljes së keqe të Zyrës së Prokurorit Publik në Pejë.

**Vërejtjet përmbyllëse:** I pandehuri nuk është informuar asnjëherë lidhur me procedurën gjyqësore kundër tij deri në kohën e marrjes së vendimit mbi pronën, pasi që mjetet që janë përdorur nga Gjykata komunale për të informuar të pandehurin nuk ishin në dispozicion për të. MPDL – Lëvizja për Paqe beson se shkelja e qartë e ligjeve procedurale e ka lënë atë të pambrojtur.

#### Rasti 4: Mungesa e (i) qasjes mekanizmave për ankesa dhe (ii) efektiviteti i mekanizmave ekzistues.

**Akterët kryesor të kyçur:** Gjykata komunale në Prishtinë dhe Agjencioni Kosovar i pronave.

**Hyrje:** A, një person i zhvendosur nga Prishtina, i cili momentalisht jeton në Beograd, i është drejtuar zyrës për ndihmë ligjore pa pagesë të MPDL – Lëvizjes për Paqe më 1 gusht 2007 me kërkesë për të kthyer pronën e patundshme private dhe kompensim për dëme.

**Pasqyra e fakteve:** A është pronari ligjor i shtëpisë në Prishtinë e cila ishte zënë pas vitit 1999, kur është larguar nga Kosova.

**Procedurat e iniciuara ligjore:** A ka parashtruar një padi gjyqësore Gjykates komunale në Prishtinë duke kërkuar kompensim për dëme të cilat i kishte pësuar për shkak se banesa e tij në Prishtinë ishte zënë që nga 1999. Ai paditi komunën e Prishtinës dhe Institucionet e përkohshme të vetë-qeverisjes në Kosovë.

Në 22 shkurt të vitit 2007, Gjykata komunale në Prishtinë, si gjykatë e instancës së parë, lëshoi vendimin e tij.

I padituri ka pranuar vendimin nga zyra e Agjencionit Kosovar të Pronave, me përbajtje vijuese: (i) e shpall Gjykatën jo-kompetente (ii) e referon rastin Agjencionit Kosovar të Pronave duke pohuar se ata janë kompetent për këso lloj kërkesash ligjore.

Agjencionit Kosovar i Pronave, në asnjë rrethanë, nuk është kompetent për të zgjidhur kërkesa mbi kompensim për përdorim ilegal të pronës. Bazuar në Rregulloren 2006/50, nen 3.1 Agjencionit Kosovar i Pronave është përgjegjës për t'u marrë me kërkesa që kanë të bëjnë me pronësinë dhe/ose të drejtat pronësore të ndërlidhura me pronën private, bujqësore dhe komerciale.

Në nenin 3.2 të rregullores në fjalë, deklarohet se për të gjitha kërkesat tjera që nuk parashihen me nenin 3.1, palët mund t'i kërkojnë të drejtat e tyre në gjykatën kompetente.

**Statusi aktual i rastit:** A ka parashtruar ankesë Gjykatës së Qarkut në Prishtinë si gjykatë e instancës së dytë në afat kohor prej 15 ditëve.

Për më tepër, këso lloj vendimesh të gjykatave me të njëtin argumentim dhe gati me të njëjtën përbajtje i janë shpërndarë gjerësisht shumë palëve të cilat kanë iniciuar kësi lloj procedurë. Gjykatat kanë mundur t'i kontaktojnë këtë person përmes Agjencionit Kosovar të Pronave, por Agjencionit Kosovar i Pronave nuk ndërmerr detyrën e qarkullimit të ankesave gjykatave kompetente të nivelit të dytë në Kosovë. Prandaj, në fund, atyre u mohohet qasja në drejtësi. Poashtu, disa persona kanë ndërruar adresat apo numrat e telefonit dhe nuk ka mundësi që Agjencionit Kosovar i Pronave t'i kontaktojë ata.

**Vërejtjet përbyllëse:** Gjykatat komunale nuk e zbatojnë ligjin në fuqi (kryesisht Rregulloren 2006/50). Për më tepër, Agjencionit Kosovar i Pronave ndihmon në dorëzimin e vendimeve, ndërsa nuk u ndihmon palëve të parashtrojnë ankesat.

**Rasti 5: Ekzistimi i praktikave të pohuara diskriminuese në periudhën ndërmjet marsit 1989 dhe marsit 1999.**

**Akterët kryesor të kyçur:** Agjencionit Kosovar i Pronave, Zyra kadastrale komunale e Prishtinës, dhe Gjykata komunale në Prishtinë.

**Hyrje:** B, i cili momentalisht jeton në Prishtinë, i është drejtar zyrës së MPDL – Lëvizjes për paqe për ndihmë ligjore pa pagesë, me kërkesë për kthimin e pronës së patundshme për të cilën pohon të jetë humbur si rezultat i praktikave diskriminuese ndërmjet marsit 1989 dhe marsit 1999

**Pasqyrë e faktave:** B, gëzon posedimin e banesës e cila fillimisht i takonte komunës së Prishtinës prej 1959 deri më 12 gusht 1968, data kur është blerë dhe ligjërisht është bartur në pronësi private.

Në vitin 1994 S.F. është dëbuar në mënyrë të paligjshme nga Inspektorët komunal nga prona e tij me kërkesë të palës së tretë për të cilën pohohet t'i ketë falsifikuar të gjitha dokumentet e nevojshme për të kerkuar të drejta pronësore mbi pronën.

**Procedurat e iniciuara ligjore:** B, pak pas dëbimit është kthyer në banesë dhe parashroi padi tek Gjykata komunale në Prishtinë. Më 5 nëntor 1998 Gjykatë shpalli parashtruesin e kërkesës si pronar ligjor të banesës por fillimi i luftës parandaloi gjykatën kompetente nga nxjerra e vendimit dhe zbatimin e saj.

Edhe pse vendimi i lartpërmendur është lëshuar më në fund më 19 shkurt 2002, nuk ka dëshmi të mëtejme të pronës sepse Zyra komunale e kadastrës nuk e ka regjistruar. Më 12 qershor 2007, fletëposedimi i kerkuar në Zyrën e Kadastrit nuk kishte ndonjë rubrikë të regjistruar në emër të parashtruesit të kërkesës.

**Statusi aktual i rastit:** Prona është ende në kontest pasi Komisioni i Ankesave për Çështjet Banesore-Pronësore më 16 nëntor aprovoi një kërkesë të parashtruar nga i njëjtë person i cili pohohet të ketë falsifikuar dokumentet më herët dhe në fakt asnjëherë nuk hyri dhe jetoi në banesë.

Edhe pse B mban të gjitha dëshmitë e nevojshme për të dëshmuar pronësinë e tij mbi pronën, aktualisht ballafaqohet me rrezikun e të dëbuarit pas lëshimit të vendimit të lartpërmendur.

Ky rast i është përcjellë Institucionit të Ombudspersonit dhe OSBE-së.

**Vërejtjet përmbyllse:** Zyrës së kadastrit shpesh i mungon dokumentacioni adekuat nga periudha jugosllave pasi që dokumentet janë shkatërruar apo librat janë zhvendosur. Kjo është arsyja se pse në mungesë të udhëzimeve më fleksibile janë lejuar forma të tjera të dëshmive për të dëshmuar shitblerje të pronave; mungesa e regjistrimit është një pengesë e madhe në verifikimin e të drejtave pronësore.

Mirëpo, përkundër këtij regjistri, nëse marrim parasysh se vendimi i lëshuar nga Komisioni i Ankesave për Çështje Banesore-Pronësore hedh poshtë vendimin përfundimtar të Gjykatës komunale në Prishtinë i cili e shpall B pronarin ligjor të pronës, zelli i atij të parit në kryerjen e punës së tij është një çështje për brengosje serioze.

#### **Rasti 6: Kthimi i pronës në Bosnjë dhe Hercegovinë. Rast për krahasim.**

**Akterët kryesor të kyçur:** Komisioni për Ankesat rreth Patundshmërisë për Refugjatët dhe Personat e Zhvendosur (Komisioni për Ankesat rreth Patundshmërive), Ministria për Refugjatët dhe të Zhvendosur.

**Hyrje:** C, një qytetar i Bosnjë dhe Hercegovinës, inicioi procedurën për kthimin e pronës derisa ishte refugjat në Danimarkë, përmes Komisionit për Ankesa për Patundshmëri.

**Pasqyrë e fakteve:** C, me banim të përhershëm në Banja Llukë, Bosnjë dhe Hercegovinë, është detyruar të largohet nga qyteti më 1993, duke këruar status të refugjatit në Danimarkë, ku qëndroi me familjen e tij deri sa u kthye.

C, ishte pronar i një toke me shtëpinë e familjes në Banja Llukë në të njëjtën adresë. J. M. ishte regjistruar si pronar në regjistrat e tokës në komunën kadastrale të Banja Llukës me pronë 1/1 prej 1500 m<sup>2</sup> të tokës dhe shtëpi dy-katëshe të ndërtuar në të njëjtën tokë. C, poashtu ishte i regjistruar në komunën kadastrale të Banja Llukës si posedues i pronës së patundshme të tokës së lartpërmendor dhe shtëpisë dy-katëshe dhe rregullisht paguante tatimin në pronë.

C jetonte me bashkëshorten dhe dy fëmijë të mitur deri më 1992, kur shpërtheu lufta në Bosnjë dhe Hercegovinë. Si Boshnjak, anëtar i popullatës minoritare në regjionin e Banja Llukës, e cila ishte nën kontroll të policisë dhe ushtrisë të serbëve të Bosnjës gjatë luftës, ishte nën presion të vazhdueshëm dhe kërcënime të autoriteteve lokale dhe grupeve joformale që synonin të zbatonin pastrimin e popullatës jo-serbe.

Në vitin 1992, ai u shkarkua nga kompania lokale sepse nuk i ishte përgjigjur mobilizimit ushtarak si Boshnjak. Pasi i është kufizuar liria e lëvizjes meqë nuk i ishte lëshuar leja për lëvizje të lirë në regjionin e Banja Llukës, C vendosi të largohet nga Banja Lluka me familjen e tij.

Ai kërkoi emigrim tek autoritetet lokale dhe kërkoi ndihmë nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq në Banja Llukë. Atij dhe familjes së tij i është dhënë leja të emigrojnë nga autoritetet lokale më 22 prill 1993. C ndërpreni banimin e tij për vete dhe familjen e tij tek policia lokale. Ai duhet të parashtronte dëshmi se kishte paguar të gjitha tatimet dhe taksat për shërbimet lokale, pas së cilës nënshkroi një deklaratë të largimit vullnetar nga Republika Srpska. Ai poashtu nënshkroi se e linte pronën e tij të patundshme Republika Srpskës. Para largimit të tij më 22 prill 1993, ai i dorëzoi çelësat e shtëpisë së tij autoriteteteve lokale dhe u largua nga Bosnja dhe Hercegovina përmes Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq.

Si refugjatë, C u largua me familjen e tij për Danimarkë, ku qëndroi deri në fund të luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë.

Gjatë vitit 1994, C pranoi një telefonatë nga D. nga Banja Lluka, i cili e informoi atë se pasi që ishte Serb i zhvendosur nga Sarajevo, atij autoritetet lokale i kanë dhënë shtëpinë e C-së në shfrytëzim. Duke marrë parasysh rrëthanat, D i propozoi C-së që ai të merr shtëpinë e tij në Sarajevë, duke marrë parasysh se ishte kontrolluar nga Boshnjakët. C refuzoi këtë propozim duke pohuar se dëshiron të kthehet në Banja Llukë dhe se nuk dëshiron ta ndërrojë pronën e tij në Banja Llukë me atë në Sarajevë. Pak ditë më vonë, D e informoi C-në se në përputhje me "ligjet ushtarake", ai e ka regjistruar shtëpinë e C-së në emër të tij, dhe se C-ja mund të bënte njësoj me pronën e D-së në Sarajevë.

**Procedurat e iniciuara ligjore:** Menjëherë pas përfundimit të luftës në vitin 1996, C kishte hulumtuar mundësinë e kthimit në Bosnjë dhe Hercegovinë nga Danimarka dhe për riposedin e pronës së tij në Banja Llukë. Ai zbuloi se avokati Z nga Banja Lluka bënte ankesa pronësore. Ai e këshilloi përmes një bisede telefonike se mund të parashtronë padi tek Gjykatës komunale në Banja Llukë, por se për momentin, gjykatësit nuk vendosnin për këto çështje për shkaqe politikë. Poashtu, avokati e informoi C-në lidhur me Ligjin për Zbatimin e Anuluar të

Ligjit të Luftës mbi Pronën e Braktisur, që do të thoshte se C mund të parashtron te kërkesë të organit kompetent administrativ i Banja Llukës për të riposeder pronën e patundshme të tij. Në maj të vitit 1999, C autorizoi Z të parashtrojë një ankesë zyrtare në Gjykatën komunale të Banja Llukës për riposedit të pronës së tij të patundshme, dhe të parashtrojë ankesë me procedurë administrative tek Ministria për Refugjatë në Republikën Srpska, në Departamentin e Banja Llukës, për riposedit të pronës së patundshme.

Në të njëjtën kohë, ai mori vesh se Komisioni për Ankesë rrëth Patundshmërive, i themeluar në përputhje me Shtojcën 7 të Marrëveshjes Paqësore të Dejtonit, ka hapur zyrën e tij në Kopenhangë, Danimarkë, dhe pranonte ankesë për Komisionin.

Edhe pse ai parashroi ankesë tek Gjykata komunale e Banja Llukës përmes avokatit të tij Z dhe ka filluar procedurën administrative me Ministrinë përkatëse për riposedit të pronës së tij të patundshme, C personalisht ka parashtruar një kërkesë për Komisionin për Ankesë rrëth Patundshmërive në zyrën e saj në Kopenhangë.

Në përputhje me Rregulloren e Punës, Komisioni për Ankesë rrëth Patundshmërive vendosi se C ishte pronar i pronës së patundshme në Banja Llukë më 1 prill 1992 dhe vendosi për këtë fakt më 12 maj 2000. Pasi që është ashtu ishte udhëzuar nga Komisioni, ai parashroi ankesë tek Ministria për Refugjatë dhe persona të zhvendosur në Banja Llukë për ekzekutimin e vendimit të Komisionit për Ankesë rrëth Patundshmërive në përputhje me Ligjin për Ekzekutimin e Vendimeve të Ankesave rrëth Patundshmërive (duhet të ceket se ky ligj është aprovuar drejtpërsëdrejtë nga Zyra e Përfaqësuesit të Lartë). Në afat prej 30 ditëve, Ministria ka marrë vendim për ekzekutimin e vendimit të Komisionit të Ankesave rrëth Patundshmërire dhe urdhëroi pronarin e përkohshëm ta lirojë pronën e patundshme deri më 1 qershor 2000. Pronari i përkohshëm parashroi ankesë kundër vendimit, por ankesë e tij nuk shtyri ekzekutimin e vendimit, dhe as deklaratat e arsyeve të dhëna në ankesë nuk kishin ndonjë ndikim në statusin ligjor dhe fakte të garantuara nga vendimi.

Pasi që ai nuk dëshironte ta lironë pronën në mënyrë vullnetare, përdoruesi i përkohshëm është dëbuar më 15 qershor të vitit 2000 nga policia lokale, dhe C-së i është lejuar të riposedojë pronën në të njëjtën ditë.

**Vërejtjet përbillyse:** Ekzekutimi i vendimeve të Komisionit të Ankesave rrëth Patundshmërive është dëshmuar të jetë më efektiv dhe më i shpejtë krahasuar me procedurat administrative dhe gjyqësore për riposedit të pronës së patundshme në Bosnjë dhe Hercegovinë, të cilat zakonisht pasoheshin me një numër pengesash e vështirësish. Plani për t'i dhënë Komisionit për Ankesë rrëth Patundshmërive kompetencë të gjëra u dëshmuia të jetë një masë efektive për kthimin e pronës në Bosnjë dhe Hercegovinë.



## SEKTORI 2

### KOMISIONI PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Nënkomision i për Avancimin dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut  
Seanca e pesëdhjetë e gjashtë

#### TË DREJTAT EKONOMIKE, SOCIALE DHE KULTURORE

*Rikthimi i pronës banesore dhe pronës në kontekst të kthimit të refugjatëve dhe personave të zhvendosur  
Raporti përfundimtar i raportuesit special, Paulo Sérgio Pinheiro*

Parimet mbi rikthimin e pronës banesore dhe pronës për refugjatët dhe personat e zhvendosur

#### Përbledhje

Në seancën e tij të pesëdhjetë e gjashtë, Nënkomision i për Promovimin dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, në Rezolutën e tij 2004/2, mirëpriti raportin mbi përparimin e bërë dhe kërkoi nga Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara që t'ua shpërndajë projekt parimet mbi rikthimin e pronës banesore dhe pronës për refugjatët dhe personat e zhvendosur organizatave joqeveritare, qeverive, agjencive të specializuara dhe palëve tjera të interesuara për komente, dhe kërkojë nga Raportuesi Special që t'i merr parasysh këto komente në përgatitjen e reportit të tij përfundimtar dhe të merret para sysh nga Nënkomision i përseancën e tij të pesëdhjetë e shtatë.

Raport përfundimtar i dorëzuar nga Raportuesi Special pasqyron rezultatet e këtij procesi intensiv të konsultimeve dhe paraqet parimet mbi pronën banesore dhe rikthimin e pronës për refugjatët dhe personat e zhvendosur në versionin e tyre përfundimtar.

# **PARIMET MBI RIKTHIMIN E PRONËS BANESORE DHE PRONËS PËR REFUGJATËT DHE PERSONAT E ZHVENDOSUR**

## **Preamble**

*Duke e ditur faktin që miliona refugjatë dhe persona të zhvendosur në mbarë botën vazhdojnë të jetojnë në kushte të rrezikshme dhe të pasigurt dhe që të gjithë refugjatët dhe personat e zhvendosur kanë të drejtë në kthim vullnetar, të sigurt dhe të dinjitetshëm në shtëpitë e tyre të mëparshme të banimit ose në ish shtëpitë e tyre të banimit apo tokat e tyre,*

*Duke nënizuar, që kthimi vullnetar i sigurt dhe i dinjitetshëm duhet të bazohet në zgjidhjen e lirë dhe të informuar individuale dhe që refugjatët dhe personat e zhvendosur duhet të pajisen me informata komplate, objektive, të përditësuara dhe të sakta, përfshirë çështjet e sigurisë fizike, materiale dhe ligjore në shtetet apo vendet e prejardhjes,*

*Duke riafirmuar të drejtat e grave dhe vajzave refugjate e të zhvendosura dhe duke njohur nevojën për ndërmarrjen e masave pozitive për të siguruar garantimin e të drejtave për rikthim të pronës banesore, tokës dhe pronës,*

*Duke mirëpritur themelimin e shumë institucioneve vendore dhe ndërkombëtare viteve të fundit për të siguruar të drejtat e rikthimit të refugjatëve dhe personave të zhvendosur, si dhe të shumë ligjeve, standardeve, deklaratave politikave, marrëveshjeve dhe udhëzimeve vendore dhe ndërkombëtare, të cilat kanë bërë njohjen dhe konfirmimin e të drejtës për rikthim të pronës banesore, tokës dhe pronës,*

*Të bindur që e drejta për rikthim të pronës banesore, tokës dhe pronës është thelbësore për zgjidhje të konfliktit dhe ndërtim të paqes pas konfliktit, kthim të sigurt dhe të qëndrueshëm dhe vendlloje të sundimit të ligjit dhe se monitorimi i kujdeshëm i programeve për rikthim i organizatave ndërkombëtare dhe shteteve të përfshira është i domosdoshëm për sigurimin e implementimit efektiv të tyre,*

*Të bindur gjithashtu, që implementimi i suksesshëm i programeve për rikthim të pronës banesore, tokës dhe pronës, si element kyç i drejtësisë restorative, kontribuon në parandalimin efikas të situatave të zhvendosjes dhe ndërtimin e paqes së qëndrueshme në të ardhmen.*

## **NENI I.**

### **FUSHËVEPRIMI DHE APLIKIMI**

#### **1. Fushëveprimi dhe aplikimi**

1.1 Parimet e shprehura këtu mbi rikthimin e pronës banesore dhe pronës për refugjatët dhe personat e zhvendosur janë dizajnuar për t'i ndihmuar të gjithë akterët përkatës, vendor dhe ndërkombëtar në adresimin e çështjeve ligjore e teknike që kanë të bëjnë me rikthimin e pronës banesore, tokës dhe pronës në situatat ku zhvendosja ka quar në zhvendosje arbitrale ose joligjore nga shtëpitë e mëparshme, tokat, pronat ose vendbanimit i përhershëm,

1.2 Parimet mbi pronën banesore dhe rikthimin e pronës për refugjatët dhe personat e zhvendosur vleinë njëjtë për të gjithë refugjatët, personat e zhvendosur brenda vendit dhe për personat të cilët gjenden në pozitë të ngjashme, të cilët kanë iku përtje kufijve kombëtar, por të cilët mund të mos kualifikohen për t'u definuar si refugjat të ligjshëm (në tekstin e mëtuteshëm "refugjatët dhe personat e zhvendosur") të cilët janë privuar në mënyrë arbitrale ose të paligjshme nga e shtëpitë e mëparshme, tokat ose pronat apo vendet e banimit të përhershëm, pavarësisht nga natyra ose rrëthanat nëpër të cilat ishte shfaqur zhvendosja në rend të parë.

## **NENI II.**

### **E DREJTA PËR RIKTHIM TË PRONËS BANESORE DHE PRONËS**

#### **2. E drejta për rikthim të pronës banesore dhe pronës**

2.1 Të gjithë refugjatët dhe personat e zhvendosur kanë të drejtë në rikthim të pronës banesore, tokës dhe/ose pronës prej së cilës janë privuar në mënyrë arbitrale ose joligjore, ose të kompensohen për ndonjë pronë banesore, tokë dhe/ose pronë që faktikisht është e pamundur të rikthehet sipas përcaktimit nda një tribunal i pavarur dhe i paanshëm.

2.2 Shtetet i japin prioritet në mënyrë të demonstrative të drejtës për rikthim si një kompensim më i preferuar për

zhvendosje dhe si element kyç i drejtësisë restorative. E drejta për kompensim ekziston si e drejtë e dalluar dhe nuk paragjykohet as nga kthimi aktual e as nga mos kthimi i refugjatëve dhe personave të zhvendosur, të cilët kanë të dejtë në kthim të pronës banesore, tokës dhe pronës.

### **NENI III. PARIMET KRYESORE**

#### **3. E drejta për mosdiskriminim**

3.1 Çdokush ka të drejtë të mbrohet nga diskriminimi në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, religjionit, mendimit politik ose ndonjë mendimi tjetër, prejardhjes etnike ose sociale, pronës, paaftësisë, lindjes ose statusit tjetër.

3.2 Shtetet sigurojnë që diskriminimi de facto dhe de jure, në bazat e lartpërmendura të jetë i ndaluar dhe që të gjithë personat, duke përfshirë refugjatët dhe personat e zhvendosur konsiderohen të njëjtë para ligjit.

#### **4. E drejta për barazi ndërmjet meshkujve dhe femrave**

4.1 Shtetet garantojnë të drejta të barabarta për meshkujt dhe femrat dhe të drejta të barabarta për vajzat dhe djemtë në rikthim të pronës banesore, tokës dhe pronës. Shtetet sigurojnë të drejtë të barabartë të meshkujve dhe femrave dhe të drejtë të barabartë djemve dhe vajzave, ndër të tjera, në kthim vullnetar të sigurt dhe të dinjitetshëm, siguri ligjore të posedimit, posdim të pronës, qasje të barabartë në trashëgimi si dhe përdorim, kontrollim dhe qasje në pronë banesore, tokë dhe pronë.

4.2 Shtetet duhet të sigurojnë që programet për rikthim të pronës banesore, tokës dhe pronës dhe politikat dhe praktikat të njohin të drejtat pronësore si të kryefamiljarëve meshkuj ashtu edhe femra si një komponentë kryesore e procesit të rikthimit dhe që programet për rikthim, politikat dhe praktikat të pasqyrojnë qasje të kujdesshme ndaj çështjeve gjinore.

4.3 Shtetet garantojnë që programet për rikthim të pronës banesore, tokës dhe pronës, politikat dhe praktikat të mos i vejnë në disadvantazh gratë dhe vajzat. Shtetet duhet të miratojnë masa pozitive për të siguruar barazi gjinore në këtë aspekt.

#### **5. E drejta për mbrojtje nga zhvendosja**

5.1 Çdokush ka të drejtë të mbrohet nga zhvendosja arbitrale nga shtëpia, toka ose vendi i banimi të përhershëm të tij/saj.

5.2 Shtetet, në legjislacionin vendor, duhet të përfshijnë masa mbrojtëse kundër zhvendosjes, të cilat janë në përputhje me të drejtat ndërkombëtare të njeriut dhe të drejtën humanitare e standardeve përkatëse dhe duhet të shtrijnë këtë mbrojtje për gjithsecilin brenda juridikzionit të tyre ligjor ose kontrollit efektiv.

5.3 Shtetet ndalojnë dëbimin me forcë, rrënimin e shtëpive dhe shkatërrimin e zonave bujqësore dhe konfiskimin arbitral ose eksproprijimin e tokës si masë ndëshkuese ose si mjet apo metodë e luftës.

5.4 Shtetet marrin hapa për të siguruar që asnjëri të mos i nënshtrohet zhvendosjes as nga akterët shtetëror e as nga ata joshtetëror. Shtetet gjithashtu duhet të sigurojnë që individët, korporatat dhe subjektit tjera në kuadër të juridikzionit ligjor or kontrollit të tyre efektiv të përbahen nga realizimi apo çdo lloj pjesëmarrje në zhvendosje.

#### **6. E drejta për jetë private dhe respektimi për shtëpi**

6.1 Secili ka të drejtë të mbrohet kundër ndërhyrjes arbitrale ose paligjshme në jetën e tij private dhe në shtëpinë e tij/saj.

6.2 Shtetet sigurojnë që secilit t'i ofrohen garanci për proces të rregullt kundër ndërhyrjes arbitrale ose paligjshme në jetën e tij private dhe shtëpinë e tij/saj.

#### **7. E drejta për gëzim në qetësi të posedimeve**

7.1 Secili ka të drejtë të gëzoj në qetësi posedimet e tij/saj.

7.2 Shtetet mund të kufizojnë shfrytëzimin dhe gëzimin e posedimeve vetëm kur është në interes publik dhe i nënshtrohet kushteve të përcaktuara në ligj dhe në parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Kurdo

që është e mundur, "interesi i shoqërisë" duhet të interpretohet në mënyrë të ngushtë, në mënyrë që të nënkuptoj vetëm ndërhyrje të kufizuar apo të përkohshme ne të drejtën e gjëzimit në qetësi të posedimeve.

## **8. E drejta në kushte adekuate të banimit**

8.1 Secili ka të drejtë për kushte adekuate të banimit.

8.2 Shtetet duhet të miratojnë masa pozitive që kanë për synim zbutjen e gjendjes së refugiatëve dhe personave të zhvendosur, të cilët jetojnë në kushte joadekuate të banimit.

## **9. E drejta e lirisë së lëvizjes**

9.1 Secili ka të drejtë për liri të lëvizjes dhe të drejtë për zgjedhjen e vendbanimit të tij/saj. Askush nuk duhet të detyrohet me forcë në mënyrë arbitrale ose të paligjshme që të qëndrojë brenda territorit, zonës ose rajonit të caktuar. Në mënyrë të njashme, askush nuk duhet të detyrohet në mënyrë arbitrale ose paligjshme të largohet nga territori, zona ose rajoni i caktuar.

9.2 Shtetet sigurojnë që liria e lëvizjes dhe e drejta për zgjedhjen e vendbanimit të mos i nënshtronen ndonjë kufizimi, përvèç atyre të parashikuara me ligj, që janë të domosdoshme për mbrojtjen e sigurisë kombëtare, rendit publik, shëndetit publik ose moralit apo të drejtat dhe liritë e të tjera dhe kufizimet e tillë të janë në pajtim me të drejtat ndërkombe të njeriut, të drejtën humanitare dhe të refugiatëve dhe standardet përkatëse.

## **NENI IV.**

### **E DREJTA PËR KTHIM VULLNETAR TË SIGURT DHE TË DINJITETSHËM**

#### **10. E drejta për kthim vullnetar të sigurt dhe të dinjitetshëm**

10.1 Të gjithë refugiatët dhe personat e zhvendosur kanë të drejtë të kthehen vullnetarisht në shtëpitë e tyre të mëparshme, tokat ose vendbanimet e përhershme në mënyrë të sigurt dhe të dinjitetshme. Kthimi vullnetar i sigurt dhe i dinjitetshëm duhet të bazohet në zgjidhjen e lirë dhe të informuar individuale. Refugiatët dhe personat e zhvendosur duhet të pajisen me informata komplate, objektive, të përditësuar dhe të sakta, duke përfshirë çështjet e sigurisë fizike, materiale dhe ligjore në shtetet apo vendet e prejardhjes,

10.2 Shtetet iu lejojnë refugiatëve dhe personave të zhvendosur të cilët dëshirojnë të kthehen vullnetarisht në shtëpitë e tyre të mëparshme, tokat e tyre ose në vendbanimet e përhershme, që ta bëjnë një gjë të tillë. Kjo e drejtë nuk mund të shkurtohet në kushte të trashëgimit të shtetit, e as që mund t'i nënshrohet kufizimeve arbitrale dhe të paligjshme kohore.

10.3 Refugiatët dhe personat e zhvendosur nuk duhet të detyrohen, ose përndryshe të shtrëngohen drejtpërsëdrejti, ose tërthorazi përu kthyer në shtëpitë e tyre të mëparshme, tokat ose në vendbanimet e tyre të përhershme. Refugiatët dhe personat e zhvendosur duhet të kenë mundësi që në mënyrë efektive të gjejnë zgjidhje të qëndrueshme ndaj zhvendosjes, në vend të kthimit, nëse e dëshirojnë një gjë të tillë, pa paragjykuar të drejtën e tyre përi rikthim të pronës së tyre banesore, tokës dhe pronës.



10.4 Shtetet, kur të jetë e domosdoshme, duhet që të kërkojnë nga shtetet tjera ose nga organizatat ndërkombe të ndihmë financiare dhe/ ose teknike të nevojshme përtë lehtësuar kthimin efektiv vullnetar të refugiatëve dhe personave të zhvendosur në mënyrë të sigurt dhe me dinjitet.

## **SEKSIONI V.**

### **MEKANIZMAT E IMPLEMENTIMIT INSTITUCIONAL LIGJOR, TË POLITIKAVE DHE PROCEDURAVE**

#### **11. Përputhshmëria me të drejtat ndërkombe të njeriut, të drejtën ndërkombe humanitare dhe të refugiatëve dhe standardet përkatëse**

11.1 Shtetet duhet të sigurojnë që të gjitha procedurat e rikthimit të pronës banesore, tokës dhe pronës, institucionet, mekanizmat dhe kornizat ligjore të janë në përputhje të plotë me të drejtat ndërkombe të njeriut, të drejtën ndërkombe humanitare dhe të refugiatëve dhe me standardet përkatëse, dhe që e drejta përi kthim vullnetar të sigurt dhe me dinjitet të jetë i përfshirë në to.

#### **12. Procedurat kombëtare, institucionet dhe mekanizmat**

12.1 Shtetet duhet të krijojnë dhe të përkrahin procedurat e barabarta kohore, të pavarura, transparente dhe jo diskriminuese, institucionale dhe mekanizma përvlerësim dhe përzbatim të kërkësave përi rikthim të pronës banesore, tokës dhe pronës. Në rastet kur procedurat ekzistuese, institucionet dhe mekanizmat mund të adresojnë në mënyrë efikase këto çështje, duhet të mundësohen burimet adekuate financiare, njerëzore dhe duhet të vëhen në dispozicion burime tjera përtë lehtësuar rikthimin në mënyrë të drejtë dhe me kohë.

12.2 Shtetet duhet tē sigurojnē qē procedurat e rikthimit tē pronēs banesore, tokës dhe pronēs, institucionet, mekanizmat kanë karakter tē ndjeshëm ndaj moshës dhe gjinisë, dhe njohin tē drejtat e barabarta tē meshkujve dhe femrave, si dhe tē drejtat e barabarta tē djemve dhe vajzave dhe tē reflektojnë parimin madhor tē “interesit më tē mirë tē fëmijës”.

12.3 Shtetet duhet tē ndërmarrin tē gjitha masat e përshtatshme administrative, legjislativë dhe gjyqësore pér tē mbështetur dhe lehtësuar procesin e rikthimit tē pronēs banesore, tokës dhe pronēs. Shtetet duhet t'i sigurojnë tē gjitha agjencive relevante burime adekuate financiare, njerëzore dhe burime tjera pér përbushur me sukses punën e tyre në mënyrë tē drejtë dhe me kohë.

12.4 Shtetet duhet tē hartojinë udhëzime tē cilët do tē siguronin efikasitet tē tē gjitha procedurave relevante tē rikthimit tē pronēs banesore, tokës dhe pronēs, tē institucioneve dhe mekanizmave, përfshirë edhe udhëzime qē përmbajnë organizime institucionale, trajnim tē personelit dhe ngarkesës së rasteve, procedura hetimore dhe ankimore, vërtetim tē pronësisë mbi pronën, ose tē drejta tjera tē posedimit, si dhe mekanizma vendimmarrëse tē zbatimit dhe tē ankimit. Në këto procese, shtetet mund tē integrojnë mekanizma alternative ose mekanizma pér zgjedhjen alternative apo joformale tē konfliktit, përderisa tē gjitha ato mekanizma veprojnë në përputhje me tē drejtat ndërkombe të njeriut, me tē drejtën ndërkombe humanitare dhe tē refugjatëve dhe standartet tjera përkatëse, përfshirë edhe tē drejtën pér tē qenë i mbrojtur nga diskriminimi.

12.5 Aty ku ka prishje tē përgjithshme në sundimin e ligjit, ose kur shtetet nuk kanë mundësi t'i implementojnë procedurat, nuk kanë institucionë dhe mekanizmave tē domosdoshëm pér lehtësimin e procesit tē rikthimit tē pronēs banesore, tokës dhe pronēs, në mënyrë tē drejtë dhe me kohë, shtetet duhet tē kërkojnë ndihmë teknike dhe bashkëpunim tē agjencive relevante ndërkombe të njeriut, me tē drejtën ndërkombe humanitare dhe tē refugjatëve dhe standartet tjera përkatëse, përfshirë edhe tē drejtën pér tē qenë i mbrojtur nga diskriminimi.

12.6 Shtetet duhet tē përfshijnë procedurat e rikthimit tē pronēs banesore, tokës dhe pronēs, institucionet dhe mekanizmat, në marrëveshjet paqësore dhe marrëveshjet pér riadhesim vullnetar. Marrëveshjet paqësore duhet tē përfshijnë hapat e veçantë tē ndërmarra nga palët pér tē adresuar në mënyrë tē përshtatshme çdo çështje tē pronēs banesore, tokës dhe pronēs qē kërkon rregullim sipas së drejtës ndërkombe, ose qē kërcënën procesin paqësor nëse lihet e pa adresuar, përderisa fuqimisht i jep përparësi tē drejtës së rikthimit si mjet i preferuar i rregullimit në këtë rast.

### **13. Qasshmëria e procedurave tē kërkesave pér rikthim**

13.1 Çdonjëri i cili në mënyrë arbitrale ose tē paligjshme është privuar nga e drejta e pronēs banesore, tokës dhe/ose pronēs duhet tē ketë mundësi qē tē parashtrojë kërkesë pér rikthim dhe/ose kompensim pranë një organi tē pavarur dhe tē paanshëm, qē ato organe tē bëjnë përcaktimin pér kërkesën e tyre dhe tē lëshohet një njoftim pér përcaktimin e tillë. Shtetet nuk duhet tē krijojnë parakushte pér parashtrim tē kërkesës pér rikthim.

13.2 Shtetet duhet tē sigurojnë qē tē gjitha aspektet e procesit tē rikthimit, përfshirë procedurat e ankimit, janë tē drejta, kryhen me kohë, jenë tē qasshme, pa pagesë dhe qē janë tē ndjeshme ndaj moshës dhe pér gjinisë. Shtetet duhet tē miratojnë masa pozitive pér tē siguruar qē femrat tē kanë mundësi pjesëmarrjeje në barazi tē plotë në këtë proces.

13.3 Shtetet duhet tē sigurojnë qē fëmijët e ndarë dhe tē pashoqëruar tē kenë mundësi tē marrin pjesë dhe tē janë tē përfaqësuar denjësisht në procesin e parashtrimit tē kërkesës pér rikthim dhe se çdo vendim në lidhje me kërkesën pér rikthim tē fëmijëve tē ndarë dhe pa përcellje tē jetë në përputhje me parimin madhor tē “interesit më tē mirë pér fëmijën”.

13.4 Shtetet duhet tē sigurojnë qē procesi i kërkesës pér rikthim tē jetë i qasshëm pér tē gjithë refugjatët dhe personat tjerë tē zhvendosur, pa marrë parasysh vendbanimin e tyre gjatë periudhës së zhvendosjes, përfshirë shtetet e origjinës, shtetet e azilit, ose shtetet në tē cilat kanë gjetur strehim. Shtetet duhet tē sigurojnë qē tē gjithë personat e prekur tē njoftohen pér procesin e kërkesës pér rikthim, dhe qē informatat pér këtë proces t'u vihen në dispozicion pa vështirësi, përfshirë edhe rastet kur ata janë në shtetet e origjinës, shtetet e azilit, ose shtetet në tē cilët ata kanë gjetur strehim.

13.5 Shtetet duhet tē tentojnë qē tē themelojnë qendra dhe zyra pér procedimin e kërkesave pér rikthim në tërë rajonet e prekura ku parashtruesi potencial i kërkesës aktualisht banon. Pér tē lehtësuar qasjen më tē mirë

të personave të prekur, duhet të mundësohet parashtrimi i kërkesave nëpërmjet postës ose nga një person i autorizuar, ose personalisht. Shtetet gjithashtu duhet të marrin parasysh edhe krijimin e njësive mobile në mënyrë që t'u sigurohet qasje të gjithë parashtruesve potencial të kërkesave.

13.6 Shtetet duhet sigurojnë që shfrytëzuesit e pronës banesore, tokës dhe/ose pronës, përfshirë qiramarrësit, të kanë të drejtë të marrin pjesë në procesin e kërkesave për rikthim, përfshirë këtu parashtrimin e kërkesave të kolektive për rikthim.

13.7 Shtetet duhet të zhvillojnë formularë për kërkesa për rikthim të cilët janë të thjeshtë dhe të lehtë për t'u kupltuar dhe për t'u përdorur dhe të vëhen në dispozicion në gjuhën kryesore, ose në gjuhët e grupeve të prekura. Duhet të vëhet në dispozicion ndihmë kompetente për t'i ndihmuar personat që të kompletojnë dhe parashtrojnë çdo formular të nevojshëm të kërkesës për rikthim, dhe ndihma e tillë duhet të ofrohet në mënyrën që është e ndjeshme ndaj moshës dhe për gjinisë.

13.8 Kur formularët e kërkesave për rikthim të pronës nuk mund të thjeshtësohen aq sa duhet për shkak të ndërlíkueshmërisë së trashëguar në procesin e kërkesave, shtetet duhet të angazhojnë persona të kualifikuar për t'i intervistuar parashtruesit potencial të kërkesave në besueshmëri dhe në mënyrën që është e ndjeshme ndaj moshës dhe gjinisë, në mënyrë që të pranojnë informata të nevojshme dhe të kompletøjnë formularët e kërkesave për rikthim në emër të tyre.

13.9 Shtetet duhet të përcaktojnë një periudhë të qartë kohore për parashtrimin e kërkesave për rikthim. Kjo informatë duhet të shpérndahet gjérësisht dhe duhet që të jetë mjaftë e gjatë për të siguruar që të gjithë personat e prekur të kanë mundësi adekuate për të parashtruar një kërkesë për rikthim, duke marrë para sysh numrin e parashtruesve potencial të kërkesave, vështirësitet e mundshme të marrjes dhe qasjes në informata, madhësinë e zhvendosjes, qasjen në proces të grupeve të pafavorizuara dhe individëve të cenuar, dhe situatën politike në shtetin, apo rajonin e origjinës.

13.10 Shtetet duhet të sigurojnë që personat që kanë nevojë për ndihmë të posaçme, duke përfshirë personat analfabetë dhe personat me aftësi të kufizuara, t'u ofrohet kjo ndihmë në mënyrë që të sigurohet që atyre të mos iu mohohet qasia në procesin e kërkesave për rikthim.

13.11 Shtetet duhet të sigurojnë që të ofrohet ndihë adekuate juridike, nëse është e mundur pa pagesë, për ata që kërkojnë të parashtrojnë kërkesë për rikthim. Përderisa ndihma juridike mund të ofrohet nga burimet qeveritare ose jo-qeveritare (si kombëtare, ashtu edhe ndërkombëtare), një ndihmë e tillë ligjore duhet t'i përbushë standardet adekuate të cilësisë, mosdiskriminimit, drejtësisë dhe paanshmërisë në mënyrë që to mos paragjykohet procesi i parashtrimit të kërkesave për rikthim.

13.12 Shtetet duhet të sigurojnë që askush të mos ndiqet penalisht, ose të mos dënöhët për shkak të parashtrimit të kërkesës për rikthim.

## 14. Konsultimi dhe pjesëmarrja adekuate në vendimmarrje

14.1 Shtetet dhe akterët tjerë të përfshirë kombëtarë dhe ndërkombëtarë duhet të sigurojnë që programet për riatthesim vullnetar dhe ato për rikthimin e pronave banesore, tokave dhe për pronave të zbatohen në konsultime adekuate dhe me pjesëmarrje të personave, grupeve dhe komuniteteve të prekura.

14.2 Shtetet dhe akterët tjerë të përfshirë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, në veçanti duhet të sigurojnë që femrat, popullata autoktone, pakicat etnike dhe racore, pleqtë, personat me aftësi të kufizuara dhe fëmijët të përfaqësohen në mënyrë adekuate dhe të përfshihen në proceset e vendimmarrjes për rikthim, dhe të kenë mjete të përshtatshme dhe informata për pjesëmarrje efektive. Duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë nevojave të personave të cenuar përfshirë pleqtë, kryefamiljarët gra të pamartuara, fëmijët e ndarë dhe pa përcjellje, si dhe personat me aftësi të kufizuara.

## 15. Regjistrat dhe dokumentacioni për prona banesore, toka dhe pronë

15.1 Shtetet duhet të krijojnë ose rikrijojnë sisteme kombëtare për shumë qëllime kadastrale, ose sisteme tjera të përshtatshme për regjistrimin e të drejtave banesore, tokësore dhe pronësore si komponentë e pandashme e çdo programi të rikthimit, duke respektuar të drejtat e refugiatëve dhe personave të zhvendosur gjatë procedurave të tillë.

15.2 Shtetet duhet të sigurojnë që çdo deklaratë gjyqësore, kuazi-gjyqësore, administrative ose zakonore lidhur me pronën legjitime, ose të drejtat në pronë banesore, tokë dhe/ose pronë të përcillet me masa për të siguruar regjistrimin ose demarkacionin e asaj prone banesore, toke dhe/ose prone në atë mënyrë që është e është e nevojshme për të ofruar siguri ligjore të posedimit. Këto përcaktimet duhet të përputhen me të drejtat ndërkombëtare të njeriut, me të drejtën ndërkombëtare humanitare dhe për refugjat dhe me standardet përkatëse, duke përfshirë të drejtën për të qenë i mbrojtur nga diskriminimi.

15.3 Shtetet duhet të sigurojnë, kurdo që të jetë e duhur, që sistemet e regjistrimit të regjistrojnë dhe/ose të njohin të drejtat e posedimit të tokave kolektive komuniteteve autoktone tradicionale.

15.4 Shtetet dhe autoritetet tjera përgjegjëse ose institucionet duhet të sigurojnë që sistemet e tanishme të regjistrimit të mos shkatërrohen gjatë kohës së konfliktit, ose pas konfliktit. Masat për parandalimin e shkatërrimit të regjistrave të pronës banesore, tokës dhe/ose pronës mund të përfshijnë mbrojtjen në vendin ku gjenden, ose kur të jetë e domosdoshme, zhvendosjen për një kohë të shkurtë në një vend apo lokacion të sigurt. Nëse zhvendosen, regjistrat duhet të kthehen sa më shpejt që të jetë e mundur pa përfundimit të armiqësive. Shtetet dhe autoritetet tjera përgjegjëse gjithashtu marrin parasysh krijimin e procedurave për kopjin e regjistrave (përfshirë edhe formatin digital), transferimin e tyre në mënyrë të sigurt dhe njohjen e originalitetit të kopjeve të sipërpermendura.

15.5 Shtetet dhe autoritetet ose institucionet tjera përgjegjëse me kërkesë të parashtruesit të kërkesës ose të personit të autorizuar nga ai/ajo duhet të sigurojnë, kopje të se cilës dëshmi të dokumentuar në posedim të tyre që kërkohet për të parashtruar dhe/ose mbështetur kërkesën për rikthim. Një dëshmi e tillë e dokumentuar duhet të ofrohet pa pagesë, ose me një tarifë shumë të ulët.

15.6 Shtetet dhe autoritetet apo institucionet tjera përgjegjëse të cilat bëjnë regjistrimin e refugjatëve apo personave të zhvendosur, duhet të bëjnë përpjekje për të mbledhur informata relevante për të lehtësuar procesin e rikthimit, për shembull, përfshirjen e pyjetes për vendndodhjen dhe statusin e ish shtëpisë, tokës, pronës apo vendbanimin e refugiatit apo personit individual në formularët e regjistrimit. Informatat e tillë duhet të kërkohen kurdo që të mblidhen informata nga refugjatët apo personat e zhvendosur, përfshirë edhe informata mbi kohën e ikjes.

15.7 Shtetet në shumë situata të zhvendosjes masive ku ekzistonjë shumë pak dëshmi të dokumentuara, mund të miratojnë një supozim përfundimtar, që personat të cilët kanë ikur nga shtëpitë e tyre gjatë një periudhe të caktuar të dhunës apo katastrofës e kanë bërë një gjë të tillë për arsy që janë të ndërlidhura me dhunën apo katastrofën dhe prandaj kanë të drejtë në rikthimin e pronës banesore, tokës dhe pronës. Në raste të tillë, autoritetet gjyqësore dhe administrative minden, në mënyrë të pavarrur të nxjerrin fakte të lidhura me kërkesat e padokumentuara për rikthim.

15.8 Shtetet nuk njohin si të vlefshëm asnjë shitblerje të pronës banesore, tokës apo pronës, përfshirë çdo transferim i cili është bërë me detyrim, apo i cili është bërë nën ndikim të shtrëngimit apo dhunës, qoftë drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë, apo i cili është bërë në kundërshtim me standardet ndërkombëtare të drejtave të njeriut.

## **16. Të drejtat e qiramarrësve dhe jopronarëve tjerë**

16.1 Shtetet duhet të sigurojnë që të drejtat e qiramarrësve, bartësit e të drejtave të banimit social dhe banuesit tjerë të ligjshëm apo shfrytëzuesit e pronës banesore, tokës apo pronës të njihen brenda programeve të rikthimit. Deri në masën më të madhe të mundshme, shtetet duhet të sigurojnë që personat e tillë të kenë mundësinë e kthimit dhe të kenë në shfrytëzim dhe pronësi të serishme pronën e tyre banesore, tokët dhe pronët në të njëjtën mënyrë sikur ata të cilët posedojnë të drejta formale të pronësisë.

## **17. Banuesit sekondar**

17.1 Shtetet duhet të sigurojnë që banuesit sekondar të mbrohen kundër dëbimit të dhunshëm dhe arbitrar. Shtetet sigurojnë, në rastet kur dëbimet e banuesve të tillë konsiderohen si të arsyeshme dhe të pashmangshme për qëllime të rikthimit të pronës banesore, tokës dhe pronës, që dëbimi të kryhet në atë mënyrë që është në përputhje me të drejtën dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe të jetë i tillë që banuesve sekondar t'u sigurohen garanci për një proces të drejtë, përfshirë mundësinë për konsultim të mirëfilltë, njoftim adekuat dhe të arsyeshëm, dhe sigurim të mjeteve juridike, përfshirë mundësinë për një rishqyrtim ligjor.

17.2 Shtetet duhet tē sigurojnē qē garancitē pēr njē proces tē rregullt tē cilat u pērkasin banuesve sekondar tē mos paragjykojnē tē drejtat e pronarëve legjitim, qiramarrësve dhe tē bartësve tjerë tē drejtave pēr kthim nē posedim tē pronēs banesore, tokës dhe pronēs nē fjalë nē njē mënyrë tē drejtē dhe brenda njē afati tē caktuar kohor.

17.3 Në raste kur dëbimet e banuesve sekondar janë tē arsyeshme dhe tē pashmangshme, shtetet duhet tē marin masa pozitive pēr tē mbrojtur ata tē cilët nuk kanë mundësi pēr tē pasur qasje nē asnjë strehim tjetër nga ai nē tē cilin gjenden aktualisht, nga tē qenit tē pastrehë dhe nga shkeljet tjera tē drejtës së tyre pēr strehim adekuat. Shtetet duhet tē zotohen pēr tē identifikuar dhe siguruar strehim alternativ dhe/apo tokë pēr banues tē tillë, qoftë edhe pērkohësisht, si mjet pēr lehtësimin e rikthimit me kohë tē pronēs banesore tokës dhe pronēs së refugjatëve dhe personave tē zhvendosur. Sidoqoftë, mungesa e alternativave tē tilla nuk duhet qē nē mënyrë tē panevojshme ta vonojë implementimin dhe zbatimin e vendimeve tē organeve relevante nē lidhje me rikthimin e pronēs banesore tokës dhe pronēs.

17.4 Në rastet kur prona banesore, toka dhe prona janë shitur nga ana e banuesit sekondar palëve tē treta dhe kur kjo është bërë me mirëbesim, shtetet mund tē shqyrtojnë themelimin e mekanizmave pēr tē siguruar kompensim pēr palët e treta tē dëmtuara. Skandaloziteti i zhvendosjes nē fjalë, megjithatë, mund tē shërbejë si njoftim konstruktiv pēr paligjshmérinë e blerjes së pronēs së braktisur, duke nxitur kështu formimin e interesave me mirëbesim nē raste tē tilla.

## 18. Masat Legjislativë

18.1 Shtetet duhet tē sigurojnē qē e drejta e refugjatëve dhe personave tē zhvendosur pēr rikthim tē pronēs banesore, tokës dhe pronēs tē njihet si një komponentë thelbësore e sundimit tē ligjit. Shtetet duhet tē sigurojnē tē drejtën pēr rikthim tē pronēs banesore, tokës dhe pronēs përmes tē gjitha mjeteve tē nevojshme legjislativë, përfshirë përmes miratimit, ndryshimit, reformimit, apo shfuqizimit tē ligjeve relevante, rregulloreve dhe praktikave. Shtetet duhet tē zhvillojnë një kornizë ligjore pēr mbrojtjen e rikthimit tē pronēs banesore, tokës dhe pronēs, e cila duhet tē jetë e qartë, konsistente dhe aty ku kërkohet, e konsoliduar nē një ligj tē vetëm.

18.2 Shtetet duhet tē sigurojnē qē tē gjitha ligjet relevante nē mënyrë tē qartë tē pëershkruanjë çdo person apo grup tē prekur i cili ligjërisht ka tē drejtë nē rikthim tē pronēs banesore, tokës dhe pronēs, duke i theksuar më së shumti refugjatët dhe personat e zhvendosur. Parashtreesit subsidiar tē kërkësës duhet tē njihen njësoj, përfshirë anëtarët e tyre tē familjes nē kohën e zhvendosjes, bashkëshortët, partnerët nē banim, ata nē varësi, trashëgimtarët ligjor dhe tē tjerët tē cilët duhet tē kanë tē drejtë tē bëjnë kërkësë mbi bazë tē njëjtë si edhe parashtreesit kryesor tē kërkësës.

18.3 Shtetet duhet tē sigurojnē qē legjislationi vendor pēr rikthim tē pronēs banesore, tokës dhe pronēs tē jetë konsistent përbrenda, si dhe nē përputhshmëri me marrëveshjet relevante tē cilat kanë ekzistuar më parë, sic janë marrëveshjet pēr paqe dhe marrëveshjet pēr riadhesim tē vullnetshëm, përderisa vetë këto marrëveshje janë nē përputhshmëri me tē drejtat ndërkombëtare e njeriut, tē drejtën humanitare dhe pēr refugjatë dhe standardet përkatëse.

## 19. Ndalimi i ligjeve arbitrale dhe diskriminuese

19.1 Shtetet nuk duhet as tē nxjerrin e as tē aplikojnë lige tē cilat paragjykojnë procesin e rikthimit, posaçërisht përmes ligjeve dhe kufizimeve ligjore tē cilat janë arbitrale, diskriminuese apo tē padrejta tē braktisjes.

19.2 Shtetet duhet tē marrin masa tē menjëherëshme pēr tē shfuqizuar ligjet e padrejta dhe arbitrale dhe ligjet tē cilat kanë efekt diskriminues nē gjëzimin e tē drejtës pēr rikthim tē pronēs banesore, tokës dhe pronēs, dhe duhet tē sigurojnë mjete juridike pēr ata tē cilët janë dëmtuar gabimisht nga zbatimi i mëherëshëm i ligjeve tē tilla.

19.3 Shtetet duhet tē sigurojnē qē tē gjitha politikat kombëtare qē kanë tē bëjnë me tē drejtën pēr rikthim tē pronēs banesore, tokës dhe pronēs, tē garantojnë nē mënyrë tē plotë tē drejtat e femrave dhe vajzave pēr mbrojtje nga diskriminimi dhe tē janë tē barabarta si me ligj ashtu edhe nē praktikë.

## 20. Zbatimi i vendimeve dhe aktgjykimeve pēr rikthim

20.1 Shtetet duhet tē caktojnë agjencione tē posaçme publike tē cilëve do t'ju besohet zbatimi i vendimeve dhe aktgjykimeve qē kanë tē bëjnë me pronën banesore, tokën dhe pronën.

20.2 Shtetet duhet tē sigurojnē, përmes ligjit ose mjeteve tjera tē duhura, që autoritetet lokale dhe kombëtare tē janë tē obliguara sipas ligjit tē respektojnë, implementojnë dhe zbatojnë vendimet dhe aktgjykit e marra nga organet relevante në lidhje me rikthim e pronës banesore, tokës dhe pronës.

20.3 Shtetet duhet tē miratojnë masa specifike për tē parandaluar pengimin nga ana e popullatës së zbatimit tē vendimeve dhe aktgjykimeve që kanë tē bëjnë me rikthimin e pronës banesore, tokës dhe pronës. Kërcënimet apo sulmet kundër zyrtarëve dhe agjencive tē cilat i zbatojnë programet e rikthimit duhet tē hetohen në tërësi dhe tē ndiqen.

20.4 Shtetet duhet tē miratojnë masa specifike për tē parandaluar shkatërrimin apo grabitjen e pronave banesore, tokave dhe pronave tē kontestuara apo tē braktisura. Në mënyrë që tē minimizohet shkatërrimi dhe grabitia, shtetet duhet tē zhvillojnë procedura për tē inventarizuar përbajtjen e pronave banesore, tokës dhe pronave tē cilat janë objekt i kërkësave, brenda kontekstit tē programeve tē rikthimit tē pronës banesore, tokës dhe pronës.

20.5 Shtetet duhet tē implementojnë fushata për informim publik, me synim tē informimit tē banuesve sekondar dhe palëve tjera relevante rreth the drejtave tē tyre dhe rreth pasojave ligjore në rast tē mosrespektimit tē vendimeve dhe aktgjykimeve lidhur me rikthimin e pronës banesore, tokës dhe pronës, përfshirë edhe mos lëshimin e pronës banesore, tokës dhe pronës së uzurpuar, në mënyrë tē vullnetshme dhe dëmtim dhe grabitje tē pronës banesore, tokës dhe pronës.

## **21. Kompensimi**

21.1 Të gjithë refugjatët dhe personat e zhvendosur kanë tē drejtë në kompensim tē plotë dhe efektiv si komponentë e pandashme e procesit tē kthimit. Kompensimi mund tē jetë në para apo në natyrë. Në mënyrë që tē jenë në përputhshmëri me parimet e drejtësisë restorative, shtetet sigurojnë që rregullimi përmes kompensimit tē përdoret vetëm kur rregullimi me kthim është faktikisht i pamundshëm, apo kur pala e dëmtuar me dashje dhe vullnetarisht pranon kompensimin si rikthim, apo kur kushtet e zgjidhjes së negociuar paqësore sigurojnë një kombinim tē rikthimit dhe kompensimit.

21.2 Shtetet duhet tē sigurojnë, si rregull që rikthimi tē konsiderohet faktikisht i pamundshëm, vetëm në rrethana përjashtimore, pra vetëm kur prona banesore, toka dhe prona është shkatëruar apo kur nuk ekziston më, sipas përcaktimit nga një tribunal i paanshëm dhe i pavarur. Edhe në rrethana tē tilla bartësi i tē drejtës banesore, tokësore dhe pronësore duhet tē ketë mundësi ta rregullojë apo rindërtojë atë kurdo që është e mundshme. Në disa situata kombinimi i kompensimit the rikthimit mund tē jetë mjeti dhe forma më e mirë e drejtësisë restorative.

## **NENI VI. ROLI I BASHKËSISË NDËRKOMBËTARE, PËRFSHIRË EDHE ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE**

### **22. Përgjegjësia e bashkësisë ndërkombëtare**

22.1 Bashkësia ndërkombëtare duhet tē promovojë dhe mbrojë tē drejtën në kthim tē pronës banesore, tokës dhe pronës, si dhe tē drejtën për kthim tē sigurt dhe tē dinjitetshëm.

22.2 Institucionet ndërkombëtare financiare, tē tregtisë dhe institucionet dhe agjencionet e ndërlidhura me to, përfshirë anëtarët apo shtetet donatore tē cilat kanë tē drejtë vote në organe tē tilla, duhet tē marrin plotësisht në konsideratë ndalimin kundër zhvendosjes së paligjshme dhe arbitrage dhe posaçërisht, ndalimin sipas së drejtës ndërkombëtare për tē drejtat e njeriut dhe standarde tē ndërlidhura me to tē praktikave tē dëbimeve tē dhunshme.

22.3 Organizatat ndërkombëtare duhet tē punojnë së bashku me qeveritë nacionale dhe tē ndajnë përvojën rreth zhvillimeve tē politikave dhe programeve tē kthimit tē pronës banesore, tokës dhe pronës dhe tē ndihmojnë për tē siguruar përputhshmëri me tē drejtat ndërkombëtare tē njeriut, tē drejtën humanitare dhe tē refugjatëve dhe standardeve përkatëse. Organizatat ndërkombëtare duhet gjithashtu tē mbështesin monitorimin e implementimit tē tyre.

22.4 Organizatat ndërkombëtare, përfshirë Organizatën e Kombeve të Bashkuara, duhet tē bëjnë përpjekje tē sigurojnë që marrëveshjet e paqes dhe marrëveshjet për kthim vullnetar tē përbajnë dispozita në lidhje me

rikthimin e pronës banesore, tokës dhe pronës, përfshirë edhe përmes themelimit të procedurave kombëtare, institucioneve, mekanizmave dhe kornizave ligjore.

22.5 Operacionet ndërkombejtare paqësore, në ushtrimin e mandatit të tyre të përgjithshëm, duhet të ndihmojë në ruajtjen një ambienti të sigurt dhe stabil, brenda të cilit politikat dhe programet e rikthimit të pronës banesore, tokës dhe pronës mund të implementohen dhe zbatohen me sukses.

22.6 Operacionet ndërkombejtare të pages varësisht nga konteksti i misionit të tyre, duhet të kërkohen që të sigurojnë mbështetje dhe mbrojtje të drejtës për rikthim të pronës banesore, tokës dhe pronës, përfshirë edhe përmes zbatimit të vendimeve dhe aktgjykimeve për rikthim. Anëtarët e Këshillit të Sigurimit duhet të marrin në konsideratë përfshirjen e këtij roli në operacionet paqësore.

22.7 Organizatat ndërkombejtare dhe operacionet paqësore duhet t'i shmanget uzurpimit, marrjes me qira apo blerjes së pronës banesore, tokës apo pronës ndaj të cilës titullari i saj ende nuk ka qasje apo kontroll, dhe duhet të kërkojë që edhe personeli i tyre të veprojë në këtë mënyrë. Ngashëm me këtë, organizatat ndërkombejtare dhe operacionet paqësore duhet të sigurojnë që organet apo proceset të cilat janë nën kontrollin dhe mbikëqyrjen e tyre të mos pengojnë, drejtpërdrejt apo têrthorazi, procesin e rikthimit të pronës banesore, tokës dhe pronës.

## NENI VII. INTERPRETIMI

### 23. Interpretimi

23.1 Parimet për rikthim të pronës banesore, tokës dhe pronës për refugjatë dhe persona të zhvendosur nuk interpretohen si kufizim, ndryshim apo paragjykim i të drejtave të njoitura si të drejta ndërkombejtare të njeriut, të njoitura nga e drejta humanitare dhe për refugjatë dhe standarde relevante, apo të drejtat të cilat janë në përputhje me këto ligje dhe standarde të njoitura nga e drejta vendore.



**Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë**

**Misioni në Kosovë**

**Departamenti për të Drejtat e Njeriut, Decentralizim dhe Komunitete**

**Tetë vjet më pas**

**Kthimet e minoriteteve dhe rikthimi i pronës banesore dhe pronës në Kosovë**

*Qershor 2007*

**TABELA E PËRMBAJTJES**

<b>FJALORTHI I SHKURTESAVE</b>	<b>3</b>
<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	<b>5</b>
<b>REKOMANDIMET</b>	<b>8</b>
PËR QEVERINË E KOSOVËS	8
Për Ministrinë për Komunitete dhe Kthim	8
Për Agjencinë Kosovare të Pronës	8
Për komunat	8
Për Shërbimin Policor të Kosovës	9
Për Institutin Gjyqësor të Kosovës	9
Për Ministrinë e Serbisë për Kosovën	9
Për UNHCR-në	9
Për Departamentin e Drejtësisë të UNMIK-ut	9
Për Zyrën për Komunitete, Kthim dhe Pakica të UNMIK-ut	10
Për Zyrën e Këshilltarit Ligjor të UNMIK-ut	10
Për Ekipin Planifikues të Bashkimit Evropian	10
Për donatorët ndërkombëtarë	10
<b>1. HYRJE: TË DREJTAT E PERSONAVE TË ZHVENDOSUR DHE REFUGJATËVE PËR KTHIM DHE PËR RIKTHIM TË PRONËS BANESORE DHE PRONËS.</b>	<b>11</b>
<b>2. STRUKTURAT DHE PROCEDURAT E PROCESIT TË KTHIMIT</b>	<b>13</b>
a) FINANCIMI I PROJEKTEVE PËR KTHIM DHE RIINTEGRIM	17
b) Verifikimi i të drejtave pronësore	17
c) Përgjedhja e përfituesve	18
d) Ndarma e hapësirës së banimit dhe e tokës	19
f) Strategjitet komunale për kthim dhe planet zhvillimore komunale	20
g) Pjesëmarja e personave të zhvendosur	21
h) Qasja në banim e personave të zhvendosur në vendin e tyre aktual të banimit	21
i) Riatalogimi i detyrueshëm	22
<b>3. PROCESI I RIKTHIMIT TË PRONËS BANESORE DHE PRONËS</b>	<b>23</b>
a) QASJA NË MEKANIZMAT PËR KËRKESA	25
b) Vënia në zbatim e kërkësave dhe efekti i tyre në kthim	26
c) Kompensimi	27
d) Administrimi i pronave të braktisura	27

<b>4. KËRKESAT E PEZULLUARA NË VITIN 2004 PËRKITAZI ME DËMET QË LIDHEN ME KONFLIKTIN DHE SFIDAT TJERA QË KANË TË BËJNË ME ZHVENDOSJET</b>	<b>29</b>
A) KËRKESAT KUNDËR UNMIK-UT, KFOR-it, IPVQ-ve dhe individëve të pezulluara në vitin 2004	29
b) Transaksionet mashtruese	31
c) Shfrytëzimi i parregullt i përfaqësuesve të përkohshëm	31
d) Mungesa e mbrojtjes efikase të pronave të pakicave dhe të kthyerve	31
<b>5. PROGRAMI I RINDËRTIMIT PAS TRAZIRAVE TË MARSIT 2004</b>	<b>32</b>
<b>6. KONKLUZIONET</b>	<b>34</b>

## FJALORTHI I SHKURTESAVE

<b>ASB</b>	Arbeiter-Samariter-Bund
<b>QKK</b>	Qendra Koordinuese për Kosovën
<b>KShE</b>	Kryeshef ekzekutiv
<b>KNMR</b>	Komisioni Ndërministror për Rindërtim
<b>GKKK</b>	Grupi për Kontaktim dhe Komunikim me Komunitete
<b>MQSh</b>	Mekanizmi Qendror i Shqyrtimit
<b>DiD</b>	Departamenti i Drejtësisë
<b>KEDNj</b>	Konventa Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut
<b>EPBE</b>	Ekipi Planifikues i Bashkimit Evropian
<b>KKPB</b>	Komisioni për Kërkesa Pronësore Banesore
<b>DÇPB</b>	Drejtoria për Çështje Pronësore Banesore
<b>PNDCP</b>	Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike
<b>PZhBV</b>	Personat e zhvendosur brenda vendit
<b>KFOR</b>	Forca e Kosovës
<b>AKP</b>	Ajencija Kosovare e Pronës
<b>TMK</b>	Trupat Mbrojtëse të Kosovës
<b>KKPK</b>	Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës
<b>KKK</b>	Kryetari i kuvendit komunal
<b>MKK</b>	Ministria për Komunitete dhe Kthim
<b>PZhK</b>	Planet zhvillimore të komunës
<b>KKB</b>	Këshillat komunale të banimit
<b>PK</b>	Përfaqësuesi komunal
<b>ZKK</b>	Zyrtari komunal për kthim
<b>SKK</b>	Strategjitet komunale të kthimit
<b>GPK</b>	Grupi punues komunal
<b>NATO</b>	Organizata e Paktit të Atlantikut Verior
<b>OJQ</b>	Organizata joqeveritare
<b>ZKKÇP e UNMIK-ut</b>	Zyra e UNMIK-ut për Komunitete, Kthim dhe Çështje të Pakicave
<b>ZKL e UNMIK-ut</b>	Zyra e Këshilltarit Ligjor të UNMIK-ut
<b>OSBE</b>	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
<b>IPVQ</b>	Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes
<b>PSSP</b>	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
<b>MTP</b>	Marrëveshja trepalëshe

<b>NjPO</b>	Njësia punuese operative
<b>DUDNJ</b>	Deklarata Universale mbi të Drejtat e Njeriut
<b>UNDP</b>	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
<b>UNHCR</b>	Komisariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
<b>UNMIK</b>	Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë
<b>UNOSEK</b>	Zyra e të Dërguarit të Posaçëm të Kombeve të Bashkuara për Kosovën

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Rikthimi i pronës banesore dhe pronës, si dhe kthimi i personave të zhvendosur pas konfliktit janë procese të ndara, por të ndërlidhura dhe të ndërvarura që kërkojnë planifikim strategjik, ku përfshihen të gjithë faktorët në mënyrë që të jetë i suksesshëm. Rikthimi i pronës banesore dhe pronës, i kombinuar me elementet mbrojtëse të sigurisë dhe ofrimi i mundësive për zhvillim socio-ekonomik janë parakushte për kthim të qëndrueshëm të personave të zhvendosur dhe të refugjatëve.

E drejta e refugjatëve dhe e personave të zhvendosur për kthim dhe rikthimi i pronës banesore dhe pronës nijhet me standartet ndërkombëtare. Si rrjedhojë e së drejtës së refugjatëve dhe të zhvendosurve në kthim, si dhe implikimet e saj me të drejtën në pronë dhe në ndihme juridike, në praktike më tej interpretohen në ‘parimet mbi rikthimin e pronës banesore dhe të pronës për refugjatët dhe personat e zhvendosur’ që u miratuan nga Nënkomisioneri i KB-ve mbi Promovimin dhe Mbrotjtjen e të Drejtave të Njeriut në vitin 2005.

Kthimi i pakicave në Kosovë ka qenë i pakët megjithë krijimin e gjithanshëm të mekanizmave dhe të strategjive për kthim nga bashkësia ndërkombëtare dhe IPVQ-të. Fakti se kthimi mbetet prioritet tetë vite pas konfliktit pasqyron realitetin se të gjitha mekanizmat dhe strategjitë e krijuara nuk kanë qenë të suksesshme në ofrimin e mbrojtjes adekuate të së drejtës për kthim.

Si rrjedhojë është riafirmuar zotimi për të siguruar kthimin vullnetar të pakicave në propozimin e gjithanshëm të kohëve të fundit për zgjidhjen e statusit të Kosovës. Së fundi, Këshilli i Evropës ka nënvizuar rëndësinë e këtij objektivi para Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm.

Arsyet për numrin e pamjaftueshëm të kthimit të pakicave në Kosovë janë të shumëfishata. Disa nga konstatimet kryesore të këtij raporti që tregojnë shkallën e problemit janë si vijon:

- Në qershor të vitit 2007, 10,405 prona banimi që u përkasin personave të zhvendosur mbeten të shkatërruara;<sup>26</sup>
- Që nga qershori i vitit 2007, Agjencia Kosovare e Pronës (AKP), pasuesi i Dreitoratit për Çështje Pronësore Banësore (DÇPB), ka pranuar më shumë se 23,629 kërkesa për pronën private banesore, bujqësore dhe komerciale;
- Më shumë se 20,000 kërkesa me të cilat kërkohen kompensime për dëmet që lidhen me luftën aktualisht janë pezulluar dhe janë në pritje për një zgjidhje adekuate;
- Mijëra persona mbeten të zhvendosur brenda dhe jashtë Kosovës që nga konflikti i vitit 1999 – disa si pasojë e trazirave të marsit 2004 - dhe, për arsyet e tyre nuk kanë zgjedhur të kthehen në shtëpitë e tyre dhe t'i rikthejnë posedimet e tyre.<sup>27</sup>

Nuk është për t'u befasuar, shumë persona të zhvendosur dhe refugjatë kanë filluar një jetë të re diku tjetër dhe nuk kanë ndërmend të kthehen në vendet e tyre të origjinës. Disa syresh i kanë shitur pronat e tyre. Shumë prej tyre jetojnë në kushte të këqija të banimit në zonat tjera të Kosovës dhe në Serbi.

Nëpërmjet aktiviteteve të veta të monitorimit dhe të pranisë së vet në Kosovë, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) ka vlerësuar realizimin praktik të procesit të rikthimit të pronës banesore dhe të pronës si dhe të kthimit në Kosovë.

Në këtë raport analizohen në mënyrë të thukët: krijimi i strukturave të reja që merren me kthimin, procesi i rikthimit të pronës banesore dhe pronës, zgjidha e kërkeseve që lidhen me dëmin e shkaktuar nga konflikti dhe sfidat e tjera relevante për mbrojtjen e të drejtave të personave të zhvendosur. Po ashtu është analizuar edhe Programi i Rindërtimit nga Trazirat e Marsit 2004, si përgjigje ndaj krizës që përkohësisht kishte e ndalur kthimin dhe rikthimin e pronës banesore dhe pronës.

Ky vlerësim përqendrohet në kthimin vullnetar dhe në riintegrin dhe nuk i vlerëson në mënyrë të thukët sfidat që kanë rrjedhur si pasojë e rritjes së numrit të riatdhesimeve të detyrueshme për në Kosovë, e as të gjendjes

<sup>26</sup> Burimi: Faqja e internetit e Dreitoratit për Çështje Pronësore Banësore. Ky vlerësim çon në shifra më të ulëta të popullatës së mbetur të zhvendosur krasuar me vlerësimet e QKK-së dhe UNHCR-së dhe më afér përllogaritjeve të Iniciativës së Stabilitetit European.

<sup>27</sup> Burimet e Qendrës Koordinuese për Kosovën kanë të regjistruar deri në 242,381 persona që i përkasin komunitetit serb të Kosovës dhe atij RAE që janë zhvendosur brenda dhe jashtë Kosovës. Burimi nga faqja e internetit të QKK-së (<http://www.kc.gov.yu/D-ENGLISH/dokumenti-eng/program-povratka-eng.html>) e vizituar më 31 janar 2007. OJQ-ja, Iniciativa për Stabilitetit European (ISE) konsideron se dy të tretat e popullatës serbe të Kosovës të paraluftës kanë mbetur në Kosovë, dhe vlerëson shifrat e të zhvendosurve jashtë Kosovës në 65,000, ndërkëq shifra e serbëve të Kosovës që jetojnë në Kosovë është në 130,000.

së azilkërkuesve dhe të refugjatëve. Ai nuk i trajton në mënyrë të gjithanshme të gjitha sfidat lidhur me mbrojtjen e personave të zhvendosur dhe të refugjatëve, e as që i mbulon tërësisht ndërhyrjet në të drejtat e njeriut të uzurpuesve të dytë të pronës banesore, tokës ose pronës që duhet të kthehet. Në vend të kësaj, ai përqendrohet në disa fusha specifike ku mund të arrihet njëfarë përparimi. Në tërë raportin, OSBE-ja përdor parimet e KB-ve mbi rikthimin e pronës banesore dhe pronës pér refugjatët dhe personat e zhvendosur (që ndryshe njihen si "Parimet e Pinheiros"), si një mjet analistik<sup>28</sup>.

OSBE-ja ka identifikuar fusha të ndryshme të cilave duhet t'u kushtohet vëmendje e mëtejshme. Sa i përket zbatimit të reformave strukturore në procesin e kthimit, shqetësimet kryesore janë si vijon:

- Financimi i projekteve të kthimit;
- elementet mbrojtëse të së drejtës në pronë në projektet e kthimit;
- udhëzimet mbi procedurat pér ndarje të pronës banesore dhe të tokës;
- integrim të kthimit dhe të mbrojtjes së personave të zhvendosur në planet zhvillimore të komunës;
- pjesëmarria efektive të personave të zhvendosur, dhe
- ndërmarrja e masave pér të përmirësuar kushtet e banimit të personave të zhvendosur aty ku ata aktualisht jetojnë.

Për më tepër, OSBE-ja ka identifikuar një numër të shqetësimeve sa i përket mbrojtjes së të drejtave të personave të zhvendosur dhe të refugjatëve, siç janë:

- Ekzistimi i një ngarkese me lëndë të pazgjidhura të kërkесave pér kompensim,
- Mungesa e përgjigjeve efikase ndaj transaksioneve mashtuese,
- Shfrytëzimi i parregullit i përfaqësuesve nëpër gjykata,
- Mungesa e mbrojtjes efikase të pronave të rindërtuara e që janë të zbrazëta.

Sa i përket mandatit të Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP), sfidat kryesore lidhen me zbatimin e vendimeve të Komisionit pér Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK). Kështu që është me rëndësi të sigurohet miratimi i legjislacionit plotësues, si dhe që iniciativat e rëndësishme në vazhdim e sipër, siç është skema e qiradhënieve, të zbatohen në mënyrë adekuate. Mundësia e administrimit të tokës si mijet juridik pér parashtruesit e suksesshëm të kërkësave, krijon mundësi si pér zhvillim ekonomik lokal rural, ashtu edhe pér të ardhura të rregullta pér personat e zhvendosur. Koordinimi i AKP-së dhe përfshirja e saj në strukturat e kthimit do të ndihmonte në artikulimin e implikimeve të çështjeve të pronës banesore dhe të tokës në procesin e kthimit.

OSBE-ja beson se aspektet e pronës banesore, tokës dhe të drejtave në pronë të strategjisë së gjithanshme të hartuar nga KB-të dhe IPVQ-të duhet të fuqizohen dhe t'u përcaktohen prioritetet në kontekstin e transicionit të statusit dhe që të bëhen pjesë përbërëse e planeve pér implementimin e statusit. Kjo do të ndihmojë në parandalimin e zhvendosjeve në të ardhmen dhe do të mundësojë kushte më të mira jetese pér personat e zhvendosur.

<sup>28</sup> Këto parime kishin marrë mbështetjen formale nga Nënkomisioni i Kombeve të Bashkuara pér Promovimin dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, të datës 11 gusht 2005. (Parimet mbi Rikthimin e Pronës Banasore dhe Pronës pér Refugjatët dhe Personat e Zhvendosur. E/CN.4/Sub.2/2005/17)

## **REKOMANDIMET**

### **Për Qeverinë e Kosovës**

Të hartojë një strategji dhe plan veprimi mbi kthimin, riintegrin, rikthimin e pronës banesore dhe pronës në përputhje me strategjinë e saj të përgjithshme për të drejtat e njeriut.

Të implementojë, në mënyrë të duhur, Protokollin mbi kthimin vullnetar dhe të qëndrueshëm, në bashkëpunim me UNMIK-un dhe Republikën e Serbisë.

Të sigurojë funksionimin dhe qasjen në panelin e kërkeseve ndaj Programit të Rindërtimit të Marsit 2004.

### **Për Ministrinë për Komunitete dhe Kthim**

T'i udhëzojë komunat në hartimin dhe implementimin e strategjive efektive komunale të kthimit dhe në inkorporimin e tyre në planet zhvillimore të komunës.

Të bëjë vlerësimin e mundësive përmbrrojtjen e pronave të rindërtuara që janë të zbrazëta, duke përfshirë administrimin nga organet gjegjëse.

Të finalizojë krijimin e një baze të dhënave për personat e zhvendosur dhe të përgatisë raporte të rregullta statistikore mbi zhvendosjet.

### **Për Agjencinë Kosovare të Kadastrit**

Të themelojë, përmes një Memorandumi të Mirëkuptimit me Agjencinë Kosovare të Pronës, një mekanizëm efikas për të regjistruar titullarët e pronave kurdo që është e nevojshme pas vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore

### **Për Agjencinë Kosovare të Pronës**

Të shtojë përkjakjet e kontaktimit dhe afirmit për të sqaruar mjetet e ofruara nga AKP-ja për pronarët e zhvendosur të pronave në bashkëpunim me të gjithë palët relevante të interesit.

Të sigurojë që zbatimi i skemës së qiradhënisë të zgjerohet në mënyrë efikase ndaj të gjitha pronave nën administrimin e saj.

Të sigurojë, në bashkëpunim me UNHCR-në dhe OSBE-në, që zyrtarët komunal të kthimit të janë plotësisht të informuar për procesin e AKP-së, me qëllim që të mbështhesin kthimin dhe riintegrin.

### **Për komunat**

Të sigurojnë që personat e zhvendosur të njoftohen në mënyrë adekuate për çdo veprim administrativ që prek të drejtat e tyre mbi pronën dhe t'u sigurojë mjete efikase juridike kundër këtyre veprimeve;

Të sigurojnë zhvillimin e strategjive komunale efektive të kthimit, të cilat marrin në konsideratë nevojat e personave të zhvendosur brenda komunës si dhe riatdhesimet e mundshme me forcë dhe t'i integrojë ato në planet zhvillimore të komunës.

T'i vlerësojnë nevojat për tokë dhe banim të personave të zhvendosur brenda komunës dhe t'i inkorporojë ato në strategjitet komunale për banim.

Të lehtësojnë, në bashkëpunim me UNMIK-un ose organin pasardhës, qasjen në tokë kur është e nevojshme për zbatimin e projekteve të kthimit dhe riintegrimit.

Të koordinohen, përmes zyrtarëve komunal për kthim, me AKP-në në nivel lokal, për të siguruar që personat e zhvendosur dhe të kthyerit të janë në dijeni për mjetet ligjore të ofruara nga agjencia.

### **Për Shërbimin Policor të Kosovës**

Në bashkëpunim me UNHCR-në, AKP-në dhe autoritetet komunale, t'i forcojë mekanizmat ekzistues për të siguruar që pronat e zbrazëta të rindërtuara, pronat banesore që i nënshtrohen dëbimeve të ligjshme dhe pronat tjera të patundshme që u përkasin grupeve të cenueshme, të janë të mbrojtura në mënyrë të duhur nga dëmtimet dhe uzurpimet e paligjshme.

### **Për Institutin Gjyqësor të Kosovës**

Të sigurojë trajnim të rregullt për gjykatat lidhur me aspekte të ndryshme rreth mandatit të Agjencisë e kosovare

të Pronës për kërkesat pronësore si rezultat i konfliktit, përfshirë këtu implikimet nga vendimet e plotëfuqishme të Komisionit për Kërkesa të DÇPB-së.

### **Për Ministrinë e Serbisë për Kosovën**

Të marrë pjesë në strukturën e kthimit për të siguruar që të gjitha projektet e finacuara nga Qendra Koordinuese për Kosovë (QKK) të veprojë sipas udhërrëfyesve dhe parimeve të pasqyruara në Doracakun e rishikuar për Kthim të Qendrueshëm.

### **Për UNHCR-në**

T'i integrojë çështjet e mbrojtjes të së drejtës pronësore dhe banesore, siç janë procedurat transparente dhe mosdiskriminuese të përzgjedhjes së përfituesve dhe të verifikimit të së drejtës pronësore, në programin e ngritjes së kapaciteteve për kthim.

Të sigurojë qasje për autoritetet komunale në statistikat mbi zhvendosjen dhe kthimin.

### **Për Departamentin e Drejtësisë të UNMIK-ut**

Të hartojë një propozim së bashku me palët e tjera të interesit, me qëllim të vendosjes së shpejtë në rastet pronësore, të parashtruara nga serbë të Kosovës kundër KFOR-it, UNMIK-it, komunave dhe individëve, që janë pezulluar në vitin 2004 (dhe raste të ndërlidhura), përfshirë ndihmën për gjykata dhe gjykatësit, si dhe mënjanimit të pengesave ligjore.

T'i rishikojë dhe t'i racionalizojë procedurat për parandalimin e transfereve mashtruese, siç është verifikimi i deklaratave të autorizimit të lëshuara në Serbi.

### **Për Zyrën për Komunitete, Kthim dhe Pakica të UNMIK-ut**

Në bashkëpunim me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, t'i drejojë GPK-të mbi procedurat për ndarjen e tokave dhe banesave për personat e zhvendosur që kthehen dhe mbi projektet për riintegrin.

### **Për Zyrën e Këshilltarit Ligor të UNMIK-ut**

Të përshtypojë zhvillimin e legjislacionit të nevojshëm për zbatimin e plotë të mandatit të Agjencisë Kosovare të Pronës, përfshirë legjislacionin në pritje që rregullon kompensimin për zbatimin e kërkesave pronësore banesore.

### **Për Ekipin Planifikues të Bashkimit Evropian**

Të marrë parasysh nevojën për një strategji të koordinuar mbi rikthimin e pronës banesore dhe të pronës, si dhe kthimin dhe riintegrin në planet e BE-së për Misionin në Kosovë.

### **Për donatorët ndërkombëtarë**

T'i vlerësojnë mundësitet për financim të rindërtimit të pronave të shkatërruara të minoriteteve, në pritje për t'u rindërtuar, si dhe mundësitet për integrim lidhur me zbatimin e mandatit të AKP-së (që do të thotë, administrimin e tokave).

## **1. Hyrje: Të drejtat e personave të zhvendosur dhe refugjatëve përkthim dhe përrikthim të pronës banesore dhe pronës.**

Të drejtat e personave të zhvendosur dhe refugjatëve<sup>29</sup> përtu kthyer në shtëpi si dhe përrikthim të pronës banesore dhe pronës<sup>30</sup> janë standarde të të drejtave të njeriut të pranuara ndërkombëtarisht, të përfshira në Konventën Evropiane përtë Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut (KEDN) dhe të promovuara nga KB-të në të gjitha mjediset pas konfliktit<sup>31</sup>. Kohës së fundit, këto të drejta janë artikuluar në “parimet mbi rikthimin e pronave banesore dhe pronave përrrefugjatët dhe personat e zhvendosur”, të njohura gjithashtu si “Parimet e Pinheiros”, të miratuara në gusht 2005.<sup>32</sup> Ky vlerësim përqendrohet kryesisht në parimin e dytë, apo “të drejtën përrikthim të pronës banesore dhe pronës” dhe parimin e dhjetë, apo “të drejtën përkthim vullnetar të sigurt dhe dinjitoz”.

Parimi i rikthimit të pronës banesore dhe pronës parashev që refugjatët dhe personat e zhvendosur “kanë të drejtë që t'u kthehet çfarëdo banese, toke dhe/ose prone, nga e cila janë privuar në mënyrë arbitrale apo të paligjshme, ose të marrin kompensim përfshirë dobrobanimet, toke dhe/ose prone që është faktikisht e pamundur të rikthehet, ashtu siç vendoset nga ndonjë gjykatë e pavarur dhe e paanshme”. Parimi i dhjetë, apo “e drejta përkthim vullnetar të sigurtë dhe dinjitoz”, thekson që “të gjithë refugjatët dhe personat e zhvendosur kanë të drejtë të kthehen vullnetarisht në shtëpitë e tyre të mëparshme, tokat ose vendbanimet, të sigurt dhe me dinjitet (...). Është e rëndësishme të theksohet se “Parimet e Pinheiros” përbajnjë një elaborim shumë më të gjërë të të drejtave përrikthim të pronës banesore dhe pronës përrrefugjatët dhe personat e zhvendosur, të cilat përfshijnë politika ligjore përmekanizma procedurale dhe institucionale të zbatimit, si dhe çështje të lidhura me të drejtat e shfrytëzuesve të dytë (kundër dëbimeve arbitrale dhe ligjore me forcë). Në tërësi, “Parimet e Pinheros” mund të përmblidhen në të drejta për:

- Rikthim të pronës banesore dhe pronës;
- Mbrojje nga zhvendosja;
- Gëzim i lirshëm i pasurisë;
- Banim të përshtatshëm;
- Respektim të vendbanimit dhe jetës private;
- Liri të lëvizjes; dhe
- Kthim vullnetar të sigurt dhe dinjitoz.

Është e rëndësishme të theksohet se mbrojtja e të drejtës së personave të zhvendosur përtu kthyer dhe përrikthim të pronës banesore dhe pronës ka karakter të dyfishtë: ajo nënkuption, si nevojën përmes masa që promovojnë kthimin ashtu dhe nevojën përtë pasur mjete juridike efektive kundër shkeljeve të të drejtave të njeriut.<sup>33</sup> Rrjedhimisht, masat përmes promovimin e të drejtës përkthim nënkuptionjë se duhet pasur:

<sup>29</sup> T

apo të

Shih, Shënimet Sqaruese mbi Parimet e Rikthimit të Pronës Banesore dhe Pronës përrrefugjatët dhe Personat e Zhvendosur. E/CN.4/Sub.2/2005/17/Add.1, 8 korrik 2005, paragrafi 2 dhe 3.

<sup>30</sup> Gjatë gj

personat të cilët pësojnë humbje apo lëndime kthehen, përtë aq sa është e mundur, në pozitën e tyre para humbjes apo para lëndimit. Shih, shënimin më lartë.

<sup>31</sup> Shih, nen

në pronë) dhe nen 2, Protokoli 4 (Liria e Lëvizjes) e KEDN-së.

Shih, Rezolutat e Këshillit të Sigurimit 1287 (2000), 1036 (1996), 971 (1995) dhe 876 (1993) përrikthim të pronës, në vendet si Kosova dhe Guatema, “Parimet e Pinheiros” morën përkrahjen formale nga Nënkomisioneri i KB-ve përmes Promovimin dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (DUDN); Neni 12 (4) i Paktit Ndërkombëtar përtë Drejtat Civile dhe Politike (PNDCP); Nenet 45, 127, 132 dhe 135 të Konventës së Gjenevës mbi Mbrojtjen e Personave Civilë në Kohë Luftë; dhe nen 12 (2) i Kartës Afrikane mbi të Drejtat e Njeriut dhe të Njerëzve.

<sup>32</sup> Pas një diskutimi shumëvjeçar dhe të dhënave të siguruara nga ekspertë të përfshirë në programet e rikthimit të pronës, në vendet si Kosova dhe Guatema, “Parimet e Pinheiros” morën përkrahjen formale nga Nënkomisioneri i KB-ve përmes Promovimin dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, më 11 gusht 2005. Shih, Parimet mbi Rikthimin e Pronës Banesore dhe Pronës përrrefugjatët dhe Personat e Zhvendosur, E/CN.4/Sub.2/2005/17.

<sup>33</sup> Williams C. Rhodri, ‘Rikthimi i pronës dhe kthimi i Refugjatëve në Bosnje dhe Hercegovinë pas konfliktit: Implikimet në Çaktimin e Standardeve dhe Praktikën’, Gazeta e Universitetit të Nju-Jorkut përtë Drejtën Ndërkombëtare dhe Politikën, Vëllimi 37, Numër 3, Pranverë 2005, faqe 451.

- a) struktura efektive, transparente dhe përgjegjëse, për ndarjen e ndihmave për rindërtim, tokë dhe banim dhe zbatim të projekteve gjithëpërfshirëse dhe të balancuara të kthimeve: dhe
- b) duhet krijuar mjete efektive juridike kundër uzurpimit të paligjshëm të pronës banesore, tokës ose pronave tjera; kundër ngacmimit, kërcënimeve dhe largimeve me forcë, si dhe nga shtrëngimi dhe/ose mashtrimi në kryerjen e transfereve të pronës së patundshme.

Parimet themelore, që udhëheqin procesin e kthimit, mund të përmblidhen në nevojën që të ketë kthim vullnetar, të sigurt dhe të qëndrueshëm.<sup>34</sup> Kthimi duhet të bëhet në rrithana dinjitoze dhe duhet të bazohet në zgjedhje dhe informim të lirë të personit të zhvendosur. Në këtë drejtim, mekanizmat përmbrojtjen e të drejtës përmrithim të pronës banesore dhe të pronës duhet të janë të arritshme, efikase dhe të respektojnë standarde ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Për më tepër, autoritetet shtetërore obligohen të sigurojnë që personat e zhvendosur të gëzojnë kushte adekuate të banimit dhe të janë të mbrojtur nga dëbimet me forcë.<sup>35</sup>

Këto standarde gjithashu pasqyrohen në Parimet Udhëzuese të KB-ve mbi Zhvendosjet e Brendshme,<sup>36</sup> të cilat pasqyrojnë një përpjekje të mëhershme të Këshillit përmrithim të Drejtat e Njeriut të KB-ve përmrithim të shtuar mbrojtjen e personave të zhvendosur brenda vendit. “Parimet Udhëheqëse” theksojnë obligimet e shtetit ndaj personave të zhvendosur brenda vendit. Veç kësaj, duke e pasur parasysh cenueshmérinë e tyre përmrithim të qenë të dëbuar me forcë nga autoritetet lokale përmrithim të arsyë të situatës së tyre të zhvendosjes, parimi 21 parashev që “pronat do të mbrohen në të gjitha rrithanat; prona dhe pasuria e lënë pas nga personat e zhvendosur brenda vendit do të jetë e mbrojtur nga shkatërrimi dhe përvetësimi, uzurpimi apo shfrytëzimi arbitrar dhe i paligjshëm”.

Në Kosovë, burimi kryesor i të drejtave të personave të zhvendosur dhe të refugiatëve përmrithim të kthyer dëbimet me forcë, qëndrueshëm, kundër uzurpimit të KB-ve mbi Zhvendosjet e Brendshme, përmrithim të pronës banesore dhe pronës eshtë Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244. Në pajtim me Aneksin VII të Marrëveshjes së Dejtonit, e cila zgjodhi konfliktin në Bosnjë dhe Hercegovinë, kjo rezolutë ripohon të drejtën e të gjithë refugiatëve dhe personave të zhvendosur përmrithim të kthyer dëbimet me forcë, si një nga përgjegjësitë e pranisë ndërkombëtare civile dhe të sigurisë në Kosovë.<sup>37</sup> Për më tepër, Korniza Kushtetuese përmrithim të drejtat e të gjithë refugiatëve dhe personave të zhvendosur nga Kosova “përmrithim të kthyer dëbimet me forcë, si një nga institucionet dhe organet kompetente në Kosovë do t'i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme përmrithim të lehtësuar kthimin e sigurt të refugiatëve dhe personave të zhvendosur në Kosovë dhe se do të bashkëpunojnë plotësisht në të gjitha përpjekjet e UNHCR-së dhe organizatave tjera ndërkombëtare dhe joqeveritare në çështjet që kanë të bëjnë me kthimin e refugiatëve dhe personave të zhvendosur”.<sup>38</sup>

Pavarësisht nga kjo kornizë dhe strategjive e programeve të zhvilluara gjatë tetë viteve të fundit (shih kreun 2), kthimet në Kosovë kanë qenë të pakta përmrithim të komuniteteve pakicë (serbët e Kosovës, romët/ashkalitë/egjiptasit e Kosovës dhe shqiptarët e Kosovës në komunat ku përbëjnë pakicë relative).<sup>39</sup> Prandaj, kthimet mbetën prioritet i lartë politik si përmrithim të UNMIK-un dhe përmrithim të IPVQ-të, ashtu edhe përmrithim të organizatat përmrithim të drejtat e njeriut. Kështu, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, përmrithim të shembull, së fundi i ka përcjellë PSSP-së, nevojën përmrithim të mbrojtur të drejtën në kthim.<sup>40</sup>

Më e rëndësishmja, propozimi i Zyrës së të Dërguarit të Posacëm të Kombeve të Bashkuara përmrithim të UNOSEK-në zgjidhjen përmrithim të statusin e Kosovës, ripohon nevojën përmrithim të promovuar të drejtën në kthim. Neni 4 i propozimit përcakton që “të gjithë refugiatët dhe personat e zhvendosur nga Kosova do të kenë të drejtën e kthimit

<sup>34</sup> Shih, punimi konceptual i UNMIK-ut mbi “të drejtën përmrithim të qëndrueshëm”, i 27 majit 2002.

<sup>35</sup> Këshilli i KB-ve mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (KDESC), në Komentin e tij të Përgjithshëm 7 (E drejta përmrithim të vendbanim të adekuat: Dëbimet me forcë, përkufizon ‘dëbimin me forcë’ si ‘largin i përhershëm ose përkohshëm i individëve, familjeve dhe/ose komuniteteve kundër vullnetit të tyre nga shtëpitë e tyre dëbimet me forcë’). Këshilli theksion se dëbimet ‘nuk duhet të kenë përmrithim të rezultat lënien e individëve pa strehim apo t'i cenesë qasje në këto forma’. Këshilli theksion se dëbimet ‘nuk duhet të kenë përmrithim të rezultat lënien e individëve pa strehim apo t'i cenesë qasje në këto forma’. Këshilli theksion se dëbimet ‘nuk duhet të kenë përmrithim të rezultat lënien e individëve pa strehim apo t'i cenesë qasje në këto forma’. Këshilli theksion se dëbimet ‘nuk duhet të kenë përmrithim të rezultat lënien e individëve pa strehim apo t'i cenesë qasje në këto forma’. Këshilli theksion se dëbimet ‘nuk duhet të kenë përmrithim të rezultat lënien e individëve pa strehim apo t'i cenesë qasje në këto forma’.

<sup>36</sup> Parimet Udhëzuese mbi Zhvendosjen e Brendshme, UN Doc. E/CN.4/1998/53/Add.2

<sup>37</sup> Rezoluta e KS të KB-ve 1244 (1999), Preambula, nen 9 c, 11 k, 13 dhe Anekset.

<sup>38</sup> Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9, 15 maj 2001, preambula dhe nen 3.4.

<sup>39</sup> 16,117 persona që nga dhjetori i vitit 2006, sipas UNHCR-së. Kjo shifër nuk merr parasysh largimet.

<sup>40</sup> Shih Rezolutën e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës 1533 (2007) dhe Rekomandimin 1780 (2007) mbi situatën aktuale në Kosovë.

dhe kërkimit të pronës së tyre dhe posedimeve personale, në pajtim me ligjet vendore dhe ndërkombëtare". Veç kësaj, nga Kosova pritet që t'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të mundësuar dhe krijuar një atmosferë të favorshme për kthim të sigurt dhe të denjë të refugjatëve dhe personave të zhvendosur, bazuar në vendimet e tyre të lira dhe të informuara". Kushtet e propozimit do të mbikëqyren nga një Përfaqësues Civil Ndërkombëtar i cili njëkohwsisht do të jetë edhe Përfaqësues Special i Bashkimit Evropian.

Propozimi i jep UNHCR-së rol udhëheqës në ofrimin e ndihmës për autoritetet kompetente në shtrirjen e mbrojtjes dhe ofrimin e ndihmës për të kthyerit, si dhe në raportimin publik mbi këto çështje.<sup>41</sup> Përkitazi me këtë, UNHCR-ja së fundi ka nënshkruar një Memorandum të mirëkuptimit me Qeverinë e Kosovës për implementimin e një programi të ngritjes së kapaciteteve dhe të monitorimit për kthimet dhe riintengrimin, përfshirë krijimin e një kapaciteti të brendshëm të mbrojtjes në nivelin komunal.

## 2. Strukturat dhe procedurat e procesit të kthimit

Procesi i kthimeve është i organizuar përmes një strukture të shumë faktorëve të interesuar, e cila është e ndarë nga mekanizmi i themeluar për të siguruar rikthim të pronës banesore dhe pronës, AKP-ja. Struktura e procesit të kthimit synon të sigurojë struktura efektive, transparente dhe të përgjegjishme për ndarjen e ndihmës në rindërtim, tokës dhe hapësirës banesore dhe implementim të projekteve gjithëpërfshirëse dhe të balancuara të kthimit për personat e zhvendosur, refugjatët dhe komunitetet e tyre pranuese (shih fig. 1). Kjo përfshin një numër të konsiderueshëm të akterëve me role dhe përgjegjësi të ndryshme. UNMIK-u dhe IPVQ-të, bashkërisht kanë përkufizuar rolet dhe përgjegjësitë e secilit akter në "Doracakun e rishikuar për kthim të qëndrueshëm", të botuar në vitin 2006. Në këtë mënyrë, Doracaku ofron një kornizë të politikave dhe strukturës për koordinim ndërinstitucional në projektet për zhvillim, financim dhe implementim të kthimeve dhe të riintegrimit.

Akterët të cilët janë të përfshirë drejtpërdrejtë në procesin e kthimit radhiten nga përfaqësues të Ministrisë për Komunitete e IPVQ-ve dhe Zyrës së UNMIK-ut për Komunitete, Kthim dhe Pakica në komuna, të organizatave të shoqërisë civile dhe Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), Komisariatit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR) – me një rol në rritje e sipër të ngritjes së kapaciteteve për çështjet e kthimit, UNMIK-ut dhe të OSBE-së. Po ashtu, organet qeveritare të Republikës së Serbisë vazhdojnë të marrin pjesë në këtë proces, duke përfshirë Komisariatin serb për refugjatë (Komisariati)<sup>42</sup> dhe Qendrën Koordinuese për Kosovës (QKK).<sup>43</sup>

Komponentët më fundamental të strukturës së kthimit janë:

- Grupi punues komunal për kthim (GPK), forumi lokal i koordinimit dhe implementimit të të gjitha aktiviteteve të ndërlidhura, i kryesuar nga kryetari i kuvendit komunal;
- Mekanizimi qendor për rishikim, i kryesuar nga Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK) dhe që është përgjegjës për rishikimin e projekteve të propozuara të kthimit;
- Grupi drejtues, një organ që merret me udhëzimet e politikave i bashkë-kryesuar nga PSSP-ja dhe Kryeministri; dhe
- Grupi për kontaktim dhe komunikim me komunitete (GKKK), i kryesuar nga Ministria për Komunitete dhe Kthim, që është përgjegjës për të siguruar kontakte me personat e zhvendosur dhe me opinionin publik.<sup>44</sup>

Karakteristikat kryesore të strukturës së transformuar të kthimeve pasqyrojnë pronësinë e rritur të komunave dhe qeverisë qendrore në marrjen përsipër të udhëheqjes së çështjeve që lidhen me kthimet si dhe rolin e fuqizuar

<sup>41</sup> Propozimi gjithëpërfshirës i UNOSEC-ut për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës. Neni 4. Të drejtat e refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vendit.

<sup>42</sup> Komisariati për Refugjatë është organ shtetëror administrativ që kryen detyra që kanë të bëjnë me identifikimin e statusit të refugjatëve, kujdesin për refugjatët, mbajtjen e të dhënave, koordinimin e ndihmës humanitare të ofruar nga agjenci dhe organizata të tjera si dhe monitorimin e ofrimit të asaj ndihme në mënyrë të barabartë dhe me kohë. Komisariati punon për të ofruar ushtrë të favorshme për kthime. Për më shumë informata mbi Komisariatin, viziton: [www.kirs.sr.gov.yu](http://www.kirs.sr.gov.yu).

<sup>43</sup> Qëllimi kryesor i Programit për Kthim është krijimi i ushtrëve që do të inkurajon zhvillimin e përhershëm të marrëdhënieve ndëretnike që do të parandalonin largimin e serbëve nga Kosova. Në Kosovë, Komisariati kryen detyrat lidhur me personat e zhvendosur si vijon: regjistrimin e personave të zhvendosur dhe lëshimin e letërnjoftimeve për të zhvendosurit; akomodimin dhe përkrahjen e personave të zhvendosur në qendrat kolektive në Serbi si dhe 17 qendrat kolektive në Kosovë; dhe sigurimin e përkrahjes individuale humanitare për personat e zhvendosur si shoqatat e tyre. Për më shumë informata mbi QKK-në, viziton: [www.kc.gov.yu](http://www.kc.gov.yu).

<sup>44</sup> Shih Doracakun e rishikuar për kthim të qëndrueshëm, Udhëzimet Operative, faqe 13.

të organizatave të shoqërisë civile. Ato gjithashtu pasqyrojnë rëndësinë e pjesëmarrjes së QKK-së në proces.<sup>45</sup> Korniza operative e kthimeve gjithashtu synon të jetë më fleksibile në mënyrë që të sigurojë udhëzime dhe për t'u përgjigjur çdo skenari.

GPK-të vazhdojnë të jenë “promotor” të procesit të kthimeve dhe forumi më i rëndësishëm për koordinimin dhe implementimin në nivelin lokal të të gjitha çështjeve, projekteve dhe aktiviteteve që kanë të bëjnë me kthimet. Kryesia e GPK-së është bartur nga përfaqësuesi komunal i UNMIK-ut te kryetari i kuvendit komunal. Pjesëmarrës në GPK janë autoritetet komunale lokale, OJQ-të, Shërbimi Policor i Kosovës, përfaqësuesit e personave të zhvendosur, UNMIK-u, UNHCR-ja dhe OSBE-ja. Veç kësaj, Doracaku i ri përmban “Protokollin për kthim vullnetar dhe të qëndrueshëm” të nënshkruar nga UNMIK-u, IPVQ-të dhe Qeveria e Serbisë. Ky protokoll themelon një mekanizëm për sigurimin e ndihmës në rindërtim për të kthyerit vullnetarë në nivel komunal brenda 60 ditëve, nga data kur personat e zhvendosur deklarojnë synimin e tyre për t'u kthyer. Megjithatë, ky mekanizëm akoma nuk është implementuar.

Vendosja e theksit të strukturave të procesit të kthimit në koordinimin ndër-institucional është rezultat i mësimeve të nxjerra që kanë treguar se nuk ka qëndrueshmëri të projekteve. Për shembull, projekt i kthimit për serbët e Kosovës në Osojanë/Osojan<sup>46</sup> ishte i pari i tillë që është implementuar në Kosovë në vitin 2001. Megjithatë, vazhdon të mos ketë fare bashkëveprim në mes të të kthyerve dhe komuniteteve fqinje, për shkak të dështimit të implementimit të një projekti të koordinuar e të përkrahur nga të gjithë akterët.<sup>47</sup> “Doracaku i parë mbi kthimet e qëndrueshme”, i nxjerrë në vitin 2002, pasqyron këtë mësim dhe e vë një theks të fuqishëm në qëndrueshmërinë. Procesi i kthimit në fshatin Videjë/Vidanje (Komuna e Klinës/Klina), paraqet një shembull të mirë të koordinimit konstruktiv ndërmjet QKK-së dhe akterëve të tjera në implementimin e një projekti të kthimit me rezultate të kundërtat.

OSBE-ja, në vlerësimin e saj mbi funksionimin e strukturës së kthimeve, ka identifikuar fusha të ndryshme që kanë nevojë për vëmendje të mëtutjeshme:


- a) mungesa e financimit;
- b) nevoja për verifikim të të drejtave pronësore;
- c) nevoja për udhëzime procedurale mbi ndarjen e hapësirave të banimit dhe të tokës;
- d) integrimi i Strategjive komunale të kthimit në Planet komunale zhvillimore;
- e) pjesëmarrja e personave të zhvendosur; dhe
- f) masat për përmirësimin e qasjes në hapësirat banesore të personave të zhvendosur ku ata jetojnë.

<sup>45</sup> Doracaku i rishikuar për kthim të qëndrueshëm i UNMIK-ut dhe IPVQ-ve, korrik 2006.

<sup>46</sup> Në vitin 2004, të kthyerit serbë të Kosovës në Osojan/Osojane pranuan shtëpi të parafabikuara me ndihmën e QKK-së. QKK-ja ka dhuruar fonde për ndërtimin e 64 shtëpive të parafabikuara në në luginën e Osojanit/Osojane, siç ishte pajtuar me UNMIK-un.

<sup>47</sup> Për një analizë mbi elementet e qëndrueshmërisë së kthimeve në Kosovë, shih raportin e Grupit Ndërkombëtar të Krizave ‘Kthimi në pasiguri’, të 13 dhjetorit të vitit 2002, në dispozicion në faqen e internetit <http://www.crisisweb.org>.

**Fig. 1. Struktura e procesit të kthimit dhe riintegrimit.**



### a) Financimi i projekteve për kthim dhe riintegrin

Vlerësimet e kostos së projekteve të kthimit në Kosovë janë ndër më të lartat në botë. Në të njejtën kohë, cilësia e planifikimit dhe zbatimit të projekteve duhet të përmirësohet për t'iu përgjigjur nevojave të vërteta si dhe për të pasur projekte që janë efektive për koston e tyre. Si shembull, në vitin 2006, MKK-ja shpenzoi fonde të konsiderueshme në projektet e kthimit, të cilat nuk kanë rezultuar me ndonjë kthim fizik. Kështu, mungesa e 13 milionë eurove preku 15 nga 17 projektet e miratuar nga Mekanizmi qendror i shqyrtimit në vitin 2006. Të gjitha këto janë duke u vlerësuar sërisht për të ulur kostot.<sup>48</sup>

Për të trajtuar mbikëqyrjen e shpenzimeve të MKK-së, UNMIK-u, në vitin 2006, themeloi një Komision për autorizimin e buxhetit të mbikëqyrur ndërkombëtarisht. Për më tepër, me iniciativë të MKK-së, në janar të vitit 2007, u miratua një "Kornizë e politikave të zhvillimit dhe stabilizimit të komuniteteve", për të siguruar një kornizë funksionale për komunat në qasjen ndaj fondeve për kthim dhe riintegrin.

### b) Verifikimi i të drejtave pronësore

Procesi i verifikimit të të drejtave pronësore mbi pronat e shkatërruara është i nevojshëm për të shmangur ndërhyrjet në këto të drejta. Derisa Doracaku i rishikuar për kthim të qëndrueshëm nuk përmban një tërësi të procedurave të verifikimit të të drejtave pronësore, Marrëveshja trepalëshe (MTP) e bashkëngjitur, vë përgjegjësinë e vërtetimit të të drejtave të tij/saj tek agjencja implementuese, Organizatë joqeveritare (OJQ).<sup>49</sup> MTP gjithashtu siguron pëlgjinin e titullarit të së drejtës pronësore për kryerjen e punëve ndërtimore, gjë që është kërkesë ligjore për të ndërmarrë një punë të tillë. Doracaku i rishikuar nuk ofron udhëzime tjera për GPK-të për verifikimin e të drejtave pronësore. Kështu, komunat janë duke zbatuar këto procedura në mënyrë ad hoc. Disa autoritete komunale po kujdesen vetë për verifikimin e të drejtave pronësore, në mënyrë të pavavarur nga procesi i GPK-ve, si dhe po zbatojnë procedura të paqarta në vijim (siç janë, Drejtori i Gjeodezisë dhe Kadastrës i Podujevës/Podujevo dhe ai i Obiliqit/Obilić, apo Zyrtari Komunal i Komuniteteve dhe/ose Zyrtari Komunal i Kthimit në Prishtinë/Priština). Në raste tjera, verifikimi i pronave bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga agjencitë implementuese.<sup>50</sup> Në Pejë/Peć, për shembull, verifikimi i të drejtave pronësore kryesisht zbaton udhëzimet nga neni 2.3.3 i Udhëzimeve të UNMIK-ut mbi banimin dhe rindërtimin, të vitit 2002, si dhe Doracakun e rindërtimit të banimit, të vitit 2004, (për rastet në lidhje me trazirat e marsit 2004).<sup>51</sup>

OSBE-ja ka monitoruar një rast në të cilin nuk është bërë verifikimi i të drejtës pronësore dhe nuk janë nënshkruar MTP-të para ndërtimit. Ky është rasti i projektit të kthimit në fshatin Zogishtë/Zočiste (Rahovec/Orahovac). Në maj të vitit 2005, GPK-ja u informua se MKK-ja kishte shpallur tenderin për rindërtimin e 44 shtëpive në Zogishtë/Zočiste.

Ky veprim nga MKK-ja nuk mori parasysh fare punën e kryer nga GPK-ja në vitet e kaluara, e as përpjekjet për verifikimin e të drejtave pronësore.<sup>52</sup>

### c) Përzgjedhja e përfituesve

Procesi transparent dhe të përgjegjshëm të përzgjedhjes së përfituesve është i nevojshëm për të siguruar që e drejta e kthimit të të zhvendosur të mbrohet në mënyrë të barabartë. Modelet e përshtatshme për verifikimin e të drejtave pronësore dhe përzgjedhjes së përfituesve janë përcaktuar me udhëzimet e UNMIK-ut për Banim dhe rindërtim të vitit 2002.<sup>53</sup> Këto kritere, më parë të përdorura nga Këshillat komunale dhe rindërtim të objekteve të

<sup>48</sup> Zyra e UNMIK-ut për Komunitetet, Kthim dhe Çështje të Pakicave, Raporti i Aktiviteteve në fund të vitit, 2006.

<sup>49</sup> Shih nenin 5, Marrëveshja trepalëshe.

<sup>50</sup> OJQ-të janë të përfshira edhe në përkrahjen me ndihmë juridike, si në Prishtinë/Priština ku ato ofrojnë mbështetje në rast të kontesteve gjyqësore ose procedurave të DÇPB/KACP-së.

<sup>51</sup> Në Komunën e Pejës/Peć, sipas shifrave të AER-it, 8,147 shtëpi ishin dëmtuar, ndërsa 5,080 ishin rindërtuar deri në fund të vitit 2005, me pronarë nga pakicat dhe shumica.

<sup>52</sup> Në dhjetor të vitit 2004, Arbeiter-Samariter-Bund (ASB) i paraqiti GPKK-së një projekt kthimi i cili parashikonte rindërtimin e 40 shtëpive për serbët e zhvendosur të Kosovës të fshatit Zogishtë/Zočiste. Projekti ishte rezultat i dy viteve të vizitave 'Shko e Vizito', 'Shko e Intervisto', bashkë me takimet mes personave të zhvendosur dhe komunitetit pranues. Autoritetet lokale, duke përfshire anëtarët e GPKK-së, si dhe përfaqësuesin lokal të komunitetit serb të Kosovës, mbështesnin shumë procesin. Projekti i ASB-së ishte kryesisht i dizajnuar të siguronte qëndrueshmërinë afatgjate të kthimit, duke përfshirë sigurimin e shërbimeve sociale, arsimore dhe dialogun ndëretnik, qëllime të cilat shkonin përftej rindërtimit të thjeshtë fizik të shtëpive.

<sup>53</sup> Neni 3.3 i Udhëzimeve të UNMIK-ut për rindërtimin e Banimit, 2002, vë në përparrësi "familjet e cenueshme të gjitha prejardhjeve etnike, me të drejta të qarta të pronësisë apo posedimit të shtëpive të dëmtuara apo shkatërruara nga veprat para, gjatë ose pas luftës më 1998-99 për ndihmë. Më tej, propozohet që KKB të mos përfshirë në listën e prioriteteve të tyre familjet që nuk kanë qëllimin e jetesës së përhershme në fshat, e as ato që kanë braktisur fshatin vullnetarisht para konfliktit".

banimit (KKB), janë përdorur që nga viti 2003 nga disa GPK, por jo në vazhdimësi. Disa komuna, si ajo e Pejës/Peć, vazhdojnë të përdorin KKB-të për ofrimin e ndihmës në rindërtimin e hapësirave të banimit për projektet e rindërtimit për komunitetin shumicë.

Doracaku i rishikuar për kthim të qëndrueshëm përmban një tërësi rekmandimesh në lidhje me kriteret e përgjedhjes së përfituesve.<sup>54</sup> Këto rekandime tanë mundësojnë ndihmë në rindërtimin e pronave banesore të shkatërruara para vitit 1999. Sipas Doracakut të rishikuar për kthim të qëndrueshëm, ndihma për ndërtimin e banesave nuk duhet të jepet nëse ndonjë anëtarë i familjes posedon pronë banesore në Kosovë, në të cilën anëtarët tjerë të familjes mund të kenë qasje të lirë.

Në praktikë, përgjedhja e përfituesve bëhet në mënyrë ad hoc dhe jo gjithmonë zbatohen parimet e transparencës dhe mos-diskriminimit. Në këtë kuptim, OSBE-ja ka vëzhguar raste në të cilat përgjedhja e përfituesve ndërmerrët nga Zyrtari Komunal i kthimit në mënyrë ad hoc dhe pastaj ai diskuton me udhëheqësit e fshatrave të cilët pastaj vendosin cili nga të kthyerit e mundshëm kualifikohet, gjoja se bazohet nëse fshatarët mendojnë se ai person ka kryer krimë gjatë konfliktit.<sup>55</sup>

Për shembull, në komunën e Klinës/Klina, një person i zhvendosur u ankua te PSSP-ja për refuzimin e kërkësës së tij për kthim nga ana e Zyrtarit Komunal të kthimit, për faktin që fshatarët e Shtupelit/Stupej e kishin ndërlidhur atë dëshmorët e anëtarët të tjerë të familjes së tij me krimet e kryera në zonë gjatë konfliktit. Megjithatë, kjo nuk është praktikë e pranueshme, sepse çon në arbitraritet dhe diskriminim të mundshëm. Për më tepër, cenon vetëdijen e banorëve për sundimin e ligjit si dhe autoritetin gjyqësor për përcaktimin e përgjegjësisë për krimë.

Në raste tjera, OSBE-ja ka vëzhguar ndikimet e drejtëpërdrejta të donatorëve në ndërtimin e listave të përfituesve. Për shembull, në Prizren, QKK-ja i siguroi listën e përfituesve të mundshëm OJQ-së ASB për projektin e rindërtimit të 60 shtëpive në luginën e Župa/Zhupës.<sup>56</sup>

Përgjithësisht, ka nevojë për udhëzim për GPK-në në procedurat e përgjedhjes së përfituesve, për të shmangur arbitraritetin në procesin e përgjedhjes si dhe për të mbrojtur të drejtën e kthimit pa diskriminim.

#### d) Ndarja e hapësirës së banimit dhe e tokës

Derisa kthimi në vendin e origjinës është gjithmonë qëllimi primar i projekteve të kthimit, Doracaku i ri parashikon mundësinë e integrimit lokal (në zonën ku jeton personi i zhvendosur) dhe/ose rivendosjen (në lokacion tjetër, të ndryshëm nga vendi i zhvendosjes dhe shtëpisë së mëparshme) nëse pengesat ndaj kthimit në vendin e origjinës nuk mund të tejkalohen.<sup>57</sup> Doracaku thekson që “të gjitha përpjekjet (...) duhen bërë për heqjen e pengesave ekzistuese në lidhje me kthimin në vendet e origjinës (...).” Megjithatë, “nëse pengesat e tilla (...) nuk mund të hiqen përmes përpjekjeve të mundshme dhe të arsyeshme”, personat e zhvendosur “do të kenë mundësinë të vendosen apo integrohen lokalisht në vende tjera alternative sipas zgjedhjes së lirë”.<sup>58</sup>

Megjithatë, Doracaku nuk përbën procedura konkrete që duhen respektuar në rastet e ndarjes së tokës apo dhënes së ndihmës në rindërtim apo sigurim të njësive banesore në vende tjera përveç vendit të origjinës. Për shembull, më 27 shkurt të vitit 2007, Bordi i Drejtoreve të Rahovecit/Orahovac diskutoi kërkësën e një personi të zhvendosur nga fshati i Bratatinit/Bratutin që kërkonte nga Komuna t'i ndante familjes së tij një parcelë toke në fshatin Velika Hoča/Hoçë e Madhe. Për shkak të mungesës së procedurave në këto raste, Bordi i Drejtoreve i kërkoi Drejtoretat të kadastrës dhe Zyrës së Avokatit Publik që të kërkojë mundësitet.

Më tej, në disa raste, implementimi i procedurave ad hoc ka rezultuar në ndërhyrje në të drejtat pronësore të personave të zhvendosur. Në Rahovec/Orahovac, QKK-ja siguroi strehimin e përkohshëm (përmes Zyrës Komunale

<sup>54</sup> Shih Shtojcën I, Doracaku i Rishqyrtuar për kthimin e qëndrueshëm.

<sup>55</sup> Shih letrën e personit të zhvendosur për PSSP-në e UNMIK-ut, 19 maj 2006.

<sup>56</sup> QKK-ja ka kriteret e veta që duhen plotësuar nga individi apo familia për të qenë përfitues i projektit me financim të QKK-së. Në Lipjan/Lipljan, për rastet e kthimit individual, QKK-ja aplikon kriteret e përcaktuara nga Komisariati, të cilat përfshijnë: 1) Personi duhet të jetë i regjistruar nga Komesariati si refugiat/person i zhvendosur; 2) personi duhet të jetë i regjistruar në Kryqin e Kuq; 3) duhet të posedojë një kartelë identifikimi të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Serbisë; dhe 4) kthimi i vërtetë i personit në Kosovë duhet të verifikohet me dy dëshmitarë.

<sup>57</sup> Jo vetëm që Doracaku trajton të drejtën ndaj standardeve të përshtatshme të jetesës dhe mundësinë e vendosjes apo integrimit lokal në vende alternative të zgjedhjes së lirë, por edhe Protokolli për Kthimin vullnetar dhe të qëndrueshëm, nënshkruar në qershor të vitit 2006 mes UNMIK-ut, IPVQ-ve dhe Qeverisë së Serbisë, i cili thekson se kthimi i suksesshëm i personave të zhvendosur bazohet në tri elemente: ofrimin e sigurisë për kthyerit; kthimin e pronave tek personat e zhvendosur dhe rindërtimi i shtëpive të tyre; krijimi i një mjedisi që mbështet kthimin. Për më shumë, ai “njeh të drejtën e personave të zhvendosur që të zgjedhin lirisht vendin e tyre të banimit”. Protokoli gjithashtu hap rrugën për dialog direkt mes komunave (nikoqire dhe pranuese) si dhe ndihmon sigurimin e mbrojtjes së të drejtave të kthyerive.

<sup>58</sup> Doracaku i rishikuar për kthimin e qëndrueshëm, Faqe 8.

të Komunitetit) mes viteve 2001-2005 përfamiljet nga Peja/Peć dhe Prizreni në vendin e zhvendosjes (Rahoveci i epërm/Orahovac dhe Velika Hoca/Hoça e Madhe) përmes autorizimit të shfrytëzimit të shtëpive të pabanuara të serbëve të Kosovës.

Përkundër faktit që disa nga familjet që kanë mbetur në këto shtëpi janë pajtuar t'ua paguajnë qiranë pronarëve, QKK-ja tejkaloj kompetencat e saj dhe ndërhyri në të drejtat pronësore të pronarëve, të cilët panë zënien e pronave të tyre pa pëlqimin e tyre. Rreth 7-10 shtëpi mbeten të zëna qysh prej dhjetorit 2006.

Në Komunën e Prishtinës/Priština, QKK-ja shpesh ka punuar jashtë mekanizmave ekzistues të kthimit. Është me rëndësi të thuhet që shumica e projekteve në të cilat është përfshirë QKK-ja nuk janë projekte të vërteta të kthimit, por më së shumti iniciativa të integrimit lokal apo zgjidhje të përkohshme si reagim ndaj situatave emergjente siç ishte dhuna e marsit të vitit 2004.

Në rastet tjera, siç është projekt Novi Badovac/Badofc (Graçanica/Graçanicë), implementimi i projektit të riintegrimit ka rezultuar me ndërtime në tokën komunale, pa destinim të duhur të tokës, dhe pa leje urbane dhe të ndërtimit. Aty, QKK-ja ka financuar instalimin e 16 shtëpive të para-fabrikuara për vendosjen e të zhvendosurve brenda vendit, kryesisht me prejardhje nga komunat fqinje. Fatkeqësisht, komuna nuk ishte fillimi i përfshirë në proces, përkundër faktit që koncept-dokumenti për pjesën e dyte të këtij projekti parasqeh përfshirjen e plotë të komunës dhe aktorëve të tjerë, siç është theksuar me Doracakun e kthimit të qëndrueshëm. Për momentin, projekt parashikon ndërtimin e 70 shtëpive për personat e zhvendosur dhe rastet sociale në Novi Badovac/Badofc. Koncept-dokumenti ishte pranuar nga GPK-ja dhe miratuar nga MQSh-ja më 25 janar 2007. Megjithatë, ndarja e tokës ende nuk është miratuar ende nga organet komunale.

Në këtë kuptim, një shembull pozitiv i bashkëpunimit mes bartësve përkatës mund të gjendet në "Mekanizmin koordinues të mëhallës rome", të krijuar nga bashkësia ndërkombëtare për të ndihmuar zbatimin e projektit të kthimit të individëve romë, ashkali e egjiptas të zhvendosur në vendbanimin e madh e të shkatëruar joformal, në qendër të qytetit të Mitrovicës/Mitrovica. "Njësia për mbrojtje dhe çështje ligjore", i bashkëkryesuar me Komunën, ka trajtuar zotërimin e pronës gjatë vitit 2006 dhe 2007. Ajo kishte definuar kriteret e përzgjedhjes së përfituesve, si dhe ka ndihmuar në verifikimin e të drejtave pronësore, duke përfshirë hartimin e marrëveshjeve afatgjate të dhënes së pronave shoqërore, më vonë të miratuar edhe nga PSSP-ja.

#### e) Koordinimi me AKP-në

Koordinimi me Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) në strukturat e kthimit, parashihet në Doracakun e rishikuar, përmes pjesëmarrjes së AKP-së në Grupin Drejtues. Në nivel lokal, AKP-ja pritet të merr pjesë në "Ekipet e projektit" si ekspert. AKP-ja nuk është paraparë në mënyrë eksplikite që të merr pjesë në seancat e GPK-ve, dhe zyrtarët e AKP-së jo gjithmonë marrin pjesë në Grupet punuese komunale për kthimin, përkundër ftesave të Zyrtarëve komunalë të kthimit. Ndonëse nuk ka obligim mandator në anën e AKP-së që të merr pjesë, pjesëmarrja e zyrtarëve të tyre sigurisht që mbështet aktivitetet e kontaktimit me personat e zhvendosur, si dhe në kuptimin e ekspertizës në ekipet e projektit. UNHCR-ja koordinohet rregullisht me AKP-në, sidomos në kuptimin e organizimit të vizitatave 'Shko e Shih' (të cilat i mundësojnë të zhvendosurve të sigurojnë informata të dorës së parë mbi kushtet jetësore që mbizotërojnë në vendin e tyre të origjinës).

#### f) Strategjitet komunale për kthim dhe planet zhvillimore komunale

Një aspekt i përgjegjësisë së qeverisë komunale në procesin e kthimit pasqyrohet në përpilimin, adoptimin dhe implementimin e obligueshëm të Strategjive komunale për kthim (SKK)<sup>59</sup>. SKK-ja është mekanizëm i rëndësishëm që u mundëson komunave të marrin përsipër përgjegjësinë për kthimet e përgjithshme. Një prej tipareve që parashihet të pasqyrohet në SKK është qasja më e mirë në banim dhe mbrojtja e së drejtës pronësore. Disa komuna përfshijnë referenca, si në Podujevë/Podujevo, Lipjan/Lipljan dhe Prishtinë/Priština, ndonëse jo qartë të definuara. Megjithatë, në shumë komuna tjera, si për shembull në Pejë/Peć, SKK-ja nuk është asgjë më shumë sesa një listë projektesh në zhvillim dhe deklaratash, dhe jo një strategji e realizueshme me veprime të duhura të parapara për të përbushur një synim të paracaktuar.

Doracaku i rishikuar inkurajon komunat që të inkorporojnë SKK-të e tyre në Planet Komunale për Zhvillim (PKZH) dhe planifikimin e përgjithshëm të buxhetit. PKZH-të janë projeksionet afatmesme zhvillimore komunale. Inkorporomi i tillë do të sillte përfitime në zhvillimin e komunitetit në hapësirat e banuara me minoritetë dhe/ose të kthyer sa i përket infrastrukturës, arsimit, shëndetësisë dhe shërbimeve tjera.

<sup>59</sup> Strategjia komunale për kthim duhet të ofrojë një kornizë për kthimet me aktivitete dhe objektiva të qarta.

## **g) Pjesëmarrja e personave të zhvendosur**

Pjesëmarrja e personave të zhvendosur është e rëndësishme për të siguruar implementim të suksesshëm të projekteve për kthim. Përfaqësimi i personave të zhvendosur është i paraparë në GPK-të (grupet punuese komunale) si dhe, në nivelin qendror, në MVQ dhe Grupin Drejtues, i cili duhet të takohet çdo tre muaj në koordinim me Mekanizmin përcjellës për stabilizim dhe proceset e Standardeve për Kosovën dhe Partneritetin Evropian.

Personat e zhvendosur janë pjesë integrale e përbërjes kryesore të GPK-së meqë për ta paraqet forumin kryesor për t'u angazhuar në dialog për çështje të kthimit, për të kërkuar ndihmë për kthim dhe paraqet organin kryesor lokal koordinues për implementim me përgjegjësi kryesore për projektet e kthimit dhe qëndrueshmërinë e procesit.

Në praktikë, pjesëmarrja e personave të zhvendosur në procesin e kthimit dallon nga një komunë në tjetrën. Pjesëmarrja e asociacionit/përfaqësuesve të personave të zhvendosur është vlerësuar të jetë aktive në disa komuna (Podujevë/Podujevo, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Prishtinë/Priština dhe Pejë/Pec) përmes pjesëmarrjes së asociacioneve, OJQ-ve e madje edhe përfaqësuesve të fshatrave në GPK. Megjithatë, një kontribut i tillë nuk është sistematik. Veç kësaj, për të përfshirë personat e zhvendosur brenda Serbisë si duhet, MVQ-ja ka themeluar "Grupin punues për personat e zhvendosur" me pjesëmarrje të OJQ-ve, organizatave ndërkombëtare dhe përfaqësuesve të personave të zhvendosur.

## **h) Qasja në banim e personave të zhvendosur në vendin e tyre aktual të banimit**

Mungesa e kthimeve të pakicave dhe zhvendosja e shkaktuar nga trazirat e marsit të vitit 2004 në Kosovë, kanë bërë që afro 200,000 persona të gjiejnë vendosje alternative. Personat e zhvendosur janë vendosur në strehimore kolektive apo/dhe në pronat e uzurpuara private dhe/apo pronat publike me apo pa pëlqim të pronarit.

Standaret ndërkombëtare për të drejtat e njeriut obligojnë autoritetet shtetërore të sigurojnë që personat e zhvendosur gjëzojnë kushte të duhura banimi dhe janë të mbrojtur nga dëbimet e paligjshme.<sup>60</sup> Realiteti në terren duket të jetë larg nga ky synim. Për shembull, shumica e personave të zhvendosur nga Obiliqi/Obilić banojnë në shtëpitë private të marra me qira apo në shtëpitë e të afërmve. Nuk ka plane për rivendosjen e tyre apo që t'u mundësohen banesa. Kërkesat e personave të zhvendosur për banesa, kanë bërë që të kthyerit dhe të tjerët të përqendrohen në komuna. Për shembull në komunën e Fushë Kosovës/Kosovo Polje, kishte 600 kërkesa të parashtruara për strehim në vitin 2006.<sup>61</sup>

Janë afro 330 persona të zhvendosur që jetojnë në Komunën e Gjilanit/Gnjilane, sipas vlerësimeve të UNHCR-së. Si shembull i kushteve të vështira, nëntë familje serbe të Kosovës (29 persona) jetojnë në një kontejner frigoriferi në Silovo/Shillovë (Gjilan/Gnjilane). Në komunë nuk ka plane konkrete për përmirësimin e kushteve të banimit, sigurimit të kthimit apo ri-vendosjes nuk ka.

Prej 587 personave të zhvendosur të cilët kanë arritur në Zveçan/Zveçan pas dhunës së marsit të vitit 2004, 353 janë aktualisht të vendosur në qendra kolektive, në dy ndërtesa të papërfunduara dhe në fshatin e Mali Zveçan/Zveçanit të vogël. Përveç tyre, 51 familje (me gjithsej 234 anëtarë) tani jetojnë me të afërmit në atë zonë.

## **i) Riatdhesimi i detyrueshëm**

Vendet perëndimore gjithnjë e më shumë janë duke i detyruar individët kosovarë të cilët jetojnë në territoret e tyre që të kthehen në Kosovë. Kthimi i detyrueshëm, në shikim të parë, nuk është në përputhje me standaret ndërkombëtare të të drejtave njerëzore, pasi riatdhesimi i detyruar mund të sjellë deri te shkelja e parimit të mos-riviktizimit.<sup>62</sup> Azilkërkuesit, aplikacionet e të cilëve refuzohen dhe shtetasit e vendeve të treta që jetojnë në mënyrë të paligjshme në shtetet anëtarë të BE-së, kanë gjithashtu të drejtë në garancione minimale. Bashkimi Evropian ka bërë të ditur në disa dokumente (Dokumenti i gjelbër i vitit 2002 mbi politikën e kthimit të komuniteteve me banim të paligjshëm: Direktiva e Këshillit 2002/55/EC 20, e korrikut 2001, për standaret minimale e dhënia se mbrojtjes së përkohshme në rast të fluksi të madh të hyrjeve të personave të zhvendosur) nevojën për themelimin e standardeve minimale për procedurat e kthimit dhe rrjedhimisht të jetë në përputhje me standaret e të drejtave të njeriut. Në këtë kuptim, neni 19 i Kartës Evropiane për të Drejtat Themelore të Njeriut ndalon dëbimet kolektive (Shih, gjithashtu neni 4 Protokoli 4 i KEDNj-së). Qëllimi i saj është që të garantojë se çfarëdo vendimi do të bazohet në shqyrtim specifik dhe që asnjë masë nuk mund të merret për të përashtuar të gjithë personat që kanë shtetësinë e një shteti të veçantë. Kjo dispozitë është veçanërisht e rëndësishme duke pasur parasysh ndihmën

<sup>60</sup> Shih, p.sh Parimi 18 i Parimeve Udhëzuese mbi Zhvendosjen e Brendshme: Pavarësisht nga rrëthanat dhe pa diskriminim, autoritetet kompetente do ofrojnë personave të zhvendosur qasje të sigurt në : (...) strehim themelor dhe banim'.

<sup>61</sup> Intervistat me Zyrtarët Komunal për Kthim Prishtinë/Priština; Obiliq/Obilić dhe Fushë Kosovë/Kosovo Polje, prill 2006.

<sup>62</sup> Shih nenin 33 (1) e Konventës së Kombeve të Bashkuara në lidhje me Statusin e Refugjatëve dhe Parimin 15 të Parimeve Udhëheqëse mbi Zhvendosjen e Brendshme.

e përkohshme që jepet në rast të fluksit të madh hyrës të personave të zhvendosur, siç ishte rasti me refugjatët e Kosovës në vitin 1999. Me përfundimin e mbrojtjes së përkohshme, shtetet mund të kthejnë me forcë individët në vendet e tyre të origjinës, në rast se ekzistojnë kushtet për një kthim të sigurt dhe dinjitoz. Me përfundimin e mbrojtjes, shtetet do të konsiderojnë për çdo rast të veçantë çfarëdo arsyesh që e bëjnë kthimin të pamundshëm. Ato do të vazhdojnë lejen për qëndrim të personave, të cilët kanë nevoja të posaçme, si ato mjeksore apo psikologjike, dhe që kanë fëmijë të mitur që ndjekin mësimet në ndonjë shtet anëtar, në mënyrë që të mund të përfundojnë periudhën shkollorë. Sidoqoftë, aty ku fëmijët janë të përfshirë vlen të përmendet se Konventa për të Drejtat e Fëmijëve përban një seri rekomandimesh që kanë për qëllim mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Duke respektuar standardet ndërkontaktare dhe qëndrimin e UNHCR-së, UNMIK-u nuk duhet të pranon riadheshimin e individëve të cilët bëjnë pjesë në të ashtuquajtura grupe të riskut, siç janë serbët e Kosovës, romët dhe shqiptarët kosovarë në lokacionet ku ata do të ishin pakicë, si dhe vazhdon të monitorojë ashkalitë dhe egjiptasit që do të mund t'i nënshtrohen riadheshimi. Gjatë vitit 2006, numri i përgjithshëm i personave të riadheshuar pa vullnetin e tyre nga vendet tjera arriti në shifrën 3,598.<sup>63</sup>

Nuk ekziston ndonjë strategji kosovare e banimit për të trajtuar nevojat e të kthyerve të detyruar (kosovarët e kthyer me dhunë nga vendet tjera). Për më tepër, komunitati gjithmonë janë të informuara për ardhjen e detyruar të të kthyerve. Zyrtarët e konsultuar në Prishtinë/Priština dhe Fushë Kosovë/Kosovo Polje i kanë deklaruar OSBE-së se nuk kanë informata mbi kthimet e detyruara.<sup>64</sup> UNMIK-u tanë është duke hartuar një strategji të riintegrimit në kontekst të diskutimeve mbi tranzicionin e statusit.<sup>65</sup>

### **3 – Procesi i rikthimit të pronës banesore dhe pronës**

Në situatën e pasluftës, duhet të vendosen mekanizmat e ankesave, në mënyrë që të rikthehen të drejtat e atyre që kanë humbur pronën dhe/ose posedimin e tyre si rrjetohojë e zhvendosjes.<sup>66</sup> Në bazë të parimit 29 (2) të Parimeve udhëzuese mbi zhvendosjen e brendshme, “autoritetet përgjegjëse kanë për detyrë dhe përgjegjësi që të ofrojnë ndihmë për personat e zhvendosur që janë kthyer apo rivendosur që të rikthejnë, deri në masën e mundshme, pronën dhe posedimet që i kanë lënë prapa, apo që janë shpronësuar në kohën e zhvendosjes së tyre. Kur rikthimi i pronave dhe posedimeve të tillë nuk është i mundshëm, autoritetet kompetente do të sigurojnë ose ndihmojnë këta persona në arritjen e kompensimeve gjegjëse apo në ndonjë formë tjetër të rikthimit të drejtë”.<sup>67</sup>

Realizimi i të drejtave pronësore në procesin e kthimit të personave të zhvendosur nënkuption një proces dypalësh: qasjen ndaj mekanizmave të ankesave dhe zbatimin efektiv të vendimeve gjegjëse.

Autoritetet përgjegjëse kanë për detyrë që të mbështesin këtë proces në mënyrë aktive, përmes veprimeve pozitive, gjegjësisht aktivitetet e vetëdijesimit drejt personave të zhvendosur, si dhe të mbështesin zbatimin e vendimeve relevante. Ngashëm, autoritetet kompetente, si Policia, duhet të përkrahin këtë proces përmes masave parandaluese (d.m.th. për të shmangur vjedhjet dhe/ose dëmet ndaj pronave).

Në Kosovë, UNMIK-u themeloi Drejtoratin për çështje pronësore dhe banesore (DÇPB) dhe Komisionin e ankesave pronësore dhe banesore (KAPB) për të trajtuar rikthimin e pronave banesore pas konfliktit. Kështu, KAPB-ja është organi kuazi-juridik për “arritjen e një zgjidhjeje efikase dhe efektive të ankesave në lidhje me pronën banesore”, derisa DÇPB-është organi administrativ që udhëheq procesin. Korniza ligjore për DÇPB/KAPB u themelua me Rregulloren e UNMIK-ut 1999/23 dhe Rregulloren e UNMIK-ut 2000/60, e cila përkufizon juridiksionin ekskluziv të KAPB-së për tri lloje të ankesave banesore: ankesat e kategorisë A ishin në lidhje me të drejtat pronësore të humbura për shkak të politikave diskriminuese gjatë periudhës 1989-1999; Ankesat e kategorisë B kishin të bënin me transaksionet joformale pronësore të pronave banesore gjatë periudhës 1989-1999, ndërsa Ankesat e kategorisë C, kishin të bënin me humbjen e pavullnetshme të posedimit mbi pronën banesore gjatë ose pas vitit 1999.<sup>68</sup>

<sup>63</sup> ZKKP e UNMIK, Raporti i Fund-vitit i Aktiviteteve, 2006.

<sup>64</sup> Intervistë me ZKK, prill 2006. Intervistë me Zëvendës Kryetarin Komunal të Fushë Kosovës/Kosovo Polje, prill 2006.

<sup>65</sup> OSBE-ja është gjithashtu anëtarë e Grupit Punues për Riadheshim dhe Riintegrin.

<sup>66</sup> Ligji ndërkontaktar nuk siguron ndonjë model standard të mekanizmit të ankesave; megjithatë ekziston një pajtim në rritje së voni që rikthimi apo kompensimi i pronave është themeli i procesit të ndërtimit të paqes dhe strategji e kthimit të qëndrueshëm. Vërimi, dispozitat për zgjidhjen e problemeve pronësore dhe tokësore janë përfshirë në disa marrëveshje të paqes apo dokumenteve gjegjëse, mes tjerash Marrëveshja e Paqes së Dejtonit (1995) ose pas zgjidhjes së konfliktit në Abkhazi, Projekt-Ligji vijues gjeorgjian mbi Rikthimin e Banesave dhe pronave tek Viktimat e Konfliktit të Osetisë Gjeorgjiane. Shih ABA CEELI: Analiza e Projekt-Ligjit mbi Rikthimin e Banesave dhe Pronave tek Viktimat e Konfliktit Gjeorgjian-Osetian, 30 gusht 2004.

<sup>67</sup> Neni 2, Parimet mbi Rikthimin e Banesave dhe Pronave për Refugjatët dhe Personat e Zhvendosur, E/CN.4/Sub.2/2005/17.

<sup>68</sup> Shih Rregulloren e UNMIK –ut nr. 1999/23 mbi Themelinin e Drejtoratit për Çështje Banesore dhe Pronësore dhe Komisionin për ankesa banesore dhe pronësore dhe Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/60 Për parashtresat mbi pronat banesore dhe Rregullorja e punës së drejtoratit për banim dhe prona dhe komisionit për parashtresat pronësore dhe banesore.

Përkundër vështirësive të hasura nga institucioni në vitet e para, DÇPB/KAPB-ja kryesisht ka përbushur mandatin e vet. Kështu, DÇPB/KAPB-ja ka zbatuar 28,828 vendime në lidhje me ankesat e pronës banesore (98.9 % të ngarkesës së përgjithshme të rasteve prej 29,160 ankesave). 332 vendimet e mbetur do të zbatohen në muajt në vijim.<sup>69</sup> Arsyja për vonesë në zbatim është se vendimet në fjalë prisin rishqyrtim nga ana e KAPB-së. Është me rëndësi të ceket që “zbatimi” i këtyre rasteve nuk nënkopon që ankuesit kanë rifituar pronën apo posedimin (dhe/ose janë kthyer). Kjo nënkopon njëren nga këto në vijim:

- Pronari ka bërë marrëveshje private dhe nuk ka nevojë më për shërbimet e DÇPB-së (që zakonisht përfshinë shitjet) (rreth 23% e ankesave të zgjidhura);
- Prona është shkatërruar, ashtu që administrimi nuk është i nevojshëm (36%);
- Prona është nën administrimin e DÇPB-së (12%);
- Rasti është refuzuar (10%); ose
- Pronari ka rimarrë posedimin (19%).

**Fig 2. Ankesat e zbatuara/Qershori 2007**

Sipërfaqja	Gjithsej	gjitha ankesat					A/C – Ankesat				B-Ankesat
		të térhequra	të refuzuara nga DÇPB	të refuzuara KAPB Nr Juris.	Nr merrits	kérkesat e mbyllura	Dest. i pronës	Riposedit i pronës	Nën admin.	pa dëbim	Gran. pron.
<b>në tërë Kosovë</b>	28829	2187	65	160	2712	2218	10154	5199	3513	2226	395
<b>% e parashtresave</b>	98.9	7.5	0.2	0.5	9.3	7.6	34.8	17.8	12	7.6	1.4
<b>% të zbatuara</b>	100	7.6	0.2	0.6	9.4	7.7	35.2	18	12.2	7.7	1.4

Mandati i DÇPB/KKPB është planifikuar të merret ekskluzivisht lidhur me kérkesat kontestuese për pronë banesore. Përderisa prona e paluajtshme e cila ka qenë e lidhur me banesën, bie nën juridiksonin e DÇPB/KKPB, prona private komerciale dhe bujqësore është lënë jashtë procesit.

Vetëm kohëve të fundit është adresuar zbrazetira e mbrojtjes së të drejtave për rikthimin e banesave dhe pronave. Në vitin 2005, i Dërguari Special i Sekretarit të Përgjithshëm të KB-ve, z. Kai Aide, në Shqyrtimin e tij gjithëpërfshirës të situatës në Kosovë (“Raporti i Kai Eide-s”) ka identifikuar usurpimin e paligjshëm të pronës bujqësore dhe komerciale si një ndër faktorët kryesor për pengimin e kthimit në Kosovë, kështu, si rrjedhim kjo çështje kërkon ndërhyrje urgjente. Në procesin paralel të fuqizimit vendor, organi ndërkombëtar i autorizuar për zgjidhjen e konfliktit lidhur me kontestet pronësore, DÇPB/KKPB-ja ka arritur sukses përmes Agjencisë Kosovare për Pronë (AKP), institucion vendor i pavarur me mandat të zgjidhjes së të gjitha kontesteve të pronës së paluajtshme banesore, komerciale dhe bujqësore që lidhen me konfliktin.<sup>70</sup>

Pra, AKP-ja është formuar nga Sekretariati Ekzekutiv, Bordi Mbikëqyrës dhe Komisioni për Kérkesa Pronësore (KKP) si pothuajse një organ gjyqësor. Pjesëmarrja e IPVQ-ve në mbikëqyrjen administrative dhe udhëheqjen e politikave të AKP-së sigurohet përmes nominimit të dy anëtarëve të Bordit Mbikëqyrës nga ana e Kryeministrit të Kosovës. Për sa i përket zgjidhjes së kontesteve të kérkesave, KKP-ja do të merr një vendim mbi kérkesat pronësore lidhur me titullimin, të drejtat përfshirët e pronës dhe të drejtat e posedimit ligjor. Vendimet e KKP-së janë të prera, nëse nuk apelohen. Ndryshtë nga mekanizmi i mëparshëm i DÇPB/KKPB-së, vendimet e komisionit mund t'i apelohen Gjykatës Supreme për të marrë vendim nga paneli i përbërë nga tre gjyqtarë, dy ndërkombëtarë dhe një vendor, që të gjithë të autorizuar nga PSSP-ja.

### a) Qasja në mekanizmat për kérkesa

Hapi i parë për sigurimin e térësishtëm të realizimit të të drejtave pronësore mbështetet në ekzistimin e mekanizmit për kérkesa, në mënyrë që personat e zhvendosur të kenë qasje. Informatat dhe qasja në procesin e pranimit të parashtresave sigurohet përmes zyrave të AKP-së, ekipave lëvizëse brenda dhe jashtë Kosovës, fushatave në terren të organizuara nga Agjencia Kosovare për Pronë, agjencitë joqeveritare dhe ndërqeveritare si dhe IPVQ-të. Që nga qershori 2007, Agjencia Kosovare për Pronë ka pranuar 23,629 kérkesa. (Shih Fig 2).

<sup>69</sup> Burimi: faqja e internetit të AKP (<http://www.kpaonline.org>).

<sup>70</sup> Shih Rregulloren e UNMIK-ut 2006/10 Mbi zgjidhjen e kérkesave mbi pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, e shfuqizuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50.

Janë bërë përpjekje të posaçme për të siguruar qasje në procesin e kérkesave nga ana e komuniteteve të ceneshe, siç janë romët, ashkalitë dhe egjiptasit (RAE). Në këtë kuptim, AKP-ja në muajin shkurt ka organizuar një fushatë në terren për t'i informuar personat e zhvendosur RAE të Kosovës për procesin e kérkesave. Si rezultat i kësaj fushate, APK-ja pret të parashtrohen 1,000 kérkesa shtesë.

### b) Vënia në zbatim e kérkesave dhe efekti i tyre në kthim

Zgjidhja e kérkesave përbën fazën e parë të procesit të nevojshëm për rivendosjen e të drejtave, dhe si rrjetim inkurajimin në shumë raste në kushtet për kthim të qëndrueshëm. Megjithatë, siç është përmendur më lartë, zgjidhja e kérkesave pronësore nuk nënkupton domosdoshmërisht kthimin e personave të zhvendosur. Në Kosovë, realiteti ka qenë mjaft i kundërt si rezultat i shkallës së lartë të pronave të shkatërruara dhe shkallës së ultë të riposedit. Në 10,108 raste, pronat kanë qenë të dëmtuara dhe nuk ekzistonte ndonjë mjet juridik në dispozicion nga DÇPB/KKPB-ja. Në këto raste, rezultat i procesit ishte pohim deklarativ i KKPB-së, duke vendosur posedimin ligjor të parashtruesit të suksesshëm.

Në 3,513 rastet e shqyrtuara, parashtruesi i kérkesës ka zgjedhur ta jep pronën për administrim, dhe në 1,159 raste, nuk ka qenë e mundur të kontaktohen parashtruesit e kérkesave. Në përgjithësi, vetëm në 5,199 raste (17.8 për qind) implementimi ka rezultuar me kérkesë për posedim të sërishtë nga ana e titullarit të të drejtës për pronë, që shpeshherë tregon për shitjen e banesës shfrytëzuesit aktual ose blerësit të ri.<sup>71</sup> Nga këto, 3,771 në raste, ka qenë i nevojshëm dëbimi i detyruar (86.6 për qind) dhe në 588 (13.4 për qind) të rasteve, shfrytëzuesit e kanë liruar pronën vullnetarisht para se të bëhej dëbimi i detyrueshëm.

Në raste të caktuara, dëbimi i uzurpuesit pasohet me uzurpim të ri të paligjshëm të pronës banesore. Në këto raste, ligji në fuqi lejon një veprim *ex officio* nga policia për largimin e uzurpuesit të paligjshëm.<sup>72</sup> Megjithatë, pas raportimit të rasteve të uzurpimit të sërishtëm të paligjshëm pasi që zë vend dëbimi, komuniteti ndërkombëtar me Shërbimin Policor të Kosovës vendosën si prioritet t'i kundërvihen uzurpimit të sërishtëm në “13 prioritet e Grupit të Kontaktit për zbatimin e standardeve” dhe Procedurat e korriguara relevante standarde të veprimit për të siguruar një përgjigje efikase.<sup>73</sup>

Zbatimi i vendimeve të KKP-së mbi kérkesat lidhur me tokën kérkon mjete juridike ndryshtës nga dëbimet prej objekteve të mbyllura, duke përfshirë, por duke mos e kufizuar, vënien e pronës nën administrim, marrëveshjet për qira, konfiskimin, shkatërrimin e paligjshëm të strukturave, ankandin, të gjitha këto do ta lehtësonin dhe siguronin kthimin e pronave poseduesve të ligjshëm të së drejtës pronësore.

Posedimi i sërishtës me siguri nxitje kryesore për kthim të qëndrueshëm. Në këtë kuptim, një sërë mjetesës juridike të parashikuara për AKP-në, përvèç dëbimeve (administrimi, qiratë, konfiskimi dhe shkatërrimi, ankandet) pasqyrojnë mundësitet e ndryshme për të iu përgjigjur uzurpimit të tokës. Në këtë kuptim, duke e marrë parasysh përvojën e procesit të DÇPB/KKPB-së, administrimi i tokës ka gjasë të jetë metoda primare për zbatimin e vendimeve të KKP.

### c) Kompensimi

Standartet ndërkombëtare parashohin mundësinë e kompensimit në rastet ku nuk është i realizueshëm rikthimi. Në pajtim me “Parimet Pinheiro” të pëershkuara më herët, si shembull, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin *Qipro kundërt Turqisë*, fakti që qipriotët grekë titullar të pronës në Qipron Veriore u është mohuar qasja në pronë, kontrollimi dhe të gëzuarit e pronës së tyre si dhe çfarëdo kompensimi për ndërhyrjen në të drejtat pronësore, që përbën shkeljen e nenit 1 të Protokollit 1 (E drejta pronësore).<sup>74</sup> Lidhur me këtë, ngarkesa me lëndët e pazgjdhura të DÇPB/KKPB, ka më se 258 vendime të KKP-së ku ka kérkesa të suksesshme si të kategorisë ‘A’, ashtu edhe kérkesa e kategorisë ‘C’ për të njëjtën banesë. Në këto raste janë bërë kompensime në para në favor të parashtruesit të kérkesës të kategorisë ‘A’ sipas nenit 4 të Regullores së UNMIK-ut 2000/60. Kjo është një brengë për kategorinë A të kérkesave, ku palës së pasuksesshme të kérkesës së parashtruar duhet t'i bëhet kompensim për humbjen e të drejtës për pronën e mbetur pas dhënies në posedim palës tjetër (parashtruesi i kategorisë ‘C’). Më tutje, legjislacioni akoma nevojitet për të aranzhuar përcaktimin e nevojshëm të shumave të sakta për kompensimin që duhet paguar, dhe se janë duke u zhvilluar diskutime ndërmjet UNMIK-ut dhe IPVQ-ve për të vendosur një mekanizëm të mirëfilltë. Në parim, parashtruesi i suksesshëm i kérkesës kërkohet të paguaj kompensimin, ndonjëse mund të merren parasysh marrëveshje alternative.

<sup>71</sup> Që nga muaji prill 2007, burimi nga faqja e internetit e Drejtoretit për Çështje Banesore dhe Pronësore (<http://www.hpdkosovo.org>).

<sup>72</sup> Shih nenin 13.6 të Regullores së UNMIK-ut 2000/60 dhe nenin 16.5 të Regullores së UNMIK-ut 2006/50.

<sup>73</sup> Shih shkresën e zyrës së UNMIK-ut të këshilltarit ligjor të komisarit të policisë (13 shkurt, 2007) që kérkon rishikimin e Regullores së Punës së Shërbimit Policor të Kosovës.

<sup>74</sup> GJEDNJ, *Qipro kundërt Turqisë*, 2001.

#### d) Administrimi i pronave të braktisura

AKP-ja ka pushtet për t'i administruar pronat e braktisura.<sup>75</sup> "Braktisja" në këtë kuptim do të thotë "Cila do pronë, pronari i së cilës apo poseduesi i ligjshëm dhe familja e tij e kanë lëshuar atë pronë pa vullnetin e tyre, për arsyet mungesës së jo rastësishme, dhe ajo pronë tanë është e zbrazët apo e usurpuar ilegalisht".<sup>76</sup> Administrimi i shtëpisë ose banesës nënkuption që AKP-ja mund t'ia jep në shfrytëzim atë në baza të përkohshme, personave jetët në baza humanitare.<sup>77</sup>

Që nga nëntori 2006, AKP-ja ka implementuar skemën për dhënien me qira duke mbuluar të gjitha 5,046 pronat banesore, tanë nën administrimin e AKP-së. Deri më sot, më shumë se 3,118 posedues të së drejtës pronësore e kanë përfshirë pronën e tyre në këtë skemë. Aktualisht, 409 shfrytëzues paguajnë qira dhe si rrjetëm i janë mbledhur 133.475,61 euro. Pas presionit nga IPVQ-të, disa banka janë pajtuar që t'i reduktojnë pagesat për transferet jashtë Kosovës.

Pagesat e para për periudhën prej muajit shtator deri në nëntor janë kryer në dhjetor, përderisa qiratë e dhjetorit janë bartur për në fillim të janarit 2007. Implementimi i skemës për qiradhënie garanton të hyra për të zhvendosurit si dhe mbrojtje fizike të pronave. Siç është përmendur më lartë, administrimi i tokës është njëra prej mjeteve juridike të dhëna në kornizën e AKP-së. Publiciteti i mundësive të administrimit të tokës mund t'u lejojë investitorëve bujqësorë dhënien me qira një grup të parcelave, që i përkasin personave të ndryshëm të zhvendosur dhe në këtë mënyrë të avancohet zhvillimi ekonomik dhe të ardhurat e regullta të këtyre të zhvendosurve.

**Fig. 3. Totali i kërkesave pronësore që nga Qershori 2007 sipas llojit të të drejtave dhe kërkesave pronësore (burimi nga faqja e internetit të AKP-së).**

#### Lloji i të drejtave të pronës

Rajoni/Kategoria	Gjilan/ Gnjilane	Mitrovicë/ Mitrovica	Pejë/Pec	Prishtinë/ Priština	Prizren	Totali	% e kërke- save
Pronësia	4946	2681	8054	4326	3416	23423	99.1
Të drejtat e shfrytëzuesit	21	37	49	64	35	205	0.9
Kompensimi	0	0	0	0	0	0	0
Totali	4967	2718	8103	4390	3451	23629	100
% e kërkesave	21	11.5	34.3	18.6	14.6	100	100

<sup>75</sup> Neni 16, Rregullorja e UNMIK-ut 2006/10.

<sup>76</sup> Shih nenin 1, Rregullorja e UNMIK-ut 2000/60.

<sup>77</sup> Ka dy mënyra me të cilat AKP-ja e administron pronën: a) me pajtimin e palëve që marrin pjesë në zgjidhjen e kërkesës/ankesës, përmes parashtruesit, pas vendimit që konfirmon të drejtën e tij pronësore ose pas débimit, nëse parashtruesi i kërkesës dështon ta posedoj pronën sërisht brenda 14 ditëve, prej njoftimit për ekzekutimin e débimit. Kjo do të thotë që banesa është nën administrim vetëm për aq kohë sa dëshiron personi i zhvendosur. Nëse personi i zhvendosur vendos të kthehet ose ta shes pronën, ai ose ajo mund të kërkoj që të ndërpritet administrimi i saj. Pastaj, AKP-ja është e obliguar që të ia dorëzoj administrimin e pronës parashtruesit të suksesshëm të kërkesës brenda 90 ditëve dhe b) kur nuk është parashtruar asnjë kërkesë për pronën dhe ajo pronë është e zbrazët apo shfrytëzuesi aktual nuk ka asnje të drejtë pronësore mbi atë pronë, ose me kërkesën e pronarit apo bartësit të së drejtës së banimit.

## Lloji i pronës

Rajoni/ Lloji i pronës	Gjilan/ Gnjilane	Mitrovicë/ Mitrovica	Pejë/Pec	Prishtinë /Priština	Prizren	Totali	% e kërke- save
Banesore	262	152	514	334	235	1497	6.3
Komerciale me ndërtesa	95	140	175	254	94	758	3.2
Komerciale pa ndërtesa	4610	2426	7414	3802	3122	21374	90.5
Totali	4967	2718	8103	4390	3451	23629	100
% e kërkuesave	21	11.5	34.3	18.6	14.6	100	100

### 4 – Kërkuesat e pezulluara në vitin 2004 përkitazi me dëmet që lidhen me konfliktin dhe sfidat tjera që kanë të bëjnë me zhvendosjet

E drejta për rikthim të pronës banesore dhe të pronës parasheh që refugjatëve dhe personave të zhvendosur duhet t'u kompensohet çfarëdo prone banesore, e tokës dhe/ose pronë e cila është faktikisht e pamundur që të rikthehet siç përcaktohet nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.<sup>78</sup> Veç kësaj, mbrojtja institucionale e të drejtave pronësore të personave të zhvendosur dhe e drejta e tyre për kthim kërkon funksionimin efektiv të gjyqësisë dhe policisë, si për sigurimin e mjeteve juridike për trajtimin e uzurpimit të paligjshëm dhe/ose dëmtimin e pronës dhe për të parandaluar dhe sanksionuar veprimet e reja të paligjshme.

Në Kosovë, mbrojtja e këtyre të drejtave është ballafaquar me sfida që lidhen drejtpërdrejt me rrethana të vecanta të konfliktit të Kosovës, me zhvendosjet dhe me sistemin e gjyqësisë që është në zhvillim e sipër. Në disa raste, këto sfida shpjinë në de faktō diskriminimin e personave të zhvendosur dhe shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë (neni 6, KNDNJ). Të një rëndësie të veçantë janë:

- a) mosgjidhja e një numri të kërkuesave që kanë të bëjnë me dëmet nga konflikti të parashtruara nga serbët e Kosovës kundër UNMIK-ut, KFOR-it dhe IPVQ-ve;
- b) transaksiononet mashtruese;
- c) përdorimi i parregullt i postit të përfaqësuesit të përkohshëm në procedurat civile;
- d) mungesa e mbrojtjes efektive të pronave të zbrazëta që u takojnë minoritetëve dhe/ose të kthyerve; dhe
- e) mungesa e informimit dhe kompensimit adekuat në shpronësimet e kryera nga autoritetet qeveritare.

#### a) Kërkuesat kundër UNMIK-ut, KFOR-it, IPVQ-ve dhe individëve të pezulluara në vitin 2004

Menjëherë pas konfliktit në Kosovë, një numër i madh i pronave banesore dhe pronave tjera të patundshme në pronësi të individëve që i takojnë komunitetit minoritar ishin shkatërruar nga elemente kriminale. Trazirat e marsit 2004, të pasqyruara në kapitullin e mëparshëm, e kanë bërë situatën edhe më të ndërlidhur. Gjatë punës së vet, AKP-ja ka identifikuar deri në 10,401 prona të shkatërruara. Në shumicën e këtyre rasteve, shtëpitë u kanë takuar pjesëtarëve të komuniteteve minoritare të cilët aktualisht janë të zhvendosur dhe nuk u janë ofruar mjete juridike lidhur me shkatërrimin e pronave të tyre.<sup>79</sup>

Individët e prekur nga shkatërrimi i pronave të tyre kanë kërkuar mjete juridike pranë gjykatave të rregullta të Kosovës: në vitin 2004, mijëra serb të Kosovës kanë parashtruar kërkesa në gjykatat e rregullta duke kërkuar që në bazë të legjislacionit në fuqi, t'u kompensohen dëmet e shkaktuara menjëherë pas konfliktit. Një numër i konsiderueshëm i këtyre kërkuesave janë parashtruar kundër më shumë të pandehurve. Kështu, paditësit kërkojnë kompensim, mes të tjerash, si nga UNMIK-u ashtu edhe nga KFOR-i, personeli i të cilëve përfiton nga imunitetet e përcaktuara me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/47, dhe që mund të konsiderohet se bie jashtë mandatit të

<sup>78</sup> Parimet e Pinheiros, nenii II. E drejta për rikthim të pronës banesore dhe pronës.

<sup>79</sup> Shih faqen e internetit të Drejtoretit për Çështje Pronësore dhe Banesore: <http://www.hpdkosovo.org/newimplemented.asp>, e vizituar më 30 nëntor 2006.

gjykatave dhe komunave të Kosovës ose personave të veçantë. Në dhjetor të vitit 2006, numri i kërkesave të tillë ka qenë 18,132.<sup>80</sup>

Në gusht 2004, DD-ja e UNMIK-ut ka udhëzuar kryetarët e gjykatave supreme, të qarkut dhe komunale që të mos i shqyrtojnë këto raste, që janë në pritje të një zgjidhjeje adekuate. Më 15 nëntor 2005, DD-ja ka nxjerrë udhëzime të reja duke kërkuar nga gjykatat që të shqyrtojnë ato raste që lidhen me kërkuesat për kompensim të dëmeve të kryera nga personat fizik të identifikuar pas tetorit të vitit 2000.<sup>81</sup>

Arsyja e dhënë nga DD-ja e UNMIK-ut për këtë udhëzim ishte se fluksi masiv i kërkesave do të pengonte rëndë punën e gjykatave, duke rritur numrin tanimë të madh të rasteve të pazgjadhura. Veç kësaj, shumicës së paditësve serbë do t'u nevojiteshin aranzhime të veçanta të sigurisë për të pasur qasje në gjykata.<sup>82</sup> Ky udhëzim ka ngritur shqetësimë përkitazi me të drejtat e njeriut pasi që ai komprometon të drejtën për të pasur qasje në gjykata nga paditësit serbë të Kosovës si dhe të drejtën e tyre që rasti të shqyrtohet brenda një periudhe të arsyeshme kohore.<sup>83</sup>

Gjithashtu, udhëzimet janë interpretuar nga shumica e gjykatësve që merren me rastet civile si e zbatueshme për kërkesat për kompensim të paraqitura kundër komunave dhe UNMIK-ut si rezultat i dëmeve në pronë të shkaktuara gjatë trazirave të marsit të vitit 2004, (shih Kapitullin 5). Rrjedhimisht, ndonëse shumë persona janë dënuar për veprën penale të dëmtimit të pronës të shkaktuara gjatë veprimeve të ndodhura gjatë trazirave të marsit të vitit 2004, OSBE-ja nuk ka identifikuar asnjë rast civil për kompensim që del si rezultat nga këto dënimë. Në anën tjetër, ekzistonjë disa kërkesa për kompensim të dëmeve të pësuara nga serbët e Kosovës gjatë trazirave të marsit të paraqitura ndaj komunave, Institucioneve të Përkohshme të Vëtexqeverisjes dhe UNMIK-ut, por ato mbeten të pezulluara deri tanë, në bazë të udhëzimeve të Departamentit të Drejtësisë.

Problemi i kërkesave që janë në pritje nuk paraqitet vetëm në lidhje me dëmet e pësuara nga serbët e Kosovës që nga viti 1999. Po ashtu, gjatë të njëjtës periudhë kohore, mbi 2,939 kërkesa të natyrës së ngjashme janë parashtruar edhe nga shqiptarët e Kosovës kundër Republikës së Serbisë dhe individëve serbë të Kosovës për dëmet e pësuara gjatë konfliktit të vitit 1999.<sup>84</sup> Ndonëse nga Departamenti i Drejtësisë nuk ka udhëzim lidhur me këto raste, të gjitha ato janë pezzulluar duke marrë parasysh pamundësinë e gjykatave për t'i trajtuar kërkesat për dëmshpërbllim kundër personave të mungesë (vendndodhja aktuale e shumicës së të paditurve serbë është e panjohur) dhe mungesa e juridiksonit të gjykatave të Kosovës për të gjykuar rastet kundër shtetit serb.

Mungesa afatgjatë e zgjidhjes së këtyre kërkesave (gati tri vite që nga gushti 2004) përbën shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë.<sup>85</sup> Për më tepër, kjo përbën shkelje të qartë të së drejtës së të gjithë refugjatëve dhe personave të zhvendosur për t'iu rikthyer çdo pronë banesore, tokë dhe/ose pronë nga të cilat janë privuar në mënyrë arbitrale ose të kompensohen kur një rikthim i tillë nuk është i mundur.<sup>86</sup>

Aktualisht, DD-ja e UNMIK-ut, në bashkërendim me faktorët tjera (Agjencinë Kosovare të Pronës, Ekipin Planifikues të Bashkimit Evropian, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Ministrinë e Drejtësisë dhe OSBE-në) po përpipet të gjeljë një zgjidhje për të gjitha këto raste. Qëllimi është që të zhvillohet një propozim për të gjykuar me eksplorativitet rastet që kanë të bëjnë me pronën, të paraqitura nga serbët e Kosovës kundër KFOR-it, UNMIK-ut, komunave dhe individëve, të pezulluara në vitin 2004 (dhe rastet e ngjashme), përfshirë ndihmën për gjykata dhe gjykatesit dhe sipas nevojës eliminimin e pengesave ligjore.

<sup>80</sup> Neni 180, Ligji mbi Kontratat dhe Marrëdhëniet e Detyrimeve, Gazeta Zyrta e RSFJ-së, nr. 29/1978, e ndryshuar. Përgjegjësia e veçantë, sipas alinesë 6 të Ligjit në nenin 180 të Ligjit eshtë përkufizuar si: ‘(1) Shteti, agjencitë e të cilat, në përputhje me rregulloret ekzistuese, kanë qenë të obliguara të parandalojnë dëmtimin apo humbjen, do të jenë përgjegjësë për humbjet për shkak të plagëve vdekjeprurëse, ose dëmtimit ose shkatërrimit të pronës së një individi, shkaktuar nga aktet e dhunës apo terrorist, si dhe gjatë demonstrave dhe ngjarieve publike.’

<sup>81</sup> Letra e Dreitorit të Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut, 24 qusht 2004 dhe 15 nëntor 2005.

<sup>82</sup> Shih Shavrtimin e Parë të Sistemit të Drejtësisë Civile në Kosovë nga Sektori i Monitorimit të Sistemit Ligjor të OSBE-së.

<sup>83</sup> Shih shënimin e mësipërm. Kjo çështje gjithashtu ka ngritur shqetësimë brenda Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, i cili ia ka adresuar çështjen Departamentit të Drejtësisë në disa raste. Shih Raportin e Pestë Vjetor 2004-2005 të Institucionit të Ombudspersonit drejtuar Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, 11 korrik 2005, në dispozicion në <http://www.ombudspersonkosovo.org>.

<sup>84</sup> Sipas statistikave të siguruara nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), Zyra për Statistikat.

<sup>85</sup> GJEDNJ ka vënë në dukje në disa raste se e drejtë për të pasur qasje në gjykatë është pjesë e së Drejtës për Gjykim të Drejtë (neni 6, KEDNJ) dhe duhet të jetë efektive. Shih akt gjykimet e Gjykatës në *Golder v. MB*, A 18, 1975 dhe *Airey v. Irlandë*, A32, 1979.

<sup>86</sup> Sih Parimet Pinheiros, neni 2.

### b) Transaksionet mashtruese

Bartjet mashtruese të pronës së patundshme ndodhin ose përmes falsifikimit të dokumenteve të identifikimit, ose përmes falsifikimit të autorizimeve të palëve të treta për të bërë transaksionin.<sup>87</sup> Pas marrjes së ankesave në këtë drejtim, Drejtori i Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut ka nxjerrë një udhëzim për të gjitha gjykatat komunale në Kosovë që çfarëdo dokumenti i autorizimit përbartje të pronës së patundshme i lëshur në Serbi t'i përcillet Departamentit për verifikim.<sup>88</sup> Kjo procedurë, prapseprapë, rezulton me vonesa të konsiderueshme për shkak të faktit se Departamenti duhet të komunikojë me Ministrinë e Drejtësisë së Serbisë.

c) Shfrytëzimi i parregullt i përfaqësuesve të përkohshëm

Sa i përket shfrytëzimit të përfaqësuesve të përkohshëm, OSBE-ja ka vërejtur vazhdimisht praktika të gjykatave që kanë shpier në shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë. Kjo është për shkak se në një numër të rasteve: a) gjykatat nuk shfrytëzojnë mjetet në dispozicion për të gjetur të paditurit para caktimit të përfaqësuesit të përkohshëm ligjor; b) gjykatat nuk vërtetojnë se vendimi i tyre për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm është i nevojshëm për të parandaluar pasojat e dëmshme për palët, që sipas ligjit në fuqi, është parakusht për caktimin e përfaqësuesve të përkohshëm<sup>89</sup> c) shpalloja publike joadekuate e caktimit të përfaqësuesve të përkohshëm; d) emri i përfaqësuesit të përkohshëm propozohet nga paditësi; e) përfaqësuesi i përkohshëm paguhet nga paditësi; f) kryerja joadekuate e punës gjatë përfaqësimit.<sup>90</sup>

d) Mungesa e mbrojtjes efikase të pronave të pakicave dhe të kthyerve

Një fushë tjetër brengosëse e cila lidhet me çështjen e zhvendosjes së poseduesve të të drejtave pronësore dhe procesit të rindërtimit të shtëpisë të tyre, është mbrojtja e shtëpisë të rindërtuara nga dëmtimi apo plaçkitja. Mbrotja e pronave të rindërtuara të zbrazëta në të cilat nuk janë kthyer banuesit e mëparshëm të ligjshëm është posaçërisht brengosëse. Në Fushë Kosovë/Kosovo Polje, me përjashtim të disa shtëpisë të cilat janë kthyer në posedim apo shitur, të gjitha shtëpitë tjera të rindërtuara pas trazirave të marsit janë plaçkitura. Për shembull, 65 raste të veprave penale të dëmtimit dhe plaçkitjes janë raportuar në polici gjatë vitit 2005, ku janë përsfirë 51 nga këto prona.

Raste tjera të dëmtimit janë raportuar nëpër tërë Kosovën. Një nga më të vonshmit dhe më të njohurit ka ndodhur në shtator të vitit 2006, në dy fshatra të ndryshme të komunës së Klinës/Klina. Në natën e 11 Shtatorit 2006, një shtëpi e rindërtuar që ishte pronë e një serbi të Kosovës në fshatin Shtupel/Štupelj ishte dëmtuar shumë rëndë nga një eksploziv. Disa ditë më parë, ndodhi një incident i plaçkitjes së një shtëpie të rindërtuar në fshatin Klinavac/Klinafc.

Edhe në Klinë/Klina, më 3 mars 2007 komuna rrënoi një ndërtesë të tërë e cila ishte nën administrimin e AKP-së pas përfundimit të procedurës së shpronësimit. Përkundër kërkesave zyrtare nga AKP-ja për ndalimin e rrënimit, komuna vazhdoi dhe e rrënoi ndërtesën pas njoftimit verbal të personit që jetonte në të (poseduesit të lejes së përkohshme të banimit). Procedura penale është në vazhdim e sipër.

Në përgjithësi, mungesa e mbrojtjes efektive çon drejt zvogëlimit të besimit në institucionet e zbatimit të ligjit në Kosovë nga ana e personave të zhvendosur dhe individët e komuniteteve pakicë.

e) Mungesa e njoftimit adekuat dhe kompensimit në eksproprijimet e ndërmarra nga ana e autoriteteve qeveritare.

Sidoqoftë, edhe përkundër përmirësimeve, komunat dhe autoritetet tjera qeveritare ende vazhdojnë ta zbatojnë procedurën në mënyrë jo të drejt, ose i shmanget procedurës e cila rezulton të jetë ndërhyrje jo e ligjshme në të drejtat pronësore pa pasur mjet juridik. Veç kësaj, veprimet e tilla mund të paraqesin shkeljen e procesit të drejt, dhe, në rastet ku përfshihen pjesëtarët e komuniteteve etnike, bënë diskriminim. OSBE është e brengosur për: dështimin e autoriteteve lokale që mënyrë të drejt të bëjnë në eksproprijimin e kryerjes së punëve publike; përcaktimin jo të drejt të natyrës së interesit të përbashkët, si dhe për mungesën e identifikimit të mirëfilltë dhe njoftimin e bartësit të së drejtës pronësore të prekur (posaçërisht personat e zhvendosur) dhe dhënien e kompensimit joadekuat; dhe mungesën e mjeteve efektive juridike, si dhe për kryerjen e eksproprijimeve jo të ligjshme nga strukturat paralele administrative. Gjithashtu, komunat ende nuk e respektojnë legjislacionin në fuqi lidhur me bartjen dhe shfrytëzimin e pronës shoqërore.

<sup>87</sup> Shih Shqyrtimin e Parë të Sistemit të Drejtësisë Civile nga SMSL i OSBE-së, gershor 2006, f.21.

<sup>88</sup> Qarkoret e Departamentit të Drejtësisë DOJ/DIR/344/JH/04 dhe DOJ/LPD/0371/er/05.

89 Neni 84, LPC.

<sup>90</sup> Raporti i SMSL-së të OSBE-së mbi 'Caktimin e Përfaqësuesve në Kontestet Pronësore', prill 2005. Shih gjithashtu Shqyrtimin e Parë të Sistemit të Drejtësisë Civile, gershori 2006, f. 25.

## 5. Programi i rindërtimit pas trazirave të marsit 2004

Gjatë trazirave të marsit 2004 u sulmuan pronat e komunitetit pakicë si dhe vendet e trashëgimisë kulturore ortodokse. Si rezultat i kësaj, 993 prona banimi dhe 34 ndërtesa fetare u dëmtuan ose u shkatërruan dhe 398 pjesëtarë të komunitetit pakicë vuajtën dëmtimë të shkatërrimit të ndërtesave komerciale apo dytësore. Prandaj, afersisht 4. 000 persona u zhvendosën nga shtëpitë e tyre, disa nga ata për të dytën herë, pasi që ishin zhvendosur edhe në vitin 1999.<sup>91</sup> Këto ngjarje patën një ndikim të konsiderueshëm si në zbatimin e mandatit të DÇPB/KAPB (p. sh. zyrat rajonale të DÇPB-së ishin plaçkitur) ashtu edhe në procesin e kthimit i cili u pothuajse u ndalua i terti. Këto trazira patën ndikim negativ në sigurinë fizike të komuniteteve pakicë si dhe perspektivat përintegrimë socio-ekonomike të të kthyerve potencial. Në përgjithësi, autoritetet ndërkombëtare dhe vendore dështuan të mbronin individët nga zhvendosja.

Rindërtimi i dëmeve të shkaktuar nga trazirat e marsit 2004 ndaj vendbanimeve, ndërtesave dytësore dhe ndërtesave komerciale iu është besuar IPVQ-ve.<sup>92</sup> Si rrjedhojë, periudha fillestare e procesit të rindërtimit është udhëhequr nga një komision qeveritar i themeluar ad hoc-Komisioni Qendror Ndërministror për Rindërtim ("Komisioni Brajshori").<sup>93</sup> Është arritur përparimi i dukshëm derisa ky komision pushoi së funksionuari në fund të korrikut 2005. Komisioni ndërministror u shpërbë në nëntor të vitit 2005.

Adresimi i shkatërrimeve të marsit 2004 u bë prioritet i lartë për Qeverinë e Kosovës pasi që shtetet e Kontakt Grupit e përfshinë atë si një nga '13 pikat' (prioritetet në zbatimin e Standardeve për Kosovën) në mes të vitit 2006. Në këtë mënyrë Grupi i Kontaktit bëri thirrje përfundimin e rindërtimit të të gjitha shtëpive në fshatin serb të Svinjarit/Svinjare (Mitrovicë/Mitrovica), deri në fund të tetorit 2006 si dhe rindërtimin ose kompensimin e pronës komerciale të dëmtuar gjatë trazirave. Në qershori të vitit 2006 me kërkësë të Kryeministrit të Kosovës, PSSP-ja vendosi që Trupat Mbrotjëse të Kosovës (TMK) të finalizojnë punën e mbetur të rindërtimit në Svinjarë/Svinjare dhe të mbështesin qeverinë në zgjidhjen e kërkësave të pazgjidhura (në tërë Kosovën) të ndërlidhura me rindërtimin fizik nga trazirat e marsit 2004. TMK-ja ndërmori punimet në Svinjarë/Svinjare përderisa Qeveria themeloi një organ ad hoc përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha kërkësave.

Në përgjithësi, që nga janari 2007, 897 prona banesore (nga 993 të synuara) janë rindërtuar dhe 289 të rasteve që kishin të bënin me ndërtesat dytësore u adresuan (ose u rindërtuan ose u kompensuan). Që nga janari 2007, janë zgjidhur një numër i këtyre kërkësave. 96 shtëpi të parindërtuara përfshijnë 19 prona për të cilat përfituesit e kanë refuzuar ndihmën e ofruar të rindërtimit, 20 prona në veri të Mitrovicës/Mitrovica në të cilat nuk ka qasje për shkaqe të sigurisë si dhe 57 prona të shkatërruara në lagjen "Podkalaj" të qytetit të Prizrenit për të cilën është zhvilluar një program i posaçëm por ende është duke pritur për financim edhe pas tri viteve.

Sa i përket ndërtesave dytësore, ende ekzistonjë 49 raste në pritte (nga 338 përfitues të mundshëm), shumica e të cilëve nuk janë pajtuar me vlerësimin përlartësinë e kompensimit të vendosur nga Komisioni Ndërministror. Sa i përket sigurimit të "ndihmës fillestare", 92 nga 635 raste janë në pritte e sipër. Përfundimisht kanë mbetur 24 raste të pronave komerciale të cilat nuk janë adresuar. Në tetor të vitit 2006 është themeluar një panel i udhëhequr nga IPVQ-të për zgjidhjen e kërkësave përfundimtare rindërtim (me përashtim të rasteve të fshatit Svinjarë/Svinjare) për të shqyrtuar të gjitha kërkësat e pazgjidhura për rindërtim nga trazirat e marsit 2004. Detyra e panelit ishte të shqyrtoj kërkësat individuale nga përfituesit dhe nga kontraktuesit. Deri më tanë paneli ka kufizuar shqyrtimin e kërkësave të kontraktuesve dhe asnjë nja kërkësat tjera nuk është shqyrtuar për shkak të kufizimeve buxhetore.

Qeveria po heziton të ndajë buxhet të mëtutjeshëm për programin e rindërtimit të marsit 2004 pa treguar se ndërhyrjet e tilla do të lehtësonin kthimin e të zhvendosurve. Përmomentin qeveria nuk ka ndonjë plan as për periudhën pas marsit 2004 e as për të shqyrtuar kërkësat. Po ashtu mungojnë edhe informata për numrin e personave të zhvendosur. Në janar të vitit 2006, UNHCR-ja vlerësoi se 1,231 persona të zhvendosur gjatë trazirave të marsit, kanë mbetur të zhvendosur. Mirépo që nga ajo kohë, nuk janë mbajtur statistika të sakta për të zhvendosurit nga trazirat e marsit 2004.

## 6. Konkluzionet

Megjithëse, si bashkësia ndërkombëtare ashtu edhe institucionet e Kosovës kanë investuar resurse të konsiderueshme dhe energji përsigurimin dhe mbrojtjen e të drejtës së personave të zhvendosur përi rikthim

<sup>91</sup> Shih Raportin e Misionit të OSBE-së në Kosovë 'Sfidat e të drejtave të njeriut pas trazirave të marsit', faqe 15.

<sup>92</sup> Rindërtimi i vendeve të dëmtuara të trashëgimisë kulturore nuk është përfshirë në këtë raport. Tani për tanë një Komision për Implementim të Rindërtimit (KIR), i udhëhequr nga Këshilli i Evropës është përgjegjës përi implementim të riparim eve.

<sup>93</sup> Ministri Brajshori dha dorëheqje në nëntor të vitit 2004 para ndryshimit të Qeverisë dhe Ministri Haraqia u emërua si kryesues i ri i Komisionit Ndërministror në dhjetor 2004.

të pronës banesore dhe pronës, kjo nuk është shndërruar në mbrojtje të efektshme të kësaj të drejte, apo në kthim substancial dhe të qëndrueshëm. Përafërsisht një e treta e rasteve të DÇPB-së kanë rezultuar me vendime deklarative ndaj pronave të shkatërruara.

Në prag të tranzicionit të statusit mbrojtja e të drejtave pronësore banesore, kthimi i pronave personave të zhvendosur dhe mbrojtja e të drejtës për t'u kthyer vazhdojnë të janë sfidat kryesore. Fakti që kanë kaluar tetë vite prej përfundimit të konfliktit të vitit 1999 nuk e përjashton të drejtën e personave të zhvendosur ndaj pronave që i kanë lënë pas, apo të drejtën e tyre për kushte adekuate të jetesës.

Në këtë kontekst, zbatimi i mandatit të AKP-së ndaj kërkesave të pronës së paluajtshme private që kanë të bëjnë me konfliktin dhe zbatimin efektiv të vendimeve të KKP-së deri më tanë është sfida më e madhe për autoritetet vendore dhe ndërkontrolltare. Efektiviteti dhe qëndrueshmëria e procesit varen nga zbatimi i vendimeve të KKP-së. Duhet të sigurohet financimi i plotë nga donatorët për AKP-në deri në përfundim të mandatit të saj.

Përveç kërkesave të AKP-së, duhet të zgjidhen të gjitha çështjet tjera të pazgjadhura që janë të ndërlidhura me konfliktin. Në këtë aspekt, është e nevojshme të gjendet edhe një zgjidhje e pranueshme për kompensimin e kërkesave që lidhen me konfliktin të pezulluara me kërkesë të DD-së të UNMIK-ut e që presin për t'u shqyrtaur nëpër gjykata. Moszgjdhja për një kohë të gjatë e këtyre kërkesave (gati që tri vite që nga gushti i vitit 2004) përbënë shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë. Brengat që dalin nga gjykatat e rregullta sa i përket shitbllerjeve të rrejshme dhe mbrojtja e të drejtave pronësore të personave të zhvendosur në procedurat civile është një çështje që po ashtu duhet të adresohet. Në këtë aspekt, mekanizmat për parandalimin e shitbllerjeve mashtruese duhet të racionalizohen dhe të bëhen më të efektshme. Gjithashtu edhe emërimi i përfaqësuesve të përkohshëm duhet të jetë në përputhje me ligjin dhe kërkesat përkatëse procedurale.

Sa i përket promovimit të së drejtës për kthim, transformimi i strukturave për kthim ende duhet të prodhojë fryshtet e veta, të cilat duhet të pasqyrohen në rindërtimin e shtëpisë të të gjithë atyre të zhvendosurve të cilët dëshirojnë të kthehen. Në këtë aspekt, pjesëmarrja e shoqatave të personave të zhvendosur në Grupet Punuese të Komunave duhet të vazhdojë dhe të bëhet më efektive. Përderisa pjesëmarrja e QKK-së në proces është një zhvillim kryesish pozitiv, QKK-ja duhet t'i përbahet parimeve dhe procedurave të parashtruar në Doracakun e Rishikuar për Kthim të Qëndrueshëm. E njëjtë vlen edhe për autoritetet komunale, të cilët duhet të bashkëpunojnë drejt sigurimit të qasjes në toka dhe shtëpi kurdo që është e nevojshme, si dhe drejt sigurimit të ndihmës në rindërtim. "Protokoli për Kthim të Qëndrueshëm" i vitit 2006 i nënshkruar nga Qeveria e Kosovës, Republika e Serbisë dhe UNMIK-u mund të shërbejë si model për bashkërendimin dhe mbështetjen e khimeve në nivel komunal. Komunitat në Kosovë të cilat janë nikoqire të personave të zhvendosur, posaçërisht në pjesën veriore të Kosovës, duhet t'i përbushin obligimet e tyre për të siguruar kushte adekuate të banimit. Me mijëra njerëz ende vazhdojnë të jetojnë në kushte të papranueshme edhe pas gati të vitezë pas konfliktit dhe kjo çështje duhet trajtuar.

Programi i rindërtimeve që lidhen me trazirat e marsit 2004– që ishte si përgjigje ndaj krizës e cila pjesërisht kishte ndaluar kthimet dhe rikthimin e pronës banesore dhe të pronës – i ka plotësuar në një masë të madhe synimet e veta, por ende duhet të finalizohet sa më shpejtë që është e mundur nga Trupat Mbrojtëse të Kosovës. Paneli për kërkesa që udhëhiqet nga IPVQ-të duhet të ofrojë më shumë qasje dhe të jetë më transparent.

Në përgjithësi, vlerësimi tregon se përderisa rivendosja e të drejtave pronësore dhe banesore pas konfliktit dhe kthimi fizik dhe vullnetar i personave të zhvendosur janë procese të ndara, ato duhet të kenë një strategji të koordinuar për të siguruar që ato të mbështesin dhe të fuqizojnë njëra-tjetrën.

## **Aktivitetet pasuese përkitazi me rekomandimet në “Tetë vite më pas: kthimi i pakicave dhe kthimi i objekteve banesore dhe pronës në Kosovë”**

29 nëntor 2007

Në raportin e saj ‘Tetë vite më pas: kthimi i pakicave dhe kthimi i objekteve banesore dhe pronës në Kosovë’, Misioni i OSBE-së në Kosovë ka përpiluar një tërësi rekomandimesh. Këto i janë dërguar zyrtarisht çdo personi përgjegjës në çdo institucion në mënyrë që të nxitet implementimi i tyre dhe kështu të mbështet procesin e kthimit dhe kthimin e pronës dhe objekteve banesore dhe sigurimin e kushteve më të mira për të zhvendosurit në vendet aktuale të zhvendosjes. OSBE-ja, bazuar në hulumtim, beson se këto rekomandime ofrojnë opsione më të mira të mundshme në arritjen e përparimit në sferën e kthimit të pakicave dhe kthimit të pronave dhe objekteve banesore. Në vijim janë dhënë informata më të reja lidhur me statusin e çdo rekomandimi pesë muaj pas lëshimit të raportit, i cili mbulon periudhën prej korrikut deri në nëntor 2007. Azhurnimi bazohet në informatat e mbledhura nga prania e OSBE-së në terren.

### **Për Qeverinë e Kosovës**

Të përgatitet Strategjia dhe Plani i veprimit për kthim, reintegrin, banim dhe kthim të pronave në përputhje me Strategjinë e saj të përgjithshme mbi të drejtat e njeriut.

*Deri më sot, nuk ka pasur zhvillime lidhur me komponentin specifik të objekteve banesore dhe pronës përbrenda Strategjisë së IPVQ-së për të drejtat e njeriut.*

Të zbatohet, sipas nevojës, Protokolli mbi kthimin vullnetar dhe të qëndrueshëm, në bashkëpunim me UNMIK-un dhe Republikën e Serbisë.

*Protokolli nuk është duke u zbatuar në mënyrë formale.*

Të sigurohet funksionimi dhe qasja në Komisionin e ankesave për Programin e rindërtimit të marsit 2004.

*Komisioni i ankesave për Programin e rindërtimit për marsin e vitit 2004 momentalisht nuk është duke funksionuar.*

*Shënim: Mediat lokale kanë cituar një këshilltar të Zyrës së Kryeministrit i cili i kishte cilësuar këto tri rekomandime për Qeverinë e Kosovës si të “pabaza” dhe në kundërshtim me përpjekjet e vazhdueshme të IPVQ-së për të përmbrushur Planin për Implementimin e Standardeve të Kosovës.<sup>94</sup>*

### **Për Ministrinë për komunitete dhe kthim**

Të udhëzohen komunat në zhvillimin dhe zbatimin e Strategjive efektive komunale për kthim dhe të inkorporohen ato në Planet zhvillimore komunale.

*Ministria për Komunitete dhe Kthim është inkuruar t'i udhëzojë komunat. Deri më sot, nuk është ofruar ndonjë udhëzim specifik lidhur me inkorporimin e Strategjive komunale për kthim në Planet komunale për zhvillim.*

Të vlerësohen mundësitë për mbrojtjen e pronave të zbrazëta të rindërtuara, përfshirë edhe administrimin nga organet relevante.

*Gjatë periudhës së raportimit nuk ka pasur zhvillime. Një përfaqësues i Ministrisë për komunitete dhe kthim ka deklaruar publikisht se kompetencat e rezervuara të bashkësisë ndërkombëtare e vështirësojnë zbatimin e këtij rekomandimi.<sup>95</sup>*

Të finalizohet krijimi i bazës së të dhënave mbi të zhvendosurit dhe të përgatiten raportet e rregullta statistikore mbi zhvendosjen..

*Gjatë periudhës së raportimit nuk ka pasur zhvillime domethënëse. Ministria për komunitete dhe kthim pozon se për krijimin e bazës së të dhënave për të zhvendosurit puna është në zhvillim e sipër.*

### **Për Agjencionin Kadastral të Kosovës**

Të themelohet, përmes një Memorandumi të mirëkuptimit me Agjencionin kosovar të pronave, një mekanizëm efikas për regjistrimin e titullit, sipas rastit, pas vendimeve nga Komisioni mbi Ankesat Pronësore.

*Nuk ka zhvillime deri më sot.*

<sup>94</sup> Koha Ditore, e diel 12 gusht 2007.

<sup>95</sup> Koha Ditore, e diel 12 gusht 2007.

## **Ajpcionit kosovar të pronave**

Të rriten përpjekjet për kontaktet në terren për të shpjeguar mjetet juridike që ofrohen nga AKP-ja për titullaret e zhvendosur të pronave në bashkëpunim me të gjithë grupet relevante të interesit.

*Përpjekjet për kontakte në terren janë shpeshtuar. Fushata për vetëdijesim janë në zhvillim e sipër.*

Të përkujdeset që zbatimi i skemës së dhënies me qira të zgjerohet në mënyrë efektive për të gjitha pronat nën administrimin e saj.

*Zbatimi i skemës së qirasë i menaxhuar nga AKP-ja ende vazhdon. Në kohën e përpilimit të raportit, 2,600 pronarë kanë përfshirë pronat e tyre në skemë. 737 banues momentalisht janë duke paguar qiranë, janë kryer 346 dëbime dhe gjithsej 357,889.14 € janë grumbulluar.*

Të përkujdeset, në bashkëpunim me UNHCR-in dhe OSBE-në, që zyrtarët komunal pér kthim të jenë plotësisht të informuar pér procesin e AKP-së në mënyrë që të mbështetet kthimi dhe reintegrimi.

*Fushata mbi mjetet juridike të ndërlidhura me pronën është duke u zbatuar nga OSBE-ja në bashkëpunim me AKP-në dhe grupet e tjera të interesit. AKP-ja poashtu është duke i koordinuar përpjekjet me UNHCR-in pér informim të zyrtarëve komunal pér kthim, zyrtarëve komunal pér komunitete, zyrtarëve pér barazi gjinore dhe Qendrat pér punë sociale lidhur me procesin e AKP-së pér ndihmë të kthyerve, të zhvendosurve dhe pakicave në përgjithësi lidhur me pyetjet e ndërlidhura me pronën.*

## **Për komunat**

Të koordinohet përmes zyrtarëve komunal pér kthim me AKP-në në nivel lokal pér t'u përkujdesur që personat e zhvendosur në nivel lokal dhe të kthyerit të jenë në dijeni pér mjetet juridike që ofrohen nga agjencioni.

*Fushata mbi mjetet juridike të ndërlidhura me pronën është duke u zbatuar nga OSBE-ja në bashkëpunim me AKP-në dhe grupet e tjera të interesit. AKP-ja poashtu është duke i koordinuar përpjekjet me UNHCR-in pér informim të zyrtarëve komunal pér kthim, zyrtarëve komunal pér komunitete, zyrtarëve pér barazi gjinore dhe Qendrat pér punë sociale lidhur me procesin e AKP-së pér ndihmë të kthyerve, të zhvendosurve dhe pakicave në përgjithësi lidhur me pyetjet e ndërlidhura me pronën.*

## **Për Shërbimin policor të Kosovës**

Të fuqizojë, në koordinim me UNHCR-in, AKP-në dhe me autoritetet komunale, mekanizmat ekzistues pér t'u përkujdesur që pronat e zbrazëta të rindërtuara, pronat banesore nga të cilat më herët janë bërë dëbime ligjore dhe pronat e tjera të patundshme të mbrohen nga dëmet dhe nga zënia e jashtëligjshme.

Gjatë pesë muajve të kaluar, AKP-ja ka hasur në vështirësi në zbatimin e vendimeve të Komisionit të Ankesave pér Çështjet Banesore-Pronësore. Më 2 gusht, PSSP-ja ka lëshuar një Vendim Ekzekutiv me të cilin suspendohej përkohësisht zbatimi i vendimeve të KABP-së "deri në rivendosjen e unitetit të nevojshëm ndërmjet të gjitha grupeve të interesit". Vendimi është anuluar më 8 gusht pasi Institucionet e përkohshme e ri-vërtetuan vendosmërinë e tyre pér t'i zbatuar të gjitha vendimet përfshirë edhe ato më të vështira. Përkundër anulimit, problemet edhe më tej qëndrojnë të pazgjidhura.

Në dy rastet në komunën e Klinës dhe në kundërshtim me karakterin e formës së prerë të vendimeve të KABP-së, SHPK-ja refuzoi të ofrojë ndihmë AKP-së në zbatimin e dëbimeve dhe/ose largimin e banuesve të jashtëligjshëm edhe pas dëbimit paraprak.

Në një rast, i cili kishte të bënte me pronën që ishte zënë në mënyrë të paligjshme nga një politikan lokal, SHPK-ja iu referua një vendimi të lëshuar më 8 tetor nga gjykata komunale si bazë pér mos-ofrimin e ndihmës. Mirëpo, vendimi në fjalë i gjykatës komunale, i cili që atëherë është anuluar, ishte në kundërshtim me ligjet në fuqi.

Në rastin e dytë, SHPK-ja iu referua procedurave gjyqësore që janë në zhvillim e sipër, poashtu duke shpërfillur jurisdikcionin ekskluziv të HPD-së/ KABP-së si dhe karakterin e formës së prerë të vendimeve të KAOP-së.

Në rastin e tretë, lidhur me një pronë në Deçan, SHPK-ja pohonte se i duhet autorizimi nga prokurori publik si dhe vendimi nga gjykata komunale pér të zbatuar vendimet e KABP-së pér riposetim të pronës në fjalë, që ishte zënë në mënyrë të paligjshme.

## **Për Institutin kosovar gjyqësor**

Të ofrohet trajnim i rregullt pér gjykatat mbi aspektet e ndryshme të mandatit të Ajpcionit kosovar të pronave

lidhur me ankesat pronësore që dalin nga konflikti, përfshirë edhe efektet e natyrës obligative të vendimeve të KABP-së.

*Në tetor të vitit 2007, Instituti Kosovar Gjyqësor ndërmori një trajnim mbi referimin e disa rasteve të gjikuara nga Komisioni i Ankesave për Çështjet Pronësore-Banesore në gjykatat komunale. Trajinimet shësë mbi çështjet e ndërlidhura me Agjencionin Kosovar të Pronave si dhe mbi të drejtat pronësore planifikohen për vitin 2008.*

### **Për Ministrinë serbe të Kosovës**

Të marrin pjesë në strukturën për kthim ashtu që të përkujdeset që të gjitha projektet e finançuara nga Qendra Koordinuese për Kosovën (QKK) të janë në përputhje me udhëzimet dhe parimet e parashikuara me Doracakun e ndryshuar për kthimet e qëndrueshme.

*Ministria Serbe për Kosovën momentalist nuk merr pjesë formalisht në strukturat e procesit të kthimit.*

Të ndihmojë në kthimin e shënimive kadastrale dhe gjyqësore që rrjedhin nga apo kanë të bëjnë me Kosovën të cilat momentalist gjenden në Serbi.

*Kthimi i shënimive kadastrale dhe gjyqësore vazhdon të jetë në pritje. Gjatë periudhës raportuese nuk janë shënuar zhvillime.*

### **Për UNHCR-in**

Të integrohen çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të objekteve banesore dhe ato pronësore, siç është përzgjedha transparente dhe jo-diskriminuese e përfituesve dhe procedurave të verifikimit të të drejtave pronësore, në programet e saj të ngritisës së kapaciteteve në çështjet e kthimit.

*Deri tash nuk ka zhvillime.*

T'u sigurohet autoritetete komunale qasje në statistika për zhvendosje dhe kthim.

*Autoritetet komunale kanë qasje statistikave të UNHCR-it.*

### **Për Departamentin e UNMIK-ut për Drejtësi**

Të përgatitet një propozim bashkërisht me grupet e tjera të interesit për të gjykuar sa më shpejtë rastet e ndërlidhura me pronën që parashtrohen nga serbët kundër KFOR-it, UNMIK-ut, komunave dhe individëve që janë suspenduar në vitin 2004 (dhe rastet e ndërlidhura), përfshirë edhe ndihmë gjykatave dhe gjyqtarëve në eliminimin e pengesave ligjore.

*Gjykatat komunale kanë filluar me lëshimin e vendimeve duke refuzuar jurisdikcionin e tyre mbi këto çështje dhe duke i referuar ankesat tek AKP-ja.<sup>96</sup> Lidhur me këtë temë, pritet mendimi i Kryetarit të Gjykatës Supreme që do të shërbejnë si udhëzime për gjykatat komunale dhe të qarkut.*

### **Për UNMIK-un/Zyrën për komunitete, kthim dhe pakica**

Në bashkëpunim me Ministrinë për komunitete dhe kthim, t'i udhëzojnë Grupet punuese komunale mbi procedurat për ndarjen e tokës dhe objekteve banesore për të zhvendosurit në projektet për kthim dhe reintegrim.

*Gjate periudhës së raportimit, nuk është ofruar ndonjë udhëzim specifik apo shënuar ndonjë zhvillim. Ndarja e tokave vazhdon të bëhet në një mënyrë ad hoc.*

### **Për zyrën e UNMIK-ut dhe të Këshilltarit ligjor**

Të përshtypet zhvillimi i legjislacionit të nevojshëm për implementimin e plotë të mandatit të Agjpcionit Kosovar të Pronave, përfshirë edhe legjislacionin e pamiratuar me të cilin do të rregullohet kompensimi për implementimin e kërkesave mbi të drejtat banesore.

*Deri më sot, nuk janë shënuar zhvillime konkrete në këtë drejtim gjatë periudhës së raportimit.*

<sup>96</sup> Duhet të përmendet se nuk janë referuar të gjitha ankesat dhe as nuk janë përcjellur ankesa me gjithë tërësinë e tyre. Një numër ankesash jo vetëm që kishte kërkesa për kompensim nga NATO-ja dhe të tjerët por po ashtu edhe kërkesa që biejnë në jurisdikcion të AKP-së, siç është humbja e posedit. Vetëm kjo pjesë e ankesave i është referuar AKP-së.

## **Për Ekipin përgatitor të Bashkimit Evropian**

Të merren parasysh nevojat për një strategji të koordinuar mbi banimin, kthimin e pronave si dhe kthimin dhe reintegrimin në planet e BE-së për Misionin në Kosovë.

*Nuk janë shënuar zhvillime konkrete në këtë drejtim gjatë periudhës së raportimit.*

## **Për donatorët ndërkombëtarë**

Të vlerësohen mundësitë për të financuar rindërtimin e pronave të pakryera minoritare që janë shkatërruar si dhe mundësitë për integrimin përkitazi me implementimin e mandatit të AKP-së (gjegjësisht, administrimit të tokës).

*Nuk janë shënuar zhvillime konkrete gjatë periudhës së raportimit.*



**'TETË VITE TË SHPËRNGULJES.'**

**EKSPozITË E FOTOGRAFIE NGA CRISTOPHE QUIRION**

"Personat e shpërngulur brenda vendit do të gjëzojnë, në barazi të plotë, të njëjtat të drejta dhe liri sipas legjislacionit ndërkombeartar dhe të atij të brendshëm si edhe personat e tjerë në vendin e tyre. Ada nuk do të diskriminohen për gjëzimin e cilado të drejtave e lirive mbi bazën e të qenit të tyre të shpërngulur brenda vendit. ".  
(Parimi1, Parimet Udhëheqëse të Shpërnguljes së Brendshme )

Tetë vite pas konfliktit në Kosovë rreth 227.000<sup>97</sup> njerëz ende jetojnë të shpërngulur në Kosovë ose në regjion. Të gjitha bashkësitë kanë qenë të ndikuara nga shpërngulja gjatë dhe pas konfliktit, duke përfshirë anëtarët e bashkësive Serbe të Kosovës, Gorane, Boshnjake, Turke, Kroate. Megjithatë, Romët, Ashkalinjtë dhe Egjiptianët përbëjnë bashkësi posaçërisht të cenuara. Nga përafërsisht 43.000 Romë, Ashkalinjtë dhe Egjiptianë të shpërngulur, deri në 20.000 persona nuk kanë dokumente, që i pengon ata të kenë qasje në shërbime dhe në shfrytëzimin e të drejtave të tyre .

Pavarësisht nga etnia e tyre, të gjithë njerëzit e shpërngulur vuajnë nga mungesa e madhe e kualitetit të jetës Ata shpesh jetojnë në kushte të tmerrshme duke iu munguar infrastruktura themelore, qasja në çfarëdo shërbime dhe shpresa në ardhmëri. Çoftë nëse ata duan të kthehen në shtëpitë e tyre, në ndonjë lokacion tjetër, në vende të treta ose duan të integrohen në vendin ku janë shpërngulur, shumë nga ta nuk kanë zgjidhje të zbatueshme dhe qëndrueshme për kërkесat .

Përpjekja e bashkësisë ndërkombeartare të ndihmoj kthimin e pronës dhe kthimin e qëndrueshëm të refugjatëve dhe personave të shpërngulur ka qenë shumë e ngadalshme. Gjithsej 17,585<sup>98</sup> kthime të minoriteteve janë regjistruar nga UNHCR që nga viti 2000. Perspektiva e varfër ekonomike dhe mungesa e sigurisë janë pengesa për kthim, por kthimi i pronës së shkatërruar ose okupuar është një nga mungesat më të dukshme dhe më të prekshme.

Fakti që tetë vite pas konfliktit në Kosovë njerëzit ende ballafaqohen me vështirësi në jetën e të qenit të shpërngulur do të duhej të nxisë autoritetet kompetente të marrin përgjegjësinë të mbështesin personat e shpërngulur dhe /ose personat së brendshmi të shpërngulur dhe të rivendosur në rikthimin e pronave të tyre të cilat i lan pas, ose në sigurimin e kompensimit ose rindërtimit të pronave të këtyre personave.

Këto fotografi tregojnë jetën e vështirë të personave të shpërngulur por gjithashtu me anë të tyre pasqyrojnë qëndrueshmërinë dhe dinjitetin e këtyre grave, burrave dhe fëmijëve

#### **Rreth fotografit.....**

Christophe Quirion është fotograf i lirë francez që jeton dhe punon në Kosovë që nga 2005. Me anë të punës së tij ai ka hulumtuar çështjet sociale siç është "Identitetet kosovare" dhe rrethanat e komuniteteve të ndryshme kosovare. [christophequirion@hotmail.com]

#### **MIRËNJOHJE**

Në përgatitjen e përbledhjes së këtij materiali, Seksioni për Pronësi pranë OSBE dëshiron t'i falënderojë të gjithë pjesëmarrësit e konferencës "Ti je i zhvendosur, por të drejtat tua nuk janë" që është mbajtur në Kosovë më 26 - 27 nëntor 2007. Ne po ashtu shprehim falënderimet tona kontribuuesve në vijim dhe të gjithëve që na kanë ofruar këshillat dhe mendimet e tyre:

<sup>97</sup> UNHCR, July 2007.

<sup>98</sup> UNHCR, October 2007.

Ministria e Ambientit dhe e Planifikimit Hapësinor  
MPDL – Lëvizja për Paqe  
Agjencioni Kosovar i Pronës  
Komesariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë  
Divizioni i OSBE për Komunitete  
Zyra e Ombudspersonit, Kosovë  
Projekti për të Drejtat e Njeriut / Kosovë  
Praxis, Beograd, Serbi

*Posaçërisht falënderojmë Victoria Jennett, Këshilltaren për të Drejtat e Njeriut në Seksionin e Pronës pranë OSBE, e cila është edhe editore e këtij libri si dhe drejtuese e projektit të konferencës “Ti je i zhvendosur, por të drejtat tua nuk janë” si dhe aktiviteteve të saja vijuese.*







MPDL  
Movement for Peace



PISG  
Ministry of Environment  
and Spatial Planning

